



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



MANUAL PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT

TË NJË GJYQIMITUES PËR TRAFIKIMIN E PERSONAVE NË SHQIPËRI

MANUAL PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT

TË NJË GJYQI IMITUES

PËR TRAFIKIMIN E PERSONAVE

NË SHQIPËRI

NËNTOR 2023



U.S. Mission to the OSCE



Permanent Mission of Italy
OSCE

ISBN 9789928340894

Botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Sheshi "Italia" Tirana, Albania

Tel: +35542240001

Email: pm-al@osce.org

© 2023 Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Të drejtat e autorit: Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Dizenjimi: Sonila Krashi

Foto e kopertinës: <https://elements.envato.com/>

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadrin e Programit "Avancimi i kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore", i cili zbatohet me mbështetjen e Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

Manuali është bazuar në eksperiencën praktike të përfutur gjatë një trajnimit të mëparshëm për gjyqin imitues, të organizuar për Studentët Magjistratë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në shkurt 2022, si dhe në Manualin e Trajnuesve të UNODC-së për Mënyrën e Organizimit të Gjyqeve Imituese dhe Hetimeve Simuluese bazuar në Raste të Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

INFORMACION LIGJOR:

Materialet e përfshira në këtë botim, janë vetëm për informacion të përgjithshëm të ofruara për një kontekst specifik. Pikëpamjet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri apo politikat zyrtare të Qeverive të Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë.

FALËNDERIME

Ky manual u hartua nën kujdesin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri, që e ka vlerësuar dhe mbështetur gjyqin imitues si një veprimtari parësore për ndërtimin e kapaciteteve në Shqipëri. Manuali u përgatit nga Rahel Gershuni, konsulente, nën kujdesin dhe koordinimin e Juliana Rexha, Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, si dhe me asistencë ligjore të Prof. Dr. Evis Alimehmeti, profesore në fushën e të drejtës publike dhe e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut pranë Fakultetit të Drejtësisë si dhe lektore e lëndës së Etikës Profesionale pranë Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri dhe Juliana Rexha.

Manuali është bazuar në eksperiencën praktike të përfutur gjatë një trajnimi të mëparshëm për gjyqin imitues, të zhvilluar për studentët e Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri, organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si dhe në Manualin e Trajnuesve të UNODC-së për Mënyrën e Organizimit të Gjyqeve Imituese dhe Hetimeve Simuluese bazuar në Raste të Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Bashkëpunimi midis UNODC-së dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për këtë manual është një shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit midis organizatave ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	7
2. Fazat e gjyqit imitues	10
3. Planifikimi i gjyqit imitues	12
4. Si të zgjedhim çështjen për gjyqin imitues	18
5. Pjesa teorike e trajnimit	22
6. Prezantimi i gjyqit imitues dhe shpërndarja e roleve	30
7. Periudha e përgatitjes	38
8. Seanca paraprake për gjyqin imitues: fazat dhe rolet	43
9. Diskutime përmbledhëse	49
10. Aktivitete në vijim të trajnimit	51
11. Shtojca	53
1. Programi	54
2. Shembuj të rregullave të përgjithshme dhe të përshkrimit të roleve	58
3. Shembull i një rasti studimor që të përdoret gjatë prezantimeve teorike	69
4. Shembull skenari për një gjyq imitues	71
5. Shembuj me pjesë provash nga një gjyq imitues aktual	73

1. HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore është një plagë që prek thelbin e qenies njerëzore: autonominë, dinjitetin dhe lirinë e saj. Kjo plagë është e pranishme në çdo vend të botës dhe shfaqet si brenda kufijve të vendit dhe si veprimtari ndërkufitare. Për shkak të rëndësisë që ka, shtetet anembanë botës janë bërë së bashku për ta luftuar këtë fenomen. Kjo evidentohet edhe nga ratifikimi pothuaj universal i një dokumenti shumë të rëndësishëm lidhur me këtë fenomen, si Protokollin mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokollin)¹. Konventa të tjera të rëndësishme në nivel rajonal përfshijnë Konventën e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve njerëzore (Konventa e Këshillit të Evropës)² dhe Direktivën (BE) e Parlamentit dhe Këshillit, e datës 5 prill 2011, Për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Tij.³

Shqipëria e nënshkroi Protokollin më 12 dhjetor 2000 dhe e ratifikoi më 21 gusht 2002. Ajo e nënshkroi Konventën e Këshillit të Evropës më 22 dhjetor 2005, si dhe e ratifikoi më 6 shkurt 2007, duke hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 shkurt 2008. Pas ratifikimeve, Shqipëria hartoi dispozita ligjore për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore në nenet 110/a dhe 128/b të Kodit Penal, që u referohen trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të fëmijëve, përkatësisht.

Rëndësia e këtyre konventave ndërkombëtare në Shqipëri mund të shihet nga pesha që u jep atyre Kushtetuta e Shqipërisë. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë fuqi superiore ndaj ligjeve e vijnë menjëherë pas Kushtetutës, dhe sipas nenit 112(1) çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, Protokollin dhe Konventa e Këshillit të Evropës, të ratifikuara nga Shqipëria, e gëzojnë këtë fuqi. Sipas nenit 122(2), çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk janë në pajtim me të.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve të singerta në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i krimeve të trafikimit, si në rang global edhe në Shqipëri, mbeten me mangësi për shkak të kompleksitetit të veprës penale dhe problematikave me provat. Për këtë arsye, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndërmarrë një sërë veprimtarish për ngritjen e kapaciteteve. Ndër to, gjyqi imitues ka qenë shumë i suksesshëm, duke i ndihmuar profesionistët të identifikojnë çështje tipike dhe të gjejnë zgjidhje kreative.

¹ Mund të gjendet këtu https://www.unodc.org/documents/treaties/Special/2000_Protocol_to_Prevent_2C_Suppress_and_Punish_Trafficking_in_Persons.pdf

² Mund të gjendet këtu <https://rm.coe.int/168008371d>

³ Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 prill 2011, Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Fletorja Zyrtare, seria L 101, 15.4.2011, f. 1-11, mund të gjendet te <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32011L0036>

Forca e gjyqeve imituese qëndron tek afërsia e tyre me realitetin në sallën e gjyqit të cilin profesionistët e drejtësisë penale mund ta identifikojnë shumë lehtë. Megjithatë, në ndryshim nga një proces i vërtetë ku përfshihen shumë elementë, gjyqi imitues ofron një hapësirë të sigurt për të mësuar dhe për të provuar zgjidhje të reja.

Objektivi i gjyqit imitues nuk është që të përmirësohen aftësitë e përgjithshme të pjesëmarrësve në sallën e gjyqit, por që t'i ndihmojë ata të kuptojnë problematikat dhe sfidat tipike në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe t'u mundësojë të mprehin aftësitë për trajtimin e këtyre çështjeve. Për këtë arsye, rregullat për organizimin e seancave të gjyqeve imituese nuk duhet të lejojnë që të ketë kërkesa, kundërshtime, apo pretendime, pasi këto e devijojnë vëmendjen nga gjykimi i çështjes në themel. Po ashtu, nuk i përfshin të gjitha fazat e një procedure penale në Shqipëri, për shembull, hetimin paraprak dhe seancën paraprake, në mënyrë që fokusi të jetë tek të mësuarit të së drejtës penale, materiale në çështjet e trafikimit të personave.



Objektivi i gjyqit imitues nuk është që të përmirësohen aftësitë e përgjithshme të pjesëmarrësve në sallën e gjyqit, por që t'i ndihmojë ata të kuptojnë problematikat dhe sfidat tipike në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe t'u mundësojë të mprehin aftësitë për trajtimin e këtyre çështjeve.

Përtej këtij objektivi afatshkurtër, gjyqi imitues mund të arrijë edhe objektiva afatgjata siç janë identifikimi i boshllëqeve në legjislacionin dhe praktikën gjyqësore shqiptare, si edhe në praktikën e vetë profesionistëve; forcimi i bashkëpunimit të ardhshëm midis strukturave të ndryshme, duke theksuar rolin e vlefshëm që kanë profesionistët dhe institucionet e ndryshme në luftën kundër trafikimit dhe sinjalizimin e pjesëmarrësve për vështirësitë me të cilat mund të përballen; një kuptim më të thellë të proceseve të trafikimit, sidomos kur në këtë aktivitet trajnues përfshihen të mbijetuarit. Këto objektiva afatgjatë kanë më shumë gjasa të përmbushen nëse trajnuesit organizojnë aktivitete edhe pas gjyqit imitues, siç shpjegohet në seksionin 10 të këtij manuali.

Gjyqi imitues ka rezultuar i suksesshëm sidomos duke qenë se ndërtohet mbi parimet e të mësuarit për të rriturit, duke ofruar një mjedis optimal nxënies për ta. Ai mbështetet tek parimi “mësojmë duke vepruar”, i cili priret t'i angazhojë sa më shumë pjesëmarrësit në krahasim me forma të tjera që janë më pak ndërvepruese. Secili pjesëmarrës luan një rol në proces dhe duhet të identifikojë pikat e forta dhe pikat e dobëta në çështjen në fjalë si dhe të hartojë strategjitë dhe taktikat e duhura për t'ia dalë me sukses. Pjesëmarrësit luajnë role si gjyqtarë, prokurorë, avokatë mbrojtës dhe personazhe të tjerë, duke pasur kështu mundësinë ta shohin çështjen nga kënde të ndryshme. Ata përdorin çfarë kanë mësuar dhe kanë mundësinë të përdorin përvojën profesionale që kanë fituar deri më atëherë. Pjesëmarrësve



Gjyqi imitues mbështetet tek parimi “mësojmë duke vepruar”, i cili priret t’i angazhojë sa më shumë pjesëmarrësit në krahasim me forma të tjera që janë më pak ndërvepruese. Secili pjesëmarrës luan një rol në proces dhe duhet të identifikojë pikat e forta dhe pikat e dobëta në çështjen në fjalë si dhe të hartojë strategjitë dhe taktikat e duhura për t’ia dalë me sukses.

nuk u jepen udhëzime të gatshme, por lihen të lirë të përdorin njohurinë që kanë, në mënyrë të pavarur dhe krijuese. Aktiviteti është sfidues dhe shfrytëzon aftësinë për zgjidhjen e problemeve; ai kërkon zbatimin e njohurive për detyrat përkatëse; mundëson mësimin në mënyra të ndryshme dhe duke ndërthurur praktikën me reflektimin. Të gjitha këto janë karakteristika të mëimit për të rriturit.⁴

Ky manual synon t’u japë trajnuesve një udhëzues të natyrës hap pas hapi për mënyrën se si të organizojnë gjyqe imituese në Shqipëri. Ai mbështetet në Manualin e UNODC-së për Trajnuesit lidhur me Mënyrën e Zhvillimit të Gjyqeve Imituese dhe Simulimeve të Hetimeve bazuar në Rastet e Trafikimit të Personave (Manuali i UNODC për Gjyqet Imituese),⁵ u kushton vëmendje tendencave të veçanta dhe problematikave të pranishme në Shqipëri, si dhe mbështetet në legjislacionin dhe praktikën gjyqësore shqiptare dhe në burimet ndërkombëtare. Kjo u mundëson si trajnuesve ashtu edhe pjesëmarrësve fokusimin tek sfidat e veçanta me të cilat përballen profesionistët shqiptarë.

Manuali përpiket të përshkruajë fazat dhe rolet e gjyqit imitues në mënyrë të unifikuar, dhe ndjek qasjen e parashtruar në Manualin e UNODC-së për Gjyqin Imitues,⁶ duke i mundësuar trajnuesve përdorimin e diskrecionit të tyre si dhe duke paraqitur opsione të ndryshme për zbatimin e tij, së bashku me faktorët pro dhe kundra. Trajnuesit mund ta përshtatin trajnimin sipas karakteristikave të grupit të pjesëmarrësve. Një qasje e tillë mbështetet në parimin se nuk ka një zgjidhje të vetme që përdoret për çdo situatë.

Trajnuesit që dëshirojnë të përfitojnë nga një analizë më e hollësishme teorike dhe një këndvështrim më global mund të përdorin edhe Manualin e UNODC-së për Gjyqin Imitues, së bashku me këtë manual.

⁴ Shih Maria N. Gravani, “Adult Learning Principles in Designing Learning Activities for Teacher Development”, International Journal of Lifelong Education, volume 31 No. 4 (2012), f. 419; Sarah Cornelius, Carole Gordon and Aileen Ackland, “Towards Flexible Learning for Adult Learners in Professional Contexts: An Activity – focused course design”, Interactive Learning Environments, vol. 19, No. 4 (2011), f. 381.

⁵ Cituar më parë.


⁶ Cituar më parë.

2. FAZAT E GJYQIT IMITUES

Zakonisht, gjyqi imitues kalon në disa faza:

- » Vendime dhe veprime të planifikimit, të cilat i paraprijnë vetë gjyqit imitues: këtu përfshihen vendimi për llojin e gjyqit imitues që do të ndiqet; vendimi për kategorinë e pjesëmarrësve; zgjedhja e ekipit të trajnuesve; vendimi për rolin që do të luajnë; zgjedhja e rasteve mbi të cilat do të bazohet gjyqi imitues; dhe përgatitja e dokumenteve bazë dhe instrumenteve të mësimi. Shih seksionin 3 për një përshkrim më të hollësishëm të kësaj faze dhe seksionin 4 që fokusohet në një prej vendimeve më të rëndësishme - si të zgjedhim rastin në të cilin do të bazohet gjyqi imitues.
- » Prezantime teorike: kjo pjesë e trajnimit trajton çështje të rëndësishme teorike për të garantuar që të gjithë pjesëmarrësit të kenë një bazë të përbashkët njohurish si dhe të jenë të pajisur për trajtimin e çështjeve të rastit në fjalë, çka përbën bazën e seancës së gjyqit imitues. Sugjerohet të zgjasë një ditë, por nëse koha është e kufizuar, mund të shkurtohet. Shih seksionin 5 për një përshkrim më të plotë të kësaj faze të trajnimit.
- » Udhëzimet për moderatorin dhe caktimi i roleve: Gjatë kësaj faze, moderatori prezanton trajnimin dhe objektivat, si dhe përshkruan fazat që do të ndiqen, rolet e pjesëmarrësve dhe rregullat bazë për të gjithë aktivitetin. Më pas, moderatori cakton rolet për pjesëmarrësit. Sugjerohet që kjo të zgjasë një orë. Shih seksionin 6 për një përshkrim më të plotë të kësaj faze të trajnimit.
- » Periudha e përgatitjes: Gjatë kësaj faze, pjesëmarrësit studiojnë dokumenta dhe provat e gjykatës, lexojnë materialet teorike përkatëse dhe përgatiten për rolet. Sugjerohet të zgjasë dy orë e gjysmë deri në tre orë, ndonëse disa trajnime të suksesshme të gjyqit imitues e kanë kufizuar këtë kohë në 2 orë. Shih seksionin 7 për një përshkrim të plotë të kësaj faze të trajnimit, përfshirë edhe se çfarë pritet prej secilit rol.
- » Seanca e gjyqit imitues: gjatë fazës së seancës, pjesëmarrësit luajnë rolin e caktuar për në seancë. Dëshmitarët merren në pyetje nga mbrojtja dhe nga akuza; paraqiten provat; parashtrohen argumentet përmbyllëse dhe jepet vendimi për çështjen. Sugjerohet të zgjasë tre orë e gjysmë deri në katër orë për një seancë të plotë dhe një orë e gjysmë deri në dy orë për një proces të shkurtuar. Shih seksionin 8 për një përshkrim të plotë të kësaj faze të trajnimit, përfshirë fazat e tij edhe se çfarë pritet prej secilit rol.
- » Diskutime përmbledhëse (debriefing). Gjatë kësaj faze, pjesëmarrësit japin komente vlerësuese për trajnimin, përfshirë komente për çfarë shkoi mirë dhe për çfarë mund të përmirësohet. Sugjerohet që të zgjasë një orë. Shih seksionin 9 për një përshkrim më të plotë të kësaj faze të trajnimit.

- » Veprimtari pasuese: Këtu mund të përfshihen ndjekja e ndryshimeve të nevojshme në legjislacion dhe praktikë apo krijimin e një skuadre kolegësh (peer group) për konsultim. Një përshkrim i hollësishëm jepet në seksionin 10 të manualit.



3. PLANIFIKIMI I GJYQITIMITUES

Planifikimi ka rëndësi thelbësore për garantimin e suksesit të trajnimit të gjyqitimitues. Ky planifikim përfshin analizën e pyetjeve të ndryshme dhe përgatitjen për instrumente të rëndësishme të procesit të të mësuarit, dokumenta dhe prova të rëndësishme për suksesin e trajnimit. Vendimet dhe veprimet duhet të realizohen përpara se të fillojë trajnimi. Ato përfshijnë:

3.1 QARTËSIMIN E ROLEVE TË EKIPIT TË TRAJNUESVE - PARA FILLIMIT TË TRAJNIMIT, ROLET E TRAJNUESVE DUHET TË JENË BËRË TË QARTA, PËRFSHIRË:

- » Vendimin për llojin e gjyqitimitues, të plotë apo të shkurtuar;
- » Vendimin për kategoritë dhe numrin e pjesëmarrësve;
- » Përpjekjen për të përcaktuar nivelin e njohurive të pjesëmarrësve para fillimit të trajnimit;
- » Zgjedhjen e rastit mbi të cilin do të bazohet gjyqiimitues;
- » Përgatitjen dhe zbatimin e agjendës;
- » Vendimin për çështjet teorike që do të trajtohen gjatë fazës teorike;
- » Përgatitjen e instrumenteve interaktive për të mësuarin, të cilat do të përdoren gjatë pjesës teorike, si rastet studimore (ndonëse disa prej tyre mund të përgatiten nga prezantuesit);
- » Zgjedhja mes opsioneve për caktimin e roleve;⁷
- » Përpilimin e dokumentave kyçe për gjyqinimitues duke përfshirë: rregullat bazë, skenarin e rasteve, listën e burimeve, listën e roleve dhe provave, aktakuzën, deklaratat e dëshmitarëve, prova dokumentare dhe fizike, nëse ka, opinionet e ekspertëve, sipas rastit;
- » Përkthimin e burimeve nëse është e nevojshme;
- » Përzgjedhjen e një grupi me ekspertë për konsulencë gjatë trajnimit dhe për prezantime gjatë pjesës teorike të trajnimit;
- » Lehtësimin dhe moderimin e sesioneve të ndryshme;
- » Orientimin e pjesëmarrësve sidomos gjatë periudhës së përgatitjes;
- » Moderimin dhe diskutimet përmbledhëse;
- » Vlerësim dhe monitorim të vazhdueshëm të trajnimit;
- » Krijimin e një atmosfere besimi dhe bashkëpunimi gjatë gjithë aktivitetit;

⁷ Për shembull, çfarë mënyre do të përdoret për caktimin e roleve; nëse pjesëmarrësit do të luajnë në rolin e tyre real profesional apo do të këmbëjnë rolet; cilat role do të luhen nga pjesëmarrësit dhe cilët nga trajnerët apo aktorët (shih seksionin 6 "Prezantimi nga moderatori dhe caktimi i roleve" për një përshkrim më të hollësishëm).

3.2 PËRBËRJA E EKIPIT TË TRAJNUESVE

- » Ekipi duhet të karakterizohet nga një eksperiencë dhe ekspertizë e larmishme dhe e pasur për të kontribuar në këtë aktivitet trajnimi. Ekspertiza përkatëse mund të lidhet me kuadrin ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore, legjislacionin dhe tendencat shqiptare të trafikimit dhe ekspertizën për organizimin e gjyqeve imituese. Për numrin e anëtarëve, duhet mbajtur në konsideratë vendosja e një balance midis ekspertizës sa më të larmishme dhe lehtësisë për të bashkëpunuar. Gjithsesi, ekipi duhet të ketë të paktën dy anëtarë.

3.3 LLOJI I GJYQIT IMITUES

- » Ndonëse si rregull gjyqi imitues përfshin marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave, për shkak të kufizimeve mund të organizohet një version i shkurtuar i gjyqit imitues, ku akuza dhe mbrojtja paraqesin argumentet pro dhe kundër dënimit dhe gjykatësi jep vendimin. Ndonëse ky është një format i kufizuar, ai gjithsesi u paraqet pjesëmarrësve mundësinë që të identifikojnë problematika dhe t'i trajtojnë ato.

3.4 KATEGORITË E PJESËMARRËSVE

- » Pjesëmarrësit kryesorë janë oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë dhe gjyqtarë. Megjithatë, mund të konsiderohen edhe profesionistë të tjerë si: inspektorë të punës, oficerë të emigracionit, persona nga shërbimet e kujdesit social, si dhe OJF-të. Ashtu si edhe në të gjitha trajnimet për ndërtimin e kapaciteteve, duhet të synohet një balancë gjinore dhe trajnuesit duhet të marrin vlerësojnë nëse pjesëmarrësit duhet të jenë një grup me kategori të ndryshme profesionistësh, apo një grup më homogjen me vetëm një grup përfaqësuesish. Për më tepër mbi këto vendime, shih Manualin e UNODC-së për gjyqin imitues.⁸

3.5 NUMRI OPTIMAL I PJESËMARRËSVE

- » Trajnuesit duhet që të balancojnë nevojën për trajnimin e sa më shumë profesionistëve, me kufizimet e aktivitetit trajnues, ku kërkohet që të gjithë pjesëmarrësve të kenë një rol aktiv. Numri optimal i pjesëmarrësve vlerësohet të jetë midis 15 dhe 30.

3.6 PËRCAKTIMI I NIVELIT TË NJOHURISË SË PJESËMARRËSVE PARA FILLIMIT TË AKTIVITETIT TRAJNUES

- » Ndonëse një detyrë e vështirë, ka vlerë të provohet pasi mund të shërbejë për të kursyer kohë duke qenë se trajnuesit, për shembull, nuk do të kenë nevojë të trajtojnë materiale bazike. Pjesëmarrësve mund t'u kërkohet të plotësojnë që më parë një pyetësor dhe ta dërgojnë me e-mail për të përcaktuar nivelin e njohurive të tyre para aktivitetit, të ndjekin një modul mësimi online para aktivitetit në mënyrë që të garantohet një nivel i përbashkët njohurish, ose të marrin pjesë në një takim online përpara zhvillimit të aktivitetit. Kjo mund të jetë e vështirë për t'u realizuar duke marrë parasysh kufizimet kohore për profesionistët dhe angazhimin e madh për organizim që kërkohet nga trajnuesit. Nëse nuk arrijnë ta bëjnë këtë, të paktën në fillim të aktivitetit trajnuesit mund t'u kërkohen pjesëmarrësve të plotësojnë pyetësorët.

⁸ Cituar më parë.






3.7 GRUPI I EKSPERTËVE

- » Trajnuesit duhet të vlerësojnë se cilët ekspertë janë të nevojshëm dhe të përshtatshëm për këtë trajnim me një gjyq imitues. Këta ekspertë mund të luajnë një rol të rëndësishëm me konsultimet përgjatë gjithë aktivitetit, me prezantime gjatë pjesës teorike të aktivitetit apo me këshilla dhe udhëzime për pjesëmarrësit gjatë kohës që ata përgatiten për aktivitetin. Këtu mund të përfshihen ekspertë në fushën ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore; ekspertë shqiptarë në fushat e legjislacionit penal, procedurës penale dhe provave të çështjes; ekspertë shqiptarë mbi legjislacionin e trafikimit, praktikën gjyqësore dhe tendencat e trafikimit në Shqipëri; ekspertë shqiptarë mbi legjislacionin e punës dhe situatat e punës së detyruar; psikologë që njohin mirë sjelljen e viktimave të ndikuar nga traumat; punonjës nga OJF-të ose kujdesi social me përvojë në mbrojtjen e viktimave; ekspertë shqiptarë të përkujdesjes ndaj fëmijëve; ekspertë shqiptarë mbi zakonet dhe traditat kulturore të grupeve të ndryshme të popullsisë në Shqipëri, përfshirë ato të romëve dhe egjiptianëve nëse kjo lidhet me gjyqin imitues; të mbijetuar; e gjitha kjo e kushtëzuar nga një vlerësim profesional i aftësisë së tyre për të përballuar daljen para një audience. Këshillohet që të përfshihen disa ekspertë që kanë profesione të njëjta me pjesëmarrësit.

3.8 SHTRIRJA KOHORE E GJYQIT IMITUES

- » Trajnuesit duhet të mbajnë parasysh shtrirjen kohore të aktivitetit. Ata duhet të përpiqen të arrijnë një baraspeshë midis kufizimeve kohore të profesionistëve dhe nevojës për t'u kushtuar kohë të mjaftueshme procesit të të mësuarit. Ekspertët duhet të vlerësojnë se kohëzgjatja optimale për një gjyq imitues është midis 3 dhe 5 ditëve, ndonëse ka pasur gjyqe imituese që kanë rezultuar me sukses dhe janë organizuar për një kohë më të shkurtër.

Ndonëse nuk ka një dakortësim të përgjithshëm për kohëzgjatjen e fazave të ndryshme të trajnimit, më poshtë janë disa sugjerime:

				
Prezantime teorike:	Prezantimi nga moderatori dhe caktimi i roleve:	Periudha e përgatitjes:	Seanca e gjyqit imitues:	Diskutime përmblendhëse:
një ditë	një orë	dy orë e gjysmë deri në tre orë	tre orë e gjysmë deri në katër orë	1 orë

3.9 GARANTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË AKTIVITETIT TRAJNUES ME LEGJISLACIONIN VENDAS SA I TAKON PJESËS MATERIALE, PROCEDURALE DHE PROVAVE

- » Trajnuesit duhet të sigurohen që gjyqi imitues të jetë sa më në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka të bëjë me pjesën materiale, procedurale dhe provat, në mënyrë që të nxitet vërtetësia e trajnimit dhe që pjesëmarrësit të ndihen komod me kuadrin përkatës. Për këtë qëllim, ata duhet të kujdesen që të konsultohen me ekspertët për ligjet, rregullat dhe procedurat përkatëse, përfshirë format e pranueshme për dokumentat zyrtare ose opinionet e ekspertëve nëse do të përdoren këto.

Ndonëse mund të jetë e nevojshme të anashkalohen disa rregulla në interes të caktimit të roleve më aktive për pjesëmarrësit, nisur nga kufizimet e kohës apo për t'u fokusuar më shumë te të mësuarit e thelbit të çështjes, mund të jetë e nevojshme që këto anashkalime t'u bëhen të ditura pjesëmarrësve në mënyrë që të ruhet besueshmëria. Një shembull i rëndësishëm është që pjesëmarrësit të mos lejohen të hyjnë në kërkesa procedurale, marrëveshje për fajësinë, kundërshtime apo pretendime, sepse këto mund ta devijojnë qëllimin e trajnimit duke u larguar nga thelbi i të mësuarit për trafikimin me qëllim zhvillimi i mëtejshëm i aftësive për në sallën e gjyqit, çka nuk është qëllimi i këtij aktiviteti. Një shembull tjetër i rëndësishëm është mospërfshirja e disa fazave të procesit si për shembull hetimi paraprak dhe seanca paraprake, çka mund ta ndërlikojë procesin dhe ta largojë fokusin e trajnimit nga qëllimi kryesor, ai i të mësuarit mbi trafikimin. Këto shmangie duhet të jenë të pranishme në çdo aktivitet trajnues për një gjyq imitues në interes të të mësuarit, me qëllim respektimin e kufizimeve kohore, dhe si të tilla duhet të mbahen parasysht nga ana e trajnuesve.

Shembuj të tjerë të devijimit nga procedimi penal mund të jenë caktimi i roleve për një panel gjyqtarësh, pra jo thjesht vetëm një i tillë, edhe nëse ligji mund të parashikojë vetëm një gjyqtar për këto çështje. Kjo në interes të caktimit të sa më shumë roleve aktive; mundësimin të pranishëm të gjithë pjesëmarrësve gjatë seancës dëgjimore, edhe nëse rregullat procedurale i ndalojnë dëshmitarët që të jenë të pranishëm gjatë dhënies së dëshmisë nga dëshmitarët, me qëllim forcimin e të mësuarit në grup.

3.10 NXITJA E NJË ATMOSFERE BESIMI DHE BASHKËPUNIMI

- » Para se të fillojë aktiviteti trajnues, është tejet e rëndësishme që trajnuesit të vlerësojnë krijimin e një atmosfere besimi dhe bashkëpunimi, pasi kjo është me rëndësi kyçe për suksesin e aktivitetit, që për nga natyra kërkon bashkëpunim dhe që pjesëmarrësit të ndihen të sigurt për të dalë nga zona e tyre e komfortit. Sugjerime konkrete jepen në Manualin e UNODC-së për gjyqin imitues.⁹

3.11 PËRGATITJA DHE ZBATIMI I AGJENDËS

- » Agjenda duhet të përgatitet nga ekipi i trajnuesve, me kontributin e ekspertëve shqiptarë, me qëllim që të sigurohet një trajtim çështjesh dhe problematikash të rëndësishme, si dhe për të përfshirë ekspertët lokalë në prezantime. Duhet treguar kujdes për të siguruar përfshirjen e çështjeve kyçe në pjesën teorike të aktivitetit trajnues, në veçanti ato që kanë çuar në dështimin

⁹ Cituar më parë. Shih seksionin 4.7

e rasteve në të kaluarën, të tilla si çështjet dhe modelet e përshkruara në seksionin 4 “Si të zgjedhim çështjen për trajnim me një gjyq imitues”.

Duhet treguar kujdes që agjenda të ndiqet me një farë fleksibiliteti në mënyrë që të përmbushen nevojat e pjesëmarrësve, të cilat mund të lindin rrugës.

Në Shtojcën 1 jepet një shembull i agjendës.

3.12 ZGJEDHJA E ÇËSHTJES PËR GJYQIN IMITUES

Ky është një nga vendimet më të rëndësishme për trajnuesit. Për shkak të rëndësisë që ka, manuali i kushton një seksion të posaçëm (seksioni 4).

3.13 PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA E NJOFTIMIT TË AKUZËS

- » Kush duhet ta hartojë? Idealisht, njoftimi i akuzës duhet të përgatitet nga ekipi i akuzës pas caktimit të roleve për t’u ushtruar në këtë aftësi. Megjithatë, ekipi mund të mos ketë kohë të mjaftueshme gjatë periudhës së përgatitjes që të hartojë një vendim “Mbi njoftimin e akuzës”, të përgatisë dëshmitarët, të përgatisë marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe të palës tjetër, të përpilojë argumentet përmbyllëse. Po të lihet hartimi i vendimit të “njoftimit të akuzës” për më vonë, atëherë pjesëmarrësit e tjerë do ta marrin atë relativisht vonë gjatë përgatitjes së tyre për çështjen. Në këtë kontekst, mund të jetë më mirë që me përgatitjen e vendimit të “njoftimit të akuzës” të merret ekipi i trajnimit.
- » Forma e vendimit të “njoftimit të akuzës”: Duhet të jetë në përputhje me modelin e akuzës që paraqiten në Shqipëri, me formatin e përdorur “për njoftimin e akuzës” me qëllim që të jetë sa më pranë realitetit.
- » Akuzat: A duhet të përfshihen një sërë akuzash apo vetëm akuza për trafikim? Kur ka një seri akuzash, kemi një situatë faktike që mund të pasqyrojë disa vepra penale, por edhe mund t’i shpërqëndrojë pjesëmarrësit nga akuza e trafikimit, që është qëllimi kryesor i aktivitetit trajnues. Nga ana tjetër, nëse përfshihet vetëm akuza për trafikim, pjesëmarrësit do të fokusohen tek trafikimi, por mund të mos marrin parasysh akuza të tjera të mundshme me të cilat mund të përballen në një çështje në jetën reale. Një zgjidhje mund të jetë që akuza të kufizohet tek trafikimi, por duke vënë në dukje se mund të ishin shtuar edhe akuza të tjera.

3.14 CILAT PROVA DUHEN PËRGATITUR?

- » Pasi të jetë përzgjedhur çështja, trajnuesit duhet të përgatisin provat e çështjes. Idealisht, ata duhet të përgatisin prova të ndryshme dhe të mos qëndrojnë vetëm tek deklaratimet e viktimës, të cilat priren të kenë dobësi lidhur me provat. Këto prova mund të përfshijnë deklaratimet e dëshmitarëve në polici, përfshirë deklaratimet e viktimave; opinionet e ekspertëve sipas rastit; dokumente të rëndësishme që lidhen me çështjen si, të dhëna të nxjerra nga telefonat celularë, certifikata lindjeje, leje pune; objekte fizike si prezervativë, armë, kartëmonedha, foto të mjedisëve që ilustrojnë kushte çnjerëzore; apo foto të personave me lëndime apo në gjendje të dobët shëndetësore.

Deklaratat para autoriteteve të policisë dhe dokumentet zyrtare si çertifikata e lindjes apo pasaporta duhet të bazohen në tendencat vendore sipas të dhënave nga ekspertët shqiptarë, në mënyrë që të përforcohet besueshmëria e tyre.

3.15 A DUHEN PËRDORUR SALLA REALE APO TË IMPROVIZUARA?

- » Trajnuesit duhet të vendosin nëse duan të përdorin një sallë të vërtetë në gjykatë apo një sallë konferencash të organizuar sipas modelit të një salle gjyqi. Ndonëse zhvillimi i aktivitetit trajnues në një sallë të vërtetë në gjykatë mund ta bëjë atë më reale dhe angazhuese për pjesëmarrësit, mund të jetë e vështirë që të organizohet kjo me autoritetet përkatëse dhe mund të kërkojë më shumë angazhim në kohë dhe logjistikë.

Vërejmë se vendime të mëtejshme për planifikim dhe hollësi të tjera për secilën mund të gjenden në Manualin e UNODC-së për gjyqin imitues.¹⁰

¹⁰. Një pyetje e rëndësishme është nëse trajnimi me një gjyq imitues duhet të filmohet për qëllime mësimi.

4. SI TË ZGJEDHIM ÇËSHTJEN PËR GJYQIN IMITUES

Siç është përmendur më sipër, përzgjedhja e çështjes është një prej vendimeve më të rëndësishme për planifikim, për shkak të ndikimit të madh që ka ajo në fazat e aktivitetit trajnues.

Më poshtë jepen disa konsiderata që mund të kenë ndikimin e tyre mbi këtë vendim:

4.1 ÇËSHTJA DUHET TË JETË AKTUALE, FIKTIVE, APO E NDËRTHURUR?

ÇËSHTJE AKTUALE:

Trajnimi me anë të një gjyqi imitues i bazuar në një çështje aktuale e forcon besueshmërinë e tij, i parashton pjesëmarrësve shumë pyetje dhe problematika të ndryshme si dhe mund të përdoret si një burim udhëzues, nëse për atë është marrë vendim në një juridiksion tjetër. Megjithatë, ajo nuk mund të përfshijë të gjitha problematikat që kanë rëndësi për aktivitetin trajnues.

ÇËSHTJE FIKTIVE:

Këto u mundësojnë trajnuesve përfshirjen e një morie problematikash të rëndësishme, por u mungon besueshmëria.

ÇËSHTJE TË NDËRTHURURA:

Këto mund të jenë zgjidhja për këtë dilemë. Në këtë rast, kemi një kombinim të një çështjeje aktuale së cilës i shtohen ose hiqen pjesë të saj, në mënyrë që të pasqyrohen çështje që do të trajtohen. Për shembull, edhe kur një çështje aktuale bazohet tek një viktimë e vetme person i rritur, trajnuesit mund të shtojnë një viktimë të mitur, me qëllim që pjesëmarrësit të fokusohen tek dallimet midis trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të fëmijëve.

4.2 NJË ÇËSHTJE SHQIPTARE APO E HUAJ?

Është e qartë që përzgjedhja e një çështjeje shqiptare ka përparësi krahasuar me një çështje nga një juridiksion tjetër. Në këtë mënyrë, fokusi me gjasë do të jetë tek tendencat dhe çështjet vendase, që mund të bëjë që pjesëmarrësit të ndihen më të afërt dhe ta kuptojnë më mirë situatën, dhe çështja të shërbejë si precedent. Nga ana tjetër, kjo lloj çështjeje mund të mos përfshijë një vendim që përfshin ato që qëndrojnë në thelb të aktivitetit trajnues, ndërkohë që çështje nga juridiksione të tjera mund ta ofrojnë këtë gjë. Një zgjidhje mund të jetë që të përdoret një çështje shqiptare si bazë dhe të përfshihen në të pjesë themeltare nga çështje të tjera nga juridiksione të tjera.

Theksojmë se nëse përzgjidhet një çështje shqiptare, është e rëndësishme të përcaktohet përpara nëse ndonjëri prej pjesëmarrësve ka pasur një rol në të. Përvojat e mëparshme tregojnë se kjo mund të çojë në një qasje mbrojtëse dhe ndasi midis pjesëmarrësve. Trajnuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë dhe të vendosin nëse do ta konsiderojnë këtë çështje. Sipas të njëjtit arsyetim, nëse përzgjidhet një çështje e mirënjohur, është rreziku që mund të nxirren më pak mësim pas pjesëmarrësit mund ta njohin tashmë çështjen dhe vendimin përkatës.

4.3 NIVELI I KOMPLEKSITETIT

Trajnuesit duhet të arrijnë një balancë midis një çështjeje të thjeshtë që nuk i sfidon pjesëmarrësit mjaftueshëm, dhe një çështjeje tejet komplekse që mund t'i konfuzojë dhe të kërkojë më shumë kohë nga sa është në dispozicion. Një zgjidhje është që të përzgjidhet një çështje komplekse me disa problematika brenda, por, në të mirë të thjeshtimit, të hiqen prej saj elemente, për shembull të reduktohet numri i dëshmitarëve ose i problematikave.

4.4 PËRFSHIRJA E ÇËSHTJEVE KYÇE¹¹

Në kontekstin shqiptar, moskuptimi sa duhet i çështjeve të mëposhtme ka çuar në dështime të ndjekjeve të rasteve në të shkuarën dhe mund të pengojë zgjidhjen e çështjeve në të ardhmen. Ndonëse të gjitha këto problematika nuk mund të përfshihen në çdo çështje, vlen të jemi të vetëdijshëm për to:

Pëlqimi:	A ka rëndësi pëlqimi i viktimës? A e konsideron legjislacioni shqiptar pëlqimin e viktimës si të panevojshëm?
“Mjetet” e pashaqura:	Rëndësia e mjeteve që nuk kërkojnë dhunë fizike si “përfitimi nga gjendja sociale, fizike ose psikologjike” ose “trajta të tjera të detyrimit”, e cila mund të përfshijë presionin psikologjik, duke çuar në të kuptuarin se trafikimi nuk kërkon dhunë.
Shfrytëzimi që nuk është materializuar:	Si t'i trajtojmë çështje të tilla që mund të ndodhin në Shqipëri? A i trajton legjislacioni shqiptar këto raste? Cilat janë vështirësitë lidhur me provat për ta vërtetuar atë?
Trafikimi për veprimtari kriminale:	A trajtohet në legjislacionin shqiptar trafikimi ose shfrytëzimi për qëllime veprimtari kriminale? A duhen akuzuar këto viktima? A varet përgjigjja nga lloji i kriminit që është kryer? Si hyn në këtë diskutim parimi i mos-dënimit?
Trafikimi për lypje të detyruar:	A i trajton legjislacioni shqiptar rastet e trafikimit për lypje të detyruar?

¹¹ Çështjet e përshkruara në këtë nënseksion janë marrë nga dokumenti i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri "Tipologjia e çështjeve të trafikimit të fëmijëve në Shqipëri" (Tipologjia e OSBE-së) dokumenti i UNODC-së "Analiza e çështjeve të trafikimit të personave në Republikën e Shqipërisë", Tiranë, prill 2022 (Analiza e çështjeve UNODC) dhe Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin e Personave 2022 dhe 2023 - Shqipëria (Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit).

Martesë e detyruar:	Kur cilësohet si trafikim martesë e detyruar? Një shembull mund të jetë shërbimi i detyruar në shtëpi apo puna e detyruar brenda familjeve rome dhe egjiptiane, siç raportohet në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit 2023.
Birësimi i paligjshëm:	Kur cilësohet birësimi i paligjshëm si shfrytëzim në kontekstin e trafikimit? Në cilat raste mund të realizohet?
Dallimi midis shkeljeve të legjislacionit të punës dhe trafikimit:	Cili është dallimi midis shkeljeve të legjislacionit të punës dhe trafikimit për punë të detyruar, skllavëri, apo praktika të ngjashme me skllavërinë? Ç'ndikim ka kompetenca e kufizuar e inspektorëve të punës në zbulimin e rasteve? Mungesa e trajnimit të tyre? ¹²
Trafikimi i fëmijëve brenda vendit:	A trajtohet trafikimi i fëmijëve brenda vendit në nenin 128/b të Kodit Penal? Më parë, kishte nga ata që pretendonin se nuk trajtohej dhe se duhej përdorur një akuzë më e ulët. Megjithatë, një vendim i kohëve të fundit i Gjykatës së Lartë e unifikon praktikën gjyqësore duke e përfshirë këtë formë shfrytëzimi në nenin 128/b. ¹³
Dobësi tipike që shërbejnë për provat:	Çështja duhet të përfshijë dobësi tipike që shërbejnë për provat si dështimi për t'ia mbathur apo për të kërkuar ndihmë në mundësinë më të parë, kthimi tek abuzuesi, viktima që i drejtohet trafikantit për ta shoqëruar atë, viktima refuzon të paraqesë një kallëzim, viktima tërheq kallëzimin. Lind pyetja: A duhet që këto dobësi ta mbyllin një çështje?
Praktikat më të mira:	Do të ishte mirë që në çështje të përfshihen praktikatat më të mira, si lejimi i psikologut ose punonjësit social të shoqërojë një viktimë vulnerabël kur ai ose ajo intervistohen nga policia; referimi i viktimës nga policia tek një strehëz; një punonjës social që vazhdon ta vizitojë viktimën në strehëz; një fëmijë që intervistohet nga një police femër që ka marrë trajnim të posaçëm për intervistimin e fëmijëve.
Ndikimi i stereotipeve dhe miteve në zbatimin e ligjit lidhur me veprat penale të trafikimit:	Përfshirja e stereotipeve në bazë të gjinisë/pakicave/migrantëve mund të jetë i vlefshëm dhe të tregohet ndikimi i tyre tek gatishmëria e ligjzbatuesve për të njohur viktimat.

¹². Sipas Analizës së Çështjeve të UNODC-së të cituar më lart dhe Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit vëren gjithashtu se inspektorët e punës nuk janë të trajnuar sa duhet për të identifikuar viktimat e punës së detyruar.

¹³. Ndonëse përkufizimi i veprës penale të trafikimit të fëmijëve në nenin 128/b të Kodit Penal nuk kufizohet te trafikimi ndërkombëtar, ai nuk e shpreh në mënyrë eksplicite se trafikimi i fëmijëve mund të ndodhë si brenda edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në dallim nga neni 110/a i Kodit Penal që e specifikon "... si brenda edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë". Megjithatë, sipas një vendimi unifikes të Gjykatës së Lartë më 2011, konkretisht Vendimi nr 03/2011, kriteri bazë për zbatueshmërinë territoriale të veprës penale të trafikimit ishte: "hyrja ose dalja e paligjshme e personave apo sendeve nga territori i Shqipërisë ose kalimi i paligjshëm i tyre përmes territorit shqiptar." Në vitin 2022, Gjykata e Lartë adoptoi një tjetër Vendim Unifikues, konkretisht vendimin 00-2022-1679, datë 27.07.2022, i cili mban këtë qëndrim si më poshtë: "Trafikimi i qenieve njerëzore nuk kërkon domosdoshmërisht kalimin e kufijve shtetërorë dhe nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Trafikimi i qenieve njerëzore ka si qëllim kryesor shfrytëzimin e viktimës. Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit të shtetit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elemente: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj. Kolegji thekson se në këtë rast nuk gjen zbatim parimi i territorit."

Për një analizë më të hollësishme shih dokumentin: "Analysis of Albanian Trafficking in Persons Sections by the Light of Current Global Debates on Key Concepts in Trafficking", përditësuar në qershor 2023.

4.5 SHKALLA E DETAJEVE

Duhet vendosur një baraspeshë midis një çështjeje që ka shumë hollësi dhe një çështjeje që ka pak hollësi. Një çështje që ka shumë detaje mund të angazhojë më mirë pjesëmarrësit dhe të paraqesë një larmi problematikash, por ndërkohë paraqet edhe rrezikun e krijimit të konfuzionit, mungesës së fokusit në pikat më të rëndësishme dhe të neglizhimit të kufizimeve kohore. Nga ana tjetër, një çështje që ka tepër pak detaje nuk i sfidon sa duhet pjesëmarrësit dhe mund të mos i angazhojë e t'i pengojë të rriten në rolet e tyre.

4.6 RËNDËSIA TEORIKE

Një çështje që trajton një problematikë në zonën gri të trafikimit, në kryqëzim të fushave të ligjit, mund të ofrojë një mundësi për të mësuar më thellë. Për shembull, dallimi midis shkeljes së të drejtës së punës dhe trafikimit për skllavëri apo punë të detyruar.

4.7 FOKUSI TEK TENDENCAT E FENOMENIT NË VEND¹⁴

Fokusimi tek tendencat e fenomenit në vend mund t'i ndihmojë profesionistët në punën e tyre të përditshme që të identifikojnë më mirë rastet e trafikimit. Disa shembuj për këto tendencat mund të jenë shfrytëzimi për: lypje të detyruar, veprimtari kriminale, shërbime seksuale, shërbime të detyruara pranë një familjeje dhe puna e detyruar, të cilat mund të ndodhin në kontekstin e një martesë të detyruar në familje rome dhe egjiptiane, birësim të paligjshëm kur shoqërohet me shfrytëzim. Kjo mund të përfshijë edhe metoda tipike të kontrollit nga trafikantët si paraqitja si partner për lidhje romantike, trafikimi me anë të një anëtarit të familjes, premtime të rreme për martesë, arsimim dhe punësim, krijimi i varësisë së viktimës ndaj alkoolit dhe drogave. Po ashtu, të rëndësishme janë edhe llojet tipike të vulnerabilitetit, qofshin ato të natyrës fizike, psikologjike, emocionale apo kulturore. Disa shembuj janë grupet e pakicave (si komunitetet rome dhe egjiptiane), migrantët, personat me aftësi të kufizuara, njerëzit me histori familjare problematike, persona me lidhje emocionale me trafikantët, njerëzit pa rrjete mbështetëse, femrat, fëmijët apo të rinjtë.

4.8 FOKUSI TEK TRAFIKIMI ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN PËR PUNË?

Vërejmë se pjesa më e madhe e rasteve të ndjekura penalisht dhe të gjykuara në Shqipëri kanë të bëjnë me trafikimin për shfrytëzim seksual,¹⁵ më shumë se sa trafikimi për shfrytëzim për punë. Kjo mund të shërbejë për të favorizuar rastin e trafikimit për qëllime shfrytëzimi për punë (përfshirë lypjen e detyruar) për të theksuar ekzistencën e kësaj forme dhe për t'i ndihmuar profesionistët që të hetojnë, ndjekin penalisht dhe të gjykojnë si duhet këto raste.

¹⁴ Shih dokumentin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për Tipologjinë dhe Analizën e Rasteve nga UNODC-ja, si dhe Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, që të gjitha të cituara më parë.

¹⁵ Shih Tipologjinë e OSBE-së dhe Analizën e Rastit të UNODC-së, që të dyja të cituara më parë.

5. PJESA TEORIKE E TRAJNIMIT

Trajnimi me anë të një gjyqi imitues duhet të nisë paraprakisht me prezantime të shkurtra teorike lidhur me problematikat dhe tendencat kryesore, në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit të mbështeten në të njëjtën bazë njohurish si dhe të jenë të pajisur për të trajtuar problematikat e gjyqit imitues. Duhet treguar kujdes që kjo pjesë e ushtrimit të përqendrohet në prezantime të shkurtra dhe interaktive, për të garantuar që pjesa më e madhe e trajnimit të jetë praktike.

5.1 PËRMBAJTJA

Natyrshëm lind pyetja se cilat tematika duhet të trajtohen gjatë pjesës teorike të trajnimit. Përgjigja është se ka tema themelore që duhet të trajtohen gjithmonë dhe tema opsionale që varen nga natyra e rastit që përbën thelbin e gjyqit imitues.

Cilat janë temat thelbësore?

» Elementet e veprës kriminale të trafikimit:

“veprimet”, “mjetet”, dhe “qëllimet e shfrytëzimit” me theks të veçantë tek mjetet e pashfaqura të kontrollit, të cilat nuk kërkojnë përdorim të forcës fizike dhe “qëllimet e shfrytëzimit” të renditura në dispozitat përkatëse të trafikimit në legjislacionin shqiptar, nën dritën e tendencave mbizotëruese lokale, për shembull: lypja e detyruar, shfrytëzimi për veprimtari kriminale, shërbimi shtëpiak i detyruar apo puna e detyruar në kuadër të martesave me detyrim, adoptimi i paligjshëm të shoqëruar me shfrytëzim.

» Si ta trajtojmë pëlqimin e viktimës:

A është i nevojshëm pëlqimi i viktimës sipas legjislacionit shqiptar? Si duhet të interpretohet sjellja e viktimës në këtë drejtim nga agjencitë ligjzbatuese dhe gjykatat?

» Trafikimi i fëmijëve dhe i personave të rritur:

Duhet të qartësohet dallimi midis tyre dhe çështja nëse trafikimi i fëmijëve brenda vendit përfshihet në legjislacionin shqiptar për trafikimin e fëmijëve, neni 128/b. Duhet të citohet Vendimi i Gjykatës së Lartë i cili unifikon praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit për trafikimin e fëmijëve edhe për trafikimin brenda vendit.¹⁶

» Pika tipike të forta dhe të dobëta lidhur me provat në çështjet e trafikimit:

Kjo është një temë kyçe, pasi çështja ngrihet dhe bie në bazë të provave. Një prej tematikave më të rëndësishme është dobësia në sjelljen dhe dëshminë e viktimës si edhe mënyra se si duhen trajtuar ato. Kjo tematikë mund të përfshijë nënçështje si:

¹⁶. Shih seksionin 4.4 për “Përfshirjen e çështjeve kyçe” në çështjen e përzgjedhur për gjyqin imitues, footnote 14 dhe Analiza e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Shqipëri [“Analysis of Albanian Trafficking in Persons Sections by the Light of Current Global Debates on Key Concepts in Trafficking”], përditësuar në qershor 2023.

» **Si ndikon trauma tek sjellja dhe dëshmia e viktimës:**

Kjo është një temë kyçe sepse shpesh në rastet e trafikimit zbatuesit e ligjit dhe gjykatat i pushojnë çështjet për shkak të asaj që duket të jetë një sjellje joracionale e viktimës, ndonëse kjo është rrjedhojë e traumës.

» **Ndikimi i stereotipeve dhe miteve për vlerësimin e besueshmërisë së viktimës:**

Këto mund të jenë stereotipe për gjininë, pakicat, migrantët, etnitë, fetë. Disa shembuj përfshijnë presupozimin se burrat e fortë nuk mund të trafikohen apo që migrantët janë të lumtur të punojnë për paga shumë të ulëta dhe të jetojnë në kushte minimale.

» **Vendi i mbrojtjes së viktimës:**

Tematika të rëndësishme përfshijnë rëndësinë e mbrojtjes së viktimës në të drejtën e tij/saj dhe si parakusht për ndjekje penale të suksesshme; hapat specifikë në dispozicion të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e viktimës;¹⁷ parimi i mosdënimit apo moskriminalizimit dhe se si mund të zbatohet ky parim në Shqipëri;¹⁸ rëndësia e dhënies së dëshmperblimit për viktimën;¹⁹ balanca që nevojitet midis mbrojtjes së viktimës dhe të drejtave të akuzuarit.

» **Udhëzime për dhënien e vendimit:**

Kjo është shumë e rëndësishme duke pasur parasysh dënimet e lehta që u janë dhënë trafikantëve, shprehur edhe në Raportet e Shteteve të Bashkuara për Trafikimin të viteve 2022 dhe 2023. Këto udhëzime mund të përfshijnë dëshmperblimin e viktimës si dhe të shpjegojnë rreziqet që lidhen me vendime dënimi të cilat nuk parashikojnë burgim. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar rasteve të bashkëpunimit të policisë në trafikim.

Ndërkohë, disa tema opsionale mund të përfshihen në varësi të çështjes që do të zgjidhet për gjyqin imitues. Disa shembuj përfshijnë sa më poshtë:

» **Dallimi midis kontrabandimit të migrantëve dhe trafikimit:** Kjo do të merrte rëndësi të veçantë sidomos në një rast që përfshin kontrabandimin përtej kufijve.

» **Lloje specifike të mbledhjes së provave:** Kjo mund të marrë rëndësi për ato raste që kanë prova të tilla dhe mund të përfshijnë gjurmimin financiar, prova nga media sociale, përgjimin, rregjistrimin;²⁰

» **Ndikimi i pozitës vulnerabël:** Llojet tipike të pozitës vulnerabël, qoftë fizike, psikologjike, emocionale apo kulturore, mund të bëjnë që viktimat të bien pre e trafikantëve dhe kjo mund të ketë ndikim negativ në trajtimin e tyre nga agjencitë ligjzbatuese. Pjesa më e madhe e rasteve të përzgjedhura për gjyqin imitues përfshijnë viktimat vulnerabël. Disa shembuj të pozitës vulnerabël të viktimave të trafikimit në Shqipëri përfshijnë: grupet e pakicave (si komunitetet

¹⁷ Shih për shembull nenin 31 të Udhëzimit për Mbrojtjen e Viktimave që parashikon se prokuroria është përgjegjëse për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të viktimës, që mund të përfshijë: shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë të viktimës me të akuzuarin në çdo fazë të procesit; paraqitjen e kërkesës për dhënien e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur; marrjen e masave për mbrojtjen fizike të viktimës. Gjithashtu, gjatë procesit gjyqësor, viktimat, me anë të avokatit mbrojtës, mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë për hapa mbrojtës si seancë me dyer të mbyllura apo dëshmim me anë të instrumenteve audio dhe audio-vizive (nenet 104, 340, 361 të Kodit të Procedurës Penale, neni 43 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur). Nëse rasti përfshin anëtarë të familjes, gjykata mund të nxjerrë urdhër mbrojtjeje në bazë të Ligjit për dhunën në familje.

¹⁸ Shih dokumentin me titull: The International Framework as it Relates to Albania [Moskriminalizimi: Kuadri ndërkombëtar në lidhje me Shqipërinë], përgatitur për Trajnimin e OSBE-së për gjyqin imitues, Tiranë 17-18 shkurt 2022.

¹⁹ Shih nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale, me parashikimet përkatëse për kthimin e pasurisë në kontekstin e procedimit penal. Rëndësia e kësaj teme vihet në dukje në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit nga 2023, i cili thekson se gjyqtarët shqiptarë duhet të trajnohen për dëshmperblimin në çështjet penale, pasi duket që ka një ngurrim për ta zbatuar atë në procedimet penale.

²⁰ Analiza e Rasteve e UNODC-së, cituar më herët, u referohet disa rasteve kur gjurmimi financiar dhe përgjimi i kanë forcuar rastet.

rome dhe egjiptiane), migrantët, personat me aftësi të kufizuar, njerëzit me histori familjare problematike, persona me lidhje emocionale me trafikantët, njerëzit pa rrjete mbështetëse, femrat, fëmijët apo të rinjtë.

- » **Metodat tipike të kontrollit nga trafikantët:** Fokusi duhet të jetë tek tendencat lokale mbizotëruese të reflektuara në çështjen e përzgjedhur, si: bashkëpunimi nga ana e familjarëve; bashkëpunimi nga ana e partnerëve romantikë; premtimet e rreme për martesë, arsimim ose punësim; shkaktimi i varësisë ndaj alkoolit ose drogës.
- » **Dallimi midis shkeljeve të legjislacionit të punës dhe trafikimit për skllavëri dhe punë të detyruar:** Kjo do të ishte me rëndësi për raste që lidhen me trafikimin që realizohen në kontekstin e punës.
- » **Dallimi midis prostitucionit dhe trafikimit:** Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2023 thekson se autoritetet shqiptare ngatërrojnë elementet e “shfrytëzimit për prostitucion” dhe trafikimit si dhe kanë prirje të zbatojnë akuza më të lehta që kërkojnë më pak burime dhe, që në mënyrë të gabuar, kërkojnë praninë e elementeve ndërkombëtare.
- » **Ndikimi i kulturës në rastet e trafikimit të personave:** Kjo do të ishte e rëndësishme veçanërisht në raste që kanë të bëjnë me viktimat e huaja ose viktimat nga grupe pakicash. Siç e thekson edhe raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2023, shpesh në rastet e shërbimeve të detyruara në familje dhe punën e detyruar në martesë të detyruara që përshijnë komunitetet rome dhe egjiptiane, nuk janë ngritur akuza sepse shihen si praktika dhe zakone kulturore tradicionale.
- » **Analiza ligjore e tendencave të veçanta të shfrytëzimit:** Në varësi të çështjes së përzgjedhur, prezantimi mund të trajtojë formën e veçantë të shfrytëzimit në atë çështje, për shembull: shfrytëzimin për punë, lypjen e detyruar, punën e fëmijëve, shërbimin e detyruar në familje, birësimin e paligjshëm i shoqëruar me shfrytëzim, veprimtari kriminale, shërbime të detyruara në familje ose punë të detyruar në kontekstin e martesës së detyruar.²¹

5.2 REFERENCAT

Pjesa teorike e aktivitetit trajnues duhet të përfshijë shpërndarjen e materialeve referuese ose të paktën përdorimin e materialeve referuese nga prezantuesit. Më poshtë jepen disa referenca teorike që mund të merren në konsideratë:

REFERENCA NDËRKOMBËTARE

Ndonëse referencat nga legjislacioni i brendshëm kanë rëndësi parësore për profesionistët shqiptarë, referencat ndërkombëtare janë gjithaq të rëndësishme. Duke qenë se legjislacioni shqiptar për trafikimin mbështetet në konventa ndërkombëtare si Protokollin dhe Konventa e Këshillit të Evropës, profesionistët duhet të njihen mirë me këto burime bazë, në mënyrë që të kuptojnë kontekstin e legjislacionit të tyre si dhe të jenë të informuar për t'i përdorur si ndihmesë për interpretim. Mund të përdoren gjithashtu edhe instrumente ndërkombëtare udhëzuese, të cilat mund t'i ndihmojnë profesionistët në zbatimin e legjislacionit shqiptar. Disa shembuj të këtyre referencave të rëndësishme ndërkombëtare janë:

²¹ Shih Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit 2023.

- » Protokoll i Palermos;
- » Konventa e Këshillit të Evropës;
- » Dispozitat Legjislative Model të UNODC-së kundër trafikimit të qenieve njerëzore [UNODC's Model Legislative Provisions against Trafficking in Persons];²²
- » Përmbledhja e rasteve të UNODC-së për çështjet e provave në rastet e trafikimit të personave [UNODC's Case Digest on Evidential Issues in Trafficking in Persons Cases (Case Digest)];²³
- » Përmbledhja e rasteve rajonale të UNODC-së për çështjet tipike në rastet e trafikimit të personave për Rajonin e Afrikës Jugore [UNODC's Regional Case Digest on Typical Issues in Trafficking in Persons Cases for the Southern African Region].²⁴
- » Baza e të dhënave e UNODC-së për praktikën gjyqësore;²⁵
- » Një përmbledhje e sfidave të përgjigjeve ligjore ndaj trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzimin për punë në rajonin e OSBE [OSCE's "A summary of challenges facing legal responses to human trafficking for labour exploitation in the OSCE region"];²⁶
- » Rekomandimet legjislative e politikat e OSBE-së në drejtim të zbatimit efektiv të dispozitës së mosdënimit në lidhje me viktimat e trafikimit [OSCE's "Policy and legislative recommendations towards the effective implementation of the non - punishment provision with regard to victims of trafficking"];²⁷



Theksojmë se trajnuesit duhet të bëjnë përpjekje të posaçme për t'i njohur pjesëmarrësit me përmbledhjen e çështjeve të UNODC-së (Case Digest)²⁸ pasi gjatë argumenteve dhe dhënies së vendimit do t'u duhet të citojnë çështje. Ky përmbledhës analizon 135 çështje nga 31 juridiksione. Në varësi të çështjes që përbën bazën e gjyqit imitues, trajnuesit duhet t'i referojnë pjesëmarrësit seksionet përkatëse në çështje.

Gjithashtu, theksojmë se nuk është e domosdoshme që të përdoren të gjitha burimet e sipërcituara. Ato ofrohen vetëm si mundësi.

²². Gjetet në: https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2020/TIP_ModelLegislativeProvisions_Final.pdf

²³. Gjetet në https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2017/Case_Digest_Evidential_Issues_in_Trafficking.pdf

²⁴. Gjetet në: https://www.unodc.org/documents/southernafrica/Publications/CriminalJusticeIntegrity/TraffickinginPersons/Regional_Case_Digest_Southern_Africa_-_English.pdf

²⁵. Gjetet në https://sherloc.unodc.org/cld/v3/sherloc/cldb/search.html?lng=en#c=%7B%22filters%22:%5B%7B%22fieldName%22:%22en%23_el.caseLaw.crimeType_s%22,%22value%22:%22Trafficking%20in%20persons%22%7D%5D.%22sortings%22:%22%22%7D

²⁶. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/0/5/24342.pdf>

²⁷. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/6/101002.pdf>

²⁸. Cituar më parë.

REFERENCA NGA LEGJISLACIONI I BRENDSHËM:

- » Nenet 110a, 110b, 110c dhe 128b të Kodit Penal (lidhur me trafikimin dhe me veprat penale që lidhen me të);
- » Neni 7(d) i Kodit Penal (lidhur me veprat penale të trafikimit të kryera nga shtetas të huaj);
- » Neni 52a i Kodit Penal; nenet 24(2) dhe 328(d) të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 14 dhe 55e të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (lidhur me moskriminalizimin);
- » Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;
- » Kodi i Punës, në veçanti nenet 8, 11, 98-101;
- » Kushtetuta, në veçanti nenet 26, 116, 112(1) (2);
- » Mekanizmi Kombëtar i Referimit i Shqipërisë dhe Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit;
- » Plani kombëtar për luftën kundër trafikimit të personave;
- » Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Kodi i Procedurës Penale për hapat për mbrojtjen e viktimës.
- » Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr 5, datë 26/10/2018 “Për garantimin e asistencës për viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale”;
- » Ligji për Dhunën në Familje ;
- » Ligji Nr 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- » Çështje shqiptare trafikimi²⁹;
- » Dokumente të përgatitura për qëllime të gjyqit imitues të realizuar në shkurt 2022;
 - » “Analiza e parashikimeve shqiptare të veprave penale të trafikimit të personave nën dritën e debateve aktuale globale mbi konceptet kyçe të trafikimit”;
 - » “Moskriminalizimi: kuadri ndërkombëtar që lidhet me Shqipërinë”;

5.3 INSTRUMENTET

Instrumentet që do të përdoren gjatë pjesës teorike të aktivitetit trajnues duhet të jenë në përputhje me parimet e të nxënit në moshë të rritur.³⁰ Ato duhet të jenë ndërvepruese, të mundësojnë “të mësuarit nëpërmjet veprimit”, të nxisin punë të pavarur nga ana e pjesëmarrësve, të marrin parasysh përvojën e tyre profesionale, të mundësojnë përdorimin e mënyrave të ndryshme të të nxënit, si dhe të kujdesen që ta vendosin theksin tek ato çështje që kanë lidhje me temën.

²⁹ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 00-2022- 1679, datë 27.07.2022; Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 03.2011 (ndryshuar me Vendimin unifikues të mësipërm); Vendimi Nr. 44, datë 02.07.2012, Gjykata e Apelit për Krimeve të Rënda; Vendim Nr. 555, datë 03.12.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë; Vendim Nr. 72, datë 23.10.2008, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda; Vendim Nr. 5, datë 17.01.2008, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda; Vendim Nr. 31, datë 14.06.2007, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda për të pandehurin E.M dhe Vendimi Nr. 47, datë 23.10.2007, Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda për të pandehurin E.M; Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr.40, datë 22.11.2011. Çështje nga jurisprudenca e GJEDNJ-së përfshijnë: Siliadin k. Francës, 2005, Rantsev k. Qipros dhe Rusisë, M. dhe të tjerë k. Italisë dhe Bullgarisë, J. dhe të tjerë k. Austria, <https://hudoc.echr.coe.int/eng/-/f%22itemid%22:%22001-145315%22>]Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë, V.F. k. Francës, S.M. k. Kroacisë.

³⁰ Shih seksionin 1 “Hyrja” për një shtjellim të këtyre parimeve.

Më poshtë është një listë joshteruese e instrumenteve që mund të përdoren:

- » **Leksione të shkurtra** të ndërputura me punën ndërvepruese;
- » **Prezantuesë që kanë profil në disa disiplina** me përvojë praktike për të ofruar njohuri të larmishme dhe praktike. Mund të përfshihet një i mbijetuar nëse ai apo ajo janë emocionalisht në gjendje që të veprojnë pa pasur pasoja traumatike. Në këtë drejtim, para se të përfshihet një i mbijetuar si prezantues këshillohet që kjo të konsultohet me një profesionist.
- » Përqëndrimi tek **prezantuesit shqiptarë ose nga rajoni** për të përshkruar legjislacionin lokal, praktikën gjyqësore, çështje dhe tendenca për t'u siguruar që gjithçka të ketë lidhje me realitetin.
- » **Filma dhe opsione të tjera mediatike** si nxitës të diskutimit.
- » **Aktivitete të shkurtra ushtrimore** për të praktikuar zbatimin e njohurive të fituara si dhe për të rritur larminë e leksioneve.
- » **Raste studimore** që mund të kalojnë nga më i thjeshti tek më i ndërlikuari.³¹ Theksojmë se rastet studimore mund të bazohen në çështje aktuale, fiktive, apo të ndërthurura. Zbatohen të njëjtat konsiderata si ato të përshkruara në seksionin 4.1 të këtij manuali ku trajtohet "Si të zgjedhim çështjen për gjyqin imitues - çështje aktuale, fiktive, apo të ndërthurura". Një shembull për një rast studimor jepet në Shtojcën 3.
- » **Rolet** u lejojnë pjesëmarrësve të ushtrojnë aftësitë duke luajtur role të ndryshme në një situatë të inskenuar. Këto role mund të jenë për shembull ato të profesionistëve të sektorit penal si hetues të policisë, prokurorë, gjyqtarë, ose role joligjore si ai i një viktime. Për më shumë informacione dhe shembuj, e referojmë lexuesin tek Manuali i UNODC-së për gjyqin imitues. Në lidhje me rolet duhet treguar kujdes pasi rrezikojnë që të shihen si të një rangu më të ulët për pjesëmarrësit e niveleve të larta ose ata që vijnë nga profesione prestigjioze, si gjyqtarët. Prandaj, ky instrument duhet konsultuar me ekspertët dhe profesionistët para se të vihet në përdorim.
- » Pajisja e pjesëmarrësve me **tableta dhe kopje të printuara** me informacione dhe pyetje për të shmangur humbjen e kohës dhe theksimin e natyrës vetjake të ushtrimeve.
- » Kërkesa për pjesëmarrësit që të punojnë me **modulet e-learning**, ose para ose gjatë trajnimit.
- » Paketa me karta ku ka deklarata dhe/ose fotografi që nxisin diskutime. Fotografitë mund të pasqyrojnë situata ose stereotipe për trafikimin. Deklarimet mund të jenë citime nga rastet ose nga profesionistët; ose fjali që shprehin një qasje, stereotip ose mit mbi trafikimin. Ideja mund të realizohet edhe duke shpërndarë shënime, por pjesëmarrësit mund të angazhohen më shumë nëse paketa me kartat dizajnohet në mënyrë të ngjashme me formatin e letrave që përdoren për lojë.

Deklaratat duhet të jenë të shkurtra, sa t'i nxejë një format karte, dhe duhet të nxisin diskutime (brainstorming) për shembull:

- » "Një burrë i fortë dhe i sigurt në vete nuk mund të trafikohet";
- » "Viktima: unë e dashuroj të dyshuarin, ai është i vetmi që është kujdesur për mua."
A duhet ta mbyllë kjo gjë çështjen?;
- » "Nëse shfrytëzimi nuk u realizua në të vërtetë, kjo nuk mund të përbëjë trafikim";

³¹ Një shembull mund të jetë prezantimi i një çështjeje për shfrytëzim për punë ku viktima nuk është paguar fare dhe është kërcënuar dhe rrahur dhe më pas të vijohet në një skenar më pak të rëndë ku viktima nuk paguhet por trajtohet mirë, më pas kalohet te një skenar tjetër më tej ku ai apo ajo paguhet nën pagën minimale.

Fotografite mund të përdoren veçmas ose së bashku me tekstin. Ato mund të jenë në trajtën e skenave reale që janë fotografuar apo të vizatuara. Mund të përshkruajnë kushtet e jetesës si për shembull mbipopullimin, prezencë të brejtësve, papastërti, mungesë uji, apo lëndime të trupit të personit. Trajnuesi mund t'i pyesë pjesëmarrësit se si këto lidhen me trafikimin.

» ÇËSHTJE PËR DEBAT:

Duke marrë parasysh kulturën e debatit në Shqipëri, një instrument i mirë mund të jetë paraqitja e disa çështje polimizuese për debat dhe diskutim me qëllim që të dalin në sipërfaqe keqkuptime dhe stereotipe.

Disa shembuj përfshijnë sa më poshtë:

- » Nëse shfrytëzimi nuk u materializua në të vërtetë, kjo nuk mund të përbëjë trafikim.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Nëse viktimja ka pasur kontradikta me vetveten, çështja duhet të mbyllet.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Për të siguruar dënimin, mjafton të ketë një dëshmi të mirë nga ana e viktimës.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Legjislacioni shqiptar nuk e kriminalizon trafikimin e fëmijëve brenda vendit.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Një burrë i fortë nuk mund të jetë viktimë e trafikimit.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Meshkujt nuk mund të trafikohen për shfrytëzim seksual.
E vërtetë apo e gabuar ?
- » Personi nuk mund të trafikohet nga familjarët e vet.
E vërtetë apo e gabuar ?

5.4 LOJTARË TË RËNDËSISHËM

Lojtarë të rëndësishëm gjatë pjesës teorike të trajnimit janë anëtarët e ekipit trajnues dhe prezantuesit.

TRAJNUESIT

Trajnuesit mund të marrin disa përgjegjësi për prezantimin e sesioneve të ndryshme që kanë lidhje me ekspertizën e tyre. Megjithatë, si rregull, ata duhet të jenë në prapaskenë, dhe jo në qendër. Fokusi i tyre duhet të jetë udhëzimi. Kjo mund të përfshijë përzgjedhjen e tematikave, burimet dhe instrumentet, pas konsultimeve me ekspertët lokalë; rekrutimin e prezantuesve të përshtatshëm; monitorimin e ushtrimeve të ndryshme me qëllim vlerësimin e efektshmërisë së tyre; dhe ndërhyrjet për të theksuar rëndësinë e çështjes si edhe për të rikujtuar mesazhet kyçe. Ata duhet të shmangin qëndrimin didaktik dhe të përqendrohen tek dëgjimi dhe nxitja e të menduarit në mënyrë të pavarur.

PREZANTUESIT

Rekomandohet që të përdoren prezantues të ndryshëm me stile dhe aftësi të ndryshme. Preferohet që disa prej tyre të kenë përvojë praktike. Larmia e përvojave parandalon monotoninë dhe e hap mendjen e pjesëmarrësve për t'i parë çështjet në mënyra të reja.

Prezantuesit nuk duhet të flasin gjatë dhe duhet të shmangin leksionet e pastra para auditorit. Përkundrazi, duhet të përdorin instrumente ndërvepruese për të përfshirë pjesëmarrësit, si edhe ato të përmendura më lart. Duhet të përpiqen të përfshijnë njohuri si teorike edhe praktike.

Prezantues mund të jenë, për shembull, ekspertë të traumave me përvojë praktike për sjelljen dhe reagimet e viktimave; ekspertë të shërbimeve sociale dhe përvojë praktike në mbrojtjen e viktimave; prokurorë që janë marrë me çështje trafikimi; të mbijetuar, me kusht që të jetë marrë këshillë profesionale për t'u siguruar që janë në gjendje të dalin para një audience; ekspertë në legjislacionin dhe procedurat përkatëse në Shqipëri; ekspertë në tendencat, problematikat, praktikën gjyqësore dhe legjislacionin shqiptar për trafikimin; ekspertë ndërkombëtarë.

Programi që jepet si shembull në Shtojcën 1 mund të jetë i dobishëm për të planifikuar pjesën teorike të ushtrimit.

5.5 PJESA TEORIKE E NJË GJYQI IMITUES NË VERSION TË SHKURTUAR

Edhe nëse vendoset të zhvillohet një gjyq imitues i shkurtuar, pjesa teorike është thelbësore në mënyrë që pjesëmarrësit të pajisen me atë që u nevojitet për të trajtuar problematikën e çështjes si edhe për të pasur një nivel të përbashkët njohurish. Megjithatë, duke marrë parasysh kufizimet, kohëzgjatja mund të jetë më e shkurtër se sa në një gjyq imitues i plotë. Edhe nëse zgjidhjet kjo alternative, prezantuesit duhet të përdorin gjithsesi metodat ndërvepruese dhe jo leksione didaktike.

6. PREZANTIMI HYRËS NGA MODERATORI DHE CAKTIMI I ROLEVE

6.1 ÇFARË DUHET TË PËRFSHIJË PREZANTIMI I MODERATORIT?

Për të përgatitur kontekstin për trajnimin, moderatori duhet të prezantojë qëllimet, fazat e procedimit, rolet për pjesëmarrësit, si dhe çfarë pritet prej tyre përgjatë çdo faze (periudha e përgatitjes; gjyqi imitues; dhe diskutimet përmbledhëse debriefing).

Nëse është vendosur që prokurorët do të hartojnë aktakuzën,³² moderatori duhet ta përfshijë këtë detyrë në përshkrimin e rolit të prokurorëve. Ai ose ajo mund të japë edhe mundësinë e hartimit të opinionëve të pakicës për pjesëmarrësit që do të luajnë rolin e gjyqtarëve.

Parimet kryesore të këtij prezantimi duhet të bazohen në rregullat bazë të shkruara, në mënyrë që pjesëmarrësit t'u referohen atyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit trajnues. Rregullat bazë jepen si shembull në Shtojcën 2 të këtij manuali.

Rregullat bazë dhe prezantimi duhet të përfshijnë edhe rregulla të rëndësishme, për shembull, afatin kohor; devijime të mundshme nga procedura penale në interes të të mësuarit, apo të kursimit të kohës dhe dhënies së roleve më aktive për pjesëmarrësit;³³ leje për paraqitjen e provave të caktuara me marrëveshje ndërmjet palëve për të kursyer kohë; fokusimin tek pretendimet dhe kundërshtimet që kanë lidhje me thelbin, dhe jo tek ato të natyrës procedurale, në interes të të mësuarit.

Moderatori duhet t'i njoftojë pjesëmarrësit se seanca e gjykimit imitues ndryshon nga procedura e zakonshme penale dhe ky informacion i rëndësishëm duhet të shfaqet në rregullat bazë. Disa shembuj të shmangieve që do të jenë gjithmonë të pranishme jepen më poshtë:

- » **Nuk do të lejohet asnjë deklaram, kundërshtim apo kërkesë procedurale,**³⁴ në mënyrë që pjesëmarrësit të fokusohen tek të mësuarit për sfidat tipike të rasteve të trafikimit të personave. Duhet theksuar se trajnimi nuk ka për qëllim të përmirësojë aftësitë e përgjithshme në sallën e gjyqit, por t'u japë pjesëmarrësve aftësi, dhe, në veçanti, të kuptojnë trajtimin e rasteve të trafikimit të personave. Për shembull, pjesëmarrësit nuk do të paraqesin kërkesa procedurale paraprake sipas nenit 354 të Kodit të Procedurës Penale.

³² Shih seksionin 3.13 për "Planifikimin e hartimit të aktakuzës" për më shumë hollësi mbi avantazhet dhe disavantazhet që prokurorët të hartojnë aktakuzën gjatë periudhës përgatitore.

³³ Disa shembuj mund të jenë si lejimi i të gjithë pjesëmarrësve të jenë të pranishëm në gjykatë përgjatë gjithë kohës, në interes të të mësuarit, pavarësisht nga ndalimi i pranisë për dëshmitarët kur dëshmojnë dëshmitarët e tjerë; pasja e një grupi gjyqtarësh në vend të një gjyqtari në interes të ndarjes së roleve aktive për më shumë pjesëmarrës; përfshirja e rolit për avokatin mbrojtës të viktimës, megjithëse nuk është plotësisht e qartë se si mund të zhvillohet roli i tij ose i saj, pasi legjislacioni që e rregullon atë nuk është specifik.

³⁴ Shih Manualin e UNODC-së për gjyqin imitues, seksioni 7.1 "Për hyrjen nga moderatori".

Siç e theksuan dy profesionistë gjatë një takimi të grupit të ekspertëve të organizuar nga UNODC-ja:



“Ne të gjithë priremi të theksojmë atë që dimë, në vend që të eksplorojmë terrene të reja. Ndaj pjesëmarrësit mund të priren t’u kthehen njohurive të tyre procedurale në vend që të përballojnë çështje të reja tipike për rastet e trafikimit. Duhet hartuar rregullat bazë për ta shmangur këtë problem.”

Lejimi i pretendimeve dhe kundërshtimeve procedurale do t’i shmangë pjesëmarrësit nga çështjet kryesore dhe të mësuarit prej aktivitetit.”³⁵

- » **Shqyrtimi gjyqësor nuk do të përfshijë hetimin paraprak apo seancën paraprake**³⁶ edhe pse këto janë pjesë e procedurës së zakonshme penale shqiptare. Prandaj, kërkesa për dëmshpërblimin e viktimës e cila sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me seancën paraprake, duhet të paraqitet në fillim të seancës së gjyqit imitues.
- » **Të gjithë pjesëmarrësit do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së seancës** – edhe pse procedura e rregullt penale dikton që dëshmitarët të mos jenë të pranishëm kur japin dëshminë dëshmitarët e tjerë. Kjo bëhet në interes të të mësuarit.

6.2 CILAT JANË ROLET?

Para caktimit të roleve, moderatori duhet t’u sqarojë pjesëmarrësve se cilat role janë në dispozicion të tyre.

Teorikisht, në pjesën më të madhe të gjyqeve imituese janë të pranishme rolet e mëposhtme. Megjithatë, u takon trajnerëve të vendosin se cilat nga këto role duhet të luajnë pjesëmarrësit dhe cilat do të luhen nga të tjerët, siç diskutohet më tej në këtë pjesë të manualit.

- » **Rolet të karakterit ligjor:**
Çdo gjyq imitues përfshin rolet kryesore të prokurorëve, avokatëve mbrojtës dhe gjyqtarëve. Role të tjera me natyrë ligjore mund të përfshijnë mbrojtësin e viktimave, pavarësisht nëse viktimat janë të rritur apo të mitur.³⁷
- » **Rolet që nuk kanë karakter ligjor:**
Përveç roleve me natyrë ligjore, sirregull, gjyqet imituese (përveç atyre të shkurtuara)³⁸ përfshijnë edhe rolet e viktimave, të të pandehurve, dëshmitarëve (përfshirë edhe ekspertët nëse është rasti).

³⁵. Këto mendime u shprehën në një takim të grupit të ekspertëve të thirrur nga UNODC më 9-10 mars 2023 për të rishikuar një draft të manualit të gjyqit imitues nga UNODC. Theksojmë se janë parafrazime të asaj që u tha.

³⁶. Kështu, ndryshimet e vitit 2017 në Kodin e Procedurës Penale, të cilat përcaktuan rolet e gjyqtarit në hetimin paraprak dhe të gjyqtarit të seancës paraprake, nuk do të jenë pjesë e ushtrimit të gjyqit imitues, në interes të fokusimit tek çështjet thelbësore që lidhen me trajtimin e rasteve të trafikimit.

³⁷. U referohemi neneve 58, 59, 61 të Kodit të Procedurës Penale, neneve 23, 24, 34, 36 të Kodit të Drejtësisë për të Miturit, neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nenit 23 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, 2018.

³⁸. Shih seksionin 3 mbi “Vendimet e planifikimit - lloji i gjyqit imitues” për një shpjegim të dallimit midis një gjyqi të plotë imitues dhe një versioni të shkurtuar.

Më poshtë jepen disa çështje që lidhen me ndarjen e roleve për pjesëmarrësit:

6.2.1 SI TË SIGUROHENI QË SECILI PJESËMARRËS KA NJË ROL AKTIV

Është shumë e rëndësishme të sigurohet që secili pjesëmarrës ka një rol aktiv, në mënyrë që ta përmbajtësojë dhe maksimizojë të mësuarit. Nëse nuk ka mjaftueshëm role të disponueshme, trajnerët mund t'i shtojnë ato, duke përdorur opsionet e mëposhtme:

» **Vënia në dispozicion e roleve të karakterit joligjor për profesionistët:**

Nëse ka shumë pak role ligjore aktive, mund të vihen në dispozicion rolet joligjore në mënyrë që çdo praktikues të luajë një rol aktiv, si për shembull: rolet e viktimës, të pandehurit dhe dëshmitarët, përfshirë dëshmitarët ekspertë. Megjithatë, shihni nënseksionin tjetër për më shumë në lidhje me këtë çështje.

» **Ekipet e profesionistëve:**

Trajnuesit mund të caktojnë një trupë gjyqtarësh, edhe nëse procedura penale cakton një gjyqtar, për sa kohë e sqarojnë që kjo është shmangie nga procedura penale në interes të të mësuarit. Gjithashtu, mund të caktojnë një ekip prokurorësh dhe një ekip me avokatë mbrojtës. Ky opsion ka vlerën e shtuar të inkurajimit të bashkëpunimit midis anëtarëve të trupës gjyquese apo të ekipit.

» **Më shumë se një i pandehur/viktimë:**

Nëse është vendosur që pjesëmarrësit do të luajnë rolin e të pandehurit dhe viktimës, trajnerët mund të marrin në konsideratë përfshirjen e 2 ose më shumë të pandehurve dhe viktimave. Arsyet kryesore për këtë opsion përshkruhen në seksionin 4 të këtij manuali "Si të zgjidhni çështjen për gjyqin imitues". Gjithashtu, kështu mund të përfitohet duke ofruar më shumë role aktive për pjesëmarrësit.

» **Vëzhguesit profesionistë:**

Në disa gjyqe imituese, për t'u dhënë role aktive sa më shumë pjesëmarrësve, trajnerët kanë zgjedhur të caktojnë edhe rolin e vëzhguesit profesionist. Ky rol përfshin vëzhgimin e seancës nga këndvështrimi se çfarë shkoi mirë dhe çfarë jo. Një vëzhgim i tillë mund të ketë të bëjë me boshllëqet në legjislacion, praktikën gjyqësore, mosrespektimin e hapave për mbrojtjen e viktimave, problemet me skenarin e rastit, krahas aspekteve që funksionuan mirë. Këta pjesëmarrës më pas mund të thirren të flasin të parët gjatë diskutimit përmbyllës në grup (debriefing).

6.2.2 KUSH DUHET TË LUAJË ROLE ME KARAKTER JOLIGJORE (PJESËMARRËSIT? TRAJNUESIT? AKTORËT? PERSONA QË KANË QËNË TË TRAFIKUAR?)

Në disa gjyqe imitues, pjesëmarrësit kanë ndërmarrë jo vetëm role ligjore profesionale si prokuror, avokat mbrojtës, gjyqtar apo avokat mbrojtës i viktimës, por edhe role të tjera si viktimë, i pandehuri, dëshmitarë dhe dëshmitarë ekspertë. Në gjyqe të tjera imituese, pjesëmarrësit kanë ndërmarrë vetëm role ligjore, dhe rolet joligjore janë realizuar nga trajnerë, aktorë ose të mbijetuar. Për secilin opsion ka avantazhe dhe disavantazhe:

PJESËMARRËSIT – avantazhe dhe disavantazhe:

Nga njëra anë, kur luajnë vetëm role ligjore, pjesëmarrësit i përmirësojnë drejtpërdrejt aftësitë e tyre profesionale, ndërsa kur luajnë role joligjore kjo nuk ndodh. Për më tepër, pjesëmarrësit mund të jenë të rezervuar që të luajnë role joligjore dhe t'i shohin këto si më të ulët se statusi i tyre. Kjo mund të ndodhë sidomos në rastin e pjesëmarrësve nga gjyqësori. Nga ana tjetër, ndonjëherë rolet joligjore i ndihmojnë pjesëmarrësit të njohin përvojat e dëshmitarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë, emocionet e tyre, duke mundësuar në këtë mënyrë përvetësim më të mirë të procesit. Kjo merr rëndësi të veçantë në rastin e pjesëmarrësve që luajnë rolin e viktimës.

Në një gjyq imitues,³⁹ një gjyqtar që luante rolin e viktimës u tha trajnuesve se ai kurrë më parë nuk i kishte kuptuar vështirësitë e dëshmisë për abuzimin seksual në gjykatë, derisa e luajti vetë këtë rol. Ndonëse i mësuar me mjedisin gjyqësor, e kishte të vështirë të fliste për çështje seksuale në një proces të hapur në gjykatë. Kjo i la atij një përshtypje të veçantë, e cila e ndihmoi të brendësonte më mirë vulnerabilitetin e viktimave nga sa do ta kishte ndihmuar leximi i burimeve të ndryshme.

Nëse trajnuesit vendosin t'i caktojnë këto role për pjesëmarrësit, ata duhet të përpiqen të maksimizojnë të mësuarit duke shpërndarë një përshkrim të roleve, së bashku me burime të cilat trajtojnë çështjet tipike që lindin ndërkohë që luhen këto role. Për shembull, pjesëmarrësi që luan viktimën duhet të marrë burime që trajtojnë dobësitë tipike në dëshminë dhe sjelljen e viktimës. Për shembull shërbejnë seksionet 2.2.1 dhe 3.3.6 të Përmbledhësit të rasteve të UNODC-së.⁴⁰

AKTORËT – avantazhe dhe disavantazhe:

Në disa gjyqe imituese, aktorët kanë marrë rolet e dëshmitarëve, të viktimave dhe të të pandehurve. Avantazhi i kësaj qasjeje është se u mundëson pjesëmarrësve të fokusohen tek rolet profesionale ligjore që mund të rrisin aftësitë e tyre profesionale. Gjithashtu, aktorët e shkolluar për role mund të jenë më të besueshëm se trajnuesit ose pjesëmarrësit e patrajnuar dhe më të aftë për të shkaktuar reagime emocionale. Disavantazhi është se aktorët duhet të trajnohen për temën e trafikimit, t'u jepen skenarë në mënyrë që të realizojnë rolet si edhe të trajnohen nga trajnuesit, duke vënë kështu një barrë të shtuar mbi këta të fundit. Përveç kësaj, aktorët mund t'i shtojnë shpenzimet e këtij aktiviteti trajnues.

TRAJNUESIT – avantazhe dhe disavantazhe:

Në disa gjyqe imituese, trajnuesit kanë marrë rolet e dëshmitarëve, të viktimave dhe të të pandehurve. Kjo ka avantazhin që u mundëson pjesëmarrësve të fokusohen në rolet profesionale ligjore dhe nuk kërkon shpenzime për punësimin e aktorëve. Po ashtu, duke qenë se trajnuesit i njohin mirë çështjet tipike të trafikimit, nuk kanë nevojë për prezantim, skenar apo trajnim. Nga ana tjetër, duke qenë se nuk janë aktorë të shkolluar për këtë, mund të jenë më pak të besueshëm dhe më pak të aftë për të shkaktuar emocione nga ana e pjesëmarrësve.

³⁹ Kjo u zhvillua në një gjyq imitues të organizuar nga UNODC me pjesëmarrës nga gjyqësori në Sri Lanka, në shkurt 2020.

⁴⁰ Cituar më parë.

TË MBIJETUARIT – avantazhe dhe disavantazhe:

Mund të përfshihen edhe të mbijetuarit për të luajtur rolin e viktimës. Megjithatë, duhet pasur kujdes për të vlerësuar forcën emocionale të të mbijetuarit si dhe vullnetin e tij apo të saj për të marrë pjesë, pas konsultimit me profesionistë. Nga njëra anë, pjesëmarrja e të mbijetuarve mund të shtojë besueshmërinë dhe të sjellë një përvetësim më të mirë nga ana e pjesëmarrësve të eksperiencës si viktimë. Më tej, një pjesëmarrje e tillë mund ta fuqizojë të mbijetuarin nëse ai ose ajo është emocionalisht gati. Por, nga ana tjetër, nëse viktimë nuk është emocionalisht e aftë të përballojë këtë lloj ekspozimi, mund t'i shkaktojë shqetësim akut emocional dhe të çojë në vuajtje, madje edhe në dështimin e ushtrimit.

Nisur nga sa më lart, për të vendosur se kush do të luajë rolin e dëshmitarëve, të viktimave dhe të të pandehurve, trajnuesit duhet të vlerësojnë avantazhet dhe disavantazhet parë nga karakteristikat e pjesëmarrësve dhe kontekstit të tyre kulturor.

6.2.3 A DUHET QË PJESËMARRËSIT TË LUAJNË ROLET E VETA PROFESIONALE APO TË LUAJNË ROLET TË TJERA NGA ATO NË JETËN REALE?

Të dyja opsionet janë zbatuar në gjyqe imituese në mbarë botën. Secili opsion ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Avantazhi i të luajturit të rolit të vet profesional:

Kur pjesëmarrësit luajnë rolet e veta profesionale, kjo mund të përmirësojë më mirë aftësitë e tyre profesionale, ndërsa kur luajnë role të tjera nuk ka një efekt të tillë të drejtpërdrejtë.

Avantazhet e të luajturit të roleve të tjera:

Nga ana tjetër, kur pjesëmarrësit luajnë role të të tjerëve, ata mund të shohin nga këndvështrime të reja si dhe të pasurojnë trajtimin e rasteve. Gjithashtu, kjo mund të shërbejë si sinjal për sfidat me të cilat përballen specialistët e profesioneve të tjera dhe t'i ndihmojë ata për të kuptuar më mirë rëndësinë e punës së tyre dhe vështirësive të tyre të veçanta. Kjo mund të çojë edhe në një bashkëpunim më të mirë në të ardhmen ndërmjet specialistëve të profesioneve të ndryshme.

6.3 SI DUHET TË NDAHEN ROLET?

Pas prezantimit, dhe pasi trajnuesit të kenë vendosur se cilat role do të vihen në dispozicion të pjesëmarrësve, moderatorit duhet të caktojë këto role. Kjo mund të bëhet si më poshtë:

Caktimi i roleve:

Ndërkohë që caktimi i roleve mund të sigurojë që pjesëmarrësit me më shumë njohuri dhe më dominues të marrin role qendrore, një gjë e tillë mund të nxisë ndjesi diskriminimi dhe të shkaktojë pakënaqësi dhe ndasi tek pjesëmarrësit, duke ndikuar në klimën e besimit dhe bashkëpunimit, që janë tejet të rëndësishme për suksesin e aktivitetit.

Caktimi i roleve në mënyrë rastësore me short duke tërhequr fletën me rolin nga një vazo:

Kjo ka avantazhin që nxit një ndjenje barazie midis pjesëmarrësve dhe rrit klimën e bashkëpunimit dhe besimin. Gjithashtu, krijon atmosferë informale argëtimi, e cila mund të nxisë më tej të mësuarit. Për më tepër, u jep mundësinë atyre pjesëmarrësve që kanë qenë disi më të rezervuar gjatë pjesës teorike të aktivitetit, që të jenë më aktivë në rolet e tyre. Megjithatë, me këtë alternativë mund të mos

kemi një përputhje optimale mes pjesëmarrësve dhe roleve si dhe nuk u ofron pjesëmarrësve ndjesinë e zgjedhjes.

Mundësia që pjesëmarrësit të ofrohen si vullnetarë:

Ashtu si edhe ndarja rastësore, kjo metodë ofron një ndjesi barazie dhe krijon një klimë bashkëpunimi dhe besimi. Gjithashtu, u jep pjesëmarrësve mundësinë që të rriten në rolet e tyre, edhe nëse janë treguar më të rezervuar gjatë fazave të mëparshme. Për më tepër, ka edhe një përfitim tjetër të rëndësishëm sepse nxit ndjesinë e të pasurit të mundësisë së zgjedhjes nga ana e pjesëmarrësve. Megjithatë, ashtu si në rastin e ndarjes rastësore të roleve, mund të rezultojë në një situatë ku pjesëmarrësit dhe rolet që do të luajnë të mos përputhen në mënyrën më të mirë.

6.4 ADRESIMI I ROLEVE TË VËZHguesve PROFESIONISTË NË VEÇANTI:

Moderatori duhet t'u sqarojë atyre që do të luajnë rolin e vëzhguesve profesionistë natyrën e roleve përgjatë fazave të ndryshme: periudha përgatitore; seanca; dhe diskutimet përmbledhëse (debriefing). Duke u ndalur në periudhën përgatitore, ata duhet t'i ndajnë këta pjesëmarrës në 3 grupe, ku secili shoqëron gjyqtarin, prokurorin ose ekipin e mbrojtjes. Roli i tyre do të jetë OSE të vlerësojnë se çfarë funksionoi mirë dhe çfarë duhet përmirësuar në përgatitjen e secilit grup, OSE mund të shoqërojnë përgatitjen e secilit grup dhe të marrin detyra brenda tij, megjithëse nuk do t'i luajnë ato role gjatë seancës. Këtyre pjesëmarrësve mund t'u shpërndahen pyetje udhëzuese që ata të kuptojnë më mirë rolet e tyre.

6.5 ÇFARË MATERIALESH DUHET T'U SHPËRNDAHEN PJESËMARRËSVE?

Që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të përgatisin rastin, moderatori duhet të shpërndajë materialet e mëposhtme në këtë fazë të aktivitetit:

» Rregullat bazë:

Këto përshkruajnë fazat e aktivitetit; rolet; si dhe çfarë pritet nga ata që luajnë rolet gjatë secilës fazë. Ato duhet të përfshijnë edhe rregulla thelbësore që ofrojnë një kornizë për aktivitetin, si respektimi i kohës; kufizimi i kundërshtimeve në ato që kanë të bëjnë me thelbin dhe jo me provat apo procedurat;⁴¹ vënia në dukje e devijimeve nga procedura penale vëndase, nëse këto janë të pranishme, si për shembull se hetimi paraprak dhe seanca paraprake nuk do të jenë pjesë e aktivitetit;⁴² nënvizimi i provave që mund të paraqiten me pëlqim; shpjegimi deri në çfarë mase pjesëmarrësit mund ta zbukurojnë rastin.

Në mënyrë që rregullat bazë të jenë koncize dhe të përshtatshme për t'u përdorur, pa informacione që lidhen vetëm me disa prej pjesëmarrësve, nuk është e nevojshme të përfshihet në to përshkrimi i të gjitha roleve. Trajnuesit mund të përgatisin dhe të shpërndajnë një përshkrim të veçantë të secilit rol për ata që do ta realizojnë.

⁴¹. Shih seksionin 6.1 mbi "Çfarë duhet të përfshijë prezantimi i moderatorit" për një shpjegim të detajuar mbi rëndësinë e ndalimit të kërkesave për (pa)fajësinë, pretendimet dhe kërkesat procedurale dhe pse gjyqi imitues nuk do të përfshijë fazat paraprake të gjykimit penal, si hetimi paraprak dhe seanca paraprake.

⁴². Shembuj të tjerë janë: të gjithë pjesëmarrësve mund të jenë të pranishëm gjatë gjithë seancës së gjyqit imitues, edhe pse ligji kërkon që dëshmitarët të mos jenë të pranishëm kur japin dëshmi dëshmitarët e tjerë; prokurori ose mbrojtësi i viktimës paraqesin një kërkesë për dëshmipërbllim në fillim të seancës dhe jo gjatë seancës paraprake siç parashikon neni 62 i Kodit të Procedurës Penale; çështja gjykohet nga një trup gjykues, edhe pse sipas ligjit, çështjet e trafikimit pa elementë të krimit të organizuar gjykohen nga një gjyqtar; ndarje e roleve specifike për avokatin mbrojtës të viktimës, megjithëse ende nuk është plotësisht e qartë se si mund të zhvillohet roli i tij ose i saj, pasi legjislacioni që e rregullon atë nuk është specifik.

Natyrisht, mund t'u shpërndahet trajnuesve edhe një version më i detajuar i rregullat bazë. Shembuj të rregullave bazë, përfshirë përshkrimet e roleve për pjesëmarrësit mund të gjenden në Shtojcën 2.

» **Dokumente të kontekstit:**

Këtu përfshihet një skenar për rastet; një listë e roleve dhe dëshmime; një listë e burimeve. Shih Shtojcën 4 për një shembull të skenarit të rasteve.

» **Dokumente gjyqësore dhe provat:**

Këtu përfshihet aktakuza (përveçse kur është vendosur që t'i lejohet ekipit të akuzës ta përgatisë); deklaratat e viktimave; deklaratat e të pandehurit nëse të pranishme; deklaratat e dëshmitarëve; opinion ekspertit, nëse është i rëndësishëm për rastin; dokumentet që do të dorëzohen si provë nga prokuroria;⁴³ sendet fizike që do të dorëzohen si provë nga prokuroria.⁴⁴ Shih Shtojcën 5 për shembuj të provave që mund të përdoren.

» **Materialet teorike:**

Këto duhet të synojnë t'u ofrojnë pjesëmarrësve mjetet për të formuluar një strategji dhe për të mbështetur pretendimet ose vendimin e tyre, duke cituar legjislacionin dhe praktikën gjyqësore. Ndonëse mbivendosen me burimet e përshkruara në seksionin 5.2 "Burime të rëndësishme" që do të përdoren gjatë pjesës teorike, në këtë rast këto duhet të jenë më të shkurtra dhe të fokusuara, pasi pjesëmarrësit nuk do të kenë kohë të lexojnë shumë materiale duke pasur parasysh kohën e kufizuar. Thënë këtë, ato duhet të përfshijnë:

REFERENCAT KRYESORE NDËRKOMBËTARE:

- » Protokoli i Palermos;
- » Seksionet përkatëse të Përmbledhësit të Rasteve nga UNODC-ja;⁴⁵

REFERENCAT KRYESORE NË LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM:

- » Nenet 110a, 110b, 110c dhe 128b të Kodit Penal (për trafikimin dhe me krimet që lidhen me të);
- » Nenet përkatëse në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Kodin e Procedurës Penale dhe Udhëzimin për Mbrojtjen e Viktimave, që trajtojnë hapat e mbrojtjes për viktimat;⁴⁶
- » Çështje shqiptare trafikimi;

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM QË KA LIDHJE ME ÇËSHTJEN:

- » Neni 7(d) i Kodit Penal për krimet e trafikimit të kryera nga shtetas të huaj;
- » Neni 52a i Kodit Penal; Nenet 24(2) dhe 328(d) të Kodit të Procedurës Penale dhe Nenet 14 dhe 55e të Kodit të Drejtësisë për të Mitur për moskriminalizimin;
- » Nenet përkatëse të Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në rastin e një viktime ose autori në moshë të mitur;
- » Nenet përkatëse të Kodit të Punës dhe veçanërisht nenet 8, 11, 98-101, nëse rasti ka të bëjë me trafikim për shfrytëzim për punë;
- » Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në veçanti nenet 26, 116, 112(1) (2);

⁴³ Shembuj janë certifikatat e lindjes, pasaportat, kontratat, lejet e punës, komunikimet në mediet sociale, mesazhet telefonike.

⁴⁴ Shembuj janë prezervativët, armët, veglat, pajisjet, paratë e shënuara, fotografitë, gjurmët e drogës ose të barutit.

⁴⁵ Cituar më parë.

⁴⁶ Shih shënimin 18 në fund të faqes për të parë shembujt.

6.6 HYRJA NGA MODERATORI DHE NDARJA E ROLEVE NË NJË GJYQ IMITUES NË VERSION TË SHKURTUAR

Nëse vendoset për një version të shkurtuar të gjyqit imitues, duhet të realizohet gjithsesi një hyrje nga moderatori dhe një shpërndarje e roleve. Por këto duhet të jenë më të shkurtra në kohë dhe të vetmet role që do të ndahen do të jenë ato të gjyqtarit, prokurorit, dhe avokatit mbrojtës, të cilët paraqesin më pak problematika. Çështje që mbeten janë: si të bëhet ndarja e roleve të tjera; si të sigurohet që t'u jepen role aktive sa më shumë pjesëmarrësve; si dhe nëse pjesëmarrësit aktivë duhet të këmbëjnë rolet apo të luajnë rolet e veta profesionale. Mund të vendoset që të përfshihet roli i vëzhguesve profesionistë në mënyrë që të caktohen role aktive për më shumë pjesëmarrës. Në versionin e shkurtuar të gjyqit imitues materialet që do të shpërndahen janë të njëjta me ato të versionit të plotë. Megjithatë, rregullat bazë do të jenë më pak të detajuara. Ashtu si në një gjyq imitues në version të plotë, rregullat bazë duhet të përfshijnë ndalime për marrëveshje fajësie, parashtrimin e kërkesave të tjera procedurale, si dhe të vihet në dukje që fazat paraprake të procesit penal si hetimi paraprak dhe seanca paraprake nuk do të përfshihen.

7. PERIUDHA E PËRGATITJES

7.1 HYRJE: (PËRFSHIRË DETYRA TË PËRGJITHSHME, AFATIN KOHOR, RËNDËSINË E MENTORIMIT)

Pas ndarjes së roleve dhe shpërndarjes së materialeve, pjesëmarrësve duhet t'u jepet koha e duhur për të përgatitur rastin. Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të dinë se çfarë detyrash duhet të kryejnë gjatë kësaj faze. Kjo mund të ndihmohet me rregulla të shkruara bazë ose dokumente të veçanta që përshkruajnë secilin rol dhe detyrat e tij në këtë fazë. Disa komponentë thelbësorë të periudhës së përgatitjes janë:

» Detyra të përgjithshme:

Të gjithë pjesëmarrësit duhet të studiojnë rregullat bazë, dokumentet bazë, dokumentet gjyqësore, provat dhe materialet teorike si dhe të identifikojnë problematikat që shfaqen në çështje. Ata duhet të kryejnë edhe detyrat specifike të roleve të tyre, sipas përshkrimit në seksionin 7.2 të këtij manuali.

» Shtrirja kohore:

Kjo është një fazë vendimtare, pasi përbën bazën e seancës së gjyqit imitues që do të vijojë më pas. Për nga rëndësia që ka, duhet të caktohet kohë e mjaftueshme, mundësisht 2 orë e gjysmë deri në 3 orë. Megjithatë, nëse zgjidhet një gjyq imitues version i shkurtuar, ku akuza dhe mbrojtja paraqesin argumente pro dhe kundër dënimit dhe më pas vendos gjyqtari, siç përshkruhet në seksionin 3.3 të këtij manuali, periudha e përgatitjes mund të jetë më e shkurtër, pasi nuk do të kërkojë përgatitjen e strategjisë ose të dëshmitarëve për seancë.

» Rëndësia e mentorëve:

Kjo fazë kërkon praninë fizike të mentorëve në çdo kohë. Ata mund të jenë trajnues, prezantues, profesionistë anëtarë të profesioneve të pjesëmarrësve, ose ekspertë me përvojë në gjyqë imituese. Detyra e tyre është t'u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve; të vëzhgojnë grupet e ndryshme për të parë që janë të fokusuar në detyrat në fjalë; të japin udhëzime në mënyrë proaktive nëse është e nevojshme; të kujtojnë pjesëmarrësit se nuk duhet të lënë pas dore studimin e materialeve teorike në mënyrë që të jenë në gjendje të citojnë raste dhe legjislacion për të mbështetur pretendimet e tyre; dhe t'i referojnë te materialet përkatëse. Mentorët duhet të përpiqen të arrijnë një baraspeshë midis ndihmës për pjesëmarrësit me shqetësime reale dhe pavarësisë në përgatitjen e tyre.

» Ritheksimi i rregullave që kanë të bëjnë me ndalimin e pretendimeve dhe deklarimeve procedurale dhe fushëveprimin të kufizuar të seancës së gjyqit imitues:

Mentorët duhet të ritheksojnë njoftimin që moderatorët duhet t'u japin pjesëmarrësve se seanca e gjyqit imitues do të jetë ndryshe nga procedura e zakonshme penale për faktin që nuk do të ketë kërkesa procedurale, kundërshtime ose pretendime. Për më tepër, ata duhet të

ritheksojnë edhe se seanca nuk do të përfshijë hetimin paraprak ose seancën paraprake. Shih seksionin 6.1 mbi “Çfarë duhet të përfshijë hyrja e moderatorit” për më shumë detaje mbi këtë pikë.

7.2 DETYRAT SPECIFIKE TË SECILIT PJESËMARRËS

Gjatë kësaj faze, të gjithë pjesëmarrësit duhet të lexojnë rregullat bazë, dokumentet që paraqesin kontekstin, dokumentet gjyqësore, provat dhe materialet teorike që u janë shpërndarë. Gjithashtu, çdo pjesëmarrës që ka një rol duhet të realizojë detyrat që i përshtaten rolit që ka. Më poshtë jepet një përshkrim se çfarë duhet të bëjë secili pjesëmarrës, përtej leximit të të gjitha materialeve përkatëse:

GJYQTARËT

Në rastin e një trupi gjykues, ata duhet të zgjedhin një kryetar që do të drejtojë seancën gjyqësore dhe duhet të konsultohen gjatë gjithë kësaj faze në mënyrë që të pasurojnë përvojën e të mësuarit dhe të diskutojnë në thellësi për provat, legjislacionin dhe praktikën gjyqësore. Më tej, ata duhet të marrin në konsideratë mundësinë e opinionëve të pakicës dhe të shumicës, në përfundim të çështjes.

Pavarësisht nëse është një gjyqtar apo një trup gjykues, gjyqtari pasi të ketë lexuar në thellësi dokumentet e gjykatës dhe materialin teorik duhet të përpiqet të identifikojë çështjet që kanë të bëjnë me thelbin dhe provat, duke treguar vëmendje për rastet që mund të përdorin në vendim, pasi do t'u duhet të citojnë të paktën 2 raste trafikimi në gjykimin e tyre. Duhet të marrin në konsideratë edhe rolin e tyre në seancë, duke përfshirë hapat për mbrojtjen e viktimës⁴⁷ dhe dëmshpërblimin e mundshëm të saj, nëse akuza ose pala mbrojtëse e viktimës paraqesin një kërkesë për këtë në fillim të seancës.

PROKURORËT

- » **Përgatitja e vendimit të “njoftimit të akuzës” nëse trajnuesit kanë vendosur se duhet përgatitur nga pjesëmarrësit:** Nëse trajnuesit kanë vendosur që prokurorët duhet të hartojnë vendimin për “njoftimin e akuzës”, prokurori ose ekipi i prokurorëve duhet ta bëjnë menjëherë, në mënyrë që ta shpërndajnë sa më shpejt te të gjithë pjesëmarrësit. Nëse vendimi për “njoftimin e akuzës” do të jetë i gatshëm, ata duhet të mbështeten tek ky tekst dhe të vazhdojnë me realizimin e detyrave të tjera.
- » **Detyrë e posaçme për ekipin e prokurorëve:** Nëse ka një ekip prokurorësh, ata duhet të ndajnë punën midis tyre.
- » Pavarësisht nëse është **një ekip apo një prokuror i vetëm**, në çdo rast duhet të realizohen detyrat e mëposhtme:
 - » **Formulimi i një strategjie:** Prokurorët duhet të formulojnë një strategji bazuar në pikat e forta dhe të dobëta të çështjes. Kjo do të përfshijë se çfarë duhet theksuar në pyetjet e dëshmitarëve të vet ose të palës tjetër si dhe në argumentet përmbyllëse.
 - » **Puna përgatitore:** Prokurorët duhet të përgatisin dëshmitarët e akuzës për seancën; të

⁴⁷ Shih seksionin 5.1 mbi “Përmbajtjen” gjatë pjesës teorike të aktivitetit, shënimi nr 17 që përfshin shembuj të hapave të mbrojtjes së viktimës.

përgatisin pyetjet për dëshmitarët e tyre dhe ata të palës tjetër; të përgatisin kërkesat për hapat e mbrojtjes për viktimën nëse e gjykojnë të nevojshme, pas konsultimit me viktimën;⁴⁸ të përgatisin një kërkesë për dëmshpërblimin e viktimës, pas konsultimit me viktimën, nëse ata e gjykojnë të përshtatshme⁴⁹; të hartojnë argumente përfundimtare duke trajtuar elementët e veprës penale, çështje të thelbit dhe të provave, duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi, si dhe kërkesa të përgjithshme mbi dënimin, duke përfshirë dëmshpërblimin e viktimës në rast se konkludohet me një dënim.

PËRFAQËSUESIT E MBROJTJES

- » Detyrë e posaçme për ekipin e përfaqësuesve të mbrojtjes: Nëse ka një ekip mbrojtjeje ata duhet të ndajnë punën midis tyre.
- » Pavarësisht nëse është një përfaqësues i vetëm apo një ekip mbrojtjeje, në çdo rast duhet të realizohen detyrat e mëposhtme:
 - » Të vendosin për një strategji: Kjo duhet të bëhet në konsultim me të pandehurin duke përfshirë: nëse i pandehuri duhet të deklarohet dhe nëse po – a duhet të deklarohet fajtor apo i pafajshëm; çfarë deklarimesh të tjera do të donte i pandehuri të bënte në gjykatë; nëse zgjidhet versioni që i pandehuri të heshtë, të paraqesin një deklaratë që nuk do i nënshtrohet marrjes në pyetje nga pala tjetër apo të dëshmojë; nëse do të kërkohet nga gjykata që të lejohet dëshmia e dëshmitarëve shtesë të mbrojtjes (nëse e lejon koha); nëse do të paraqiten prova dokumentare ose fizike (nëse e lejon koha).
 - » Puna përgatitore: Pala mbrojtëse duhet të përgatisë prova shtesë nëse kanë vendosur që t'i paraqesin, por duke konsideruar që gjyqtari(ët) mund të mos e lejojnë këtë për shkak të kufizimeve kohore. Këto prova mund të përfshijë dëshmitarë, dokumente dhe/ose sende fizike. Nëse zgjedhin të sjellin dëshmitarë shtesë, do të duhet të zgjedhin dikë që do të luajë rolin e dëshmitarit. Gjatë kësaj faze, duhet të përgatisin edhe dëshmitarët e tyre për seancë (të pandehurin dhe çdo dëshmitar tjetër që zgjedhin të sjellin); të përgatisin marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe atyre të palës tjetër; të përgatisin pretendimet e mundshme në lidhje me hapat e mbrojtjes së viktimës, në rast se prokuroria i kërkon; të përgatisin argumentet përfundimtare duke trajtuar elementët e krimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me aspektet materiale të ligjit dhe me provat duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi; të hartojnë kërkesat për dënimin nëse gjykata jep vendim dënimi.

⁴⁸ Për shembuj të hapave për mbrojtjen e viktimës, shihni seksionin 5.2 mbi "Përmbajtjen" e pjesës teorike, shënimi footnote 18.

⁴⁹ Sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale, kjo kërkesë duhet të paraqitet gjatë seancës paraprake. Megjithatë, meqë trajnimi nuk e përfshin këtë fazë dhe duke pasur parasysh rëndësinë e temës së dëmshpërblimit, akuzat duhet ta paraqesin këtë kërkesë në fillim të seancës.

AVOKATËT E VIKTIMAVE⁵⁰

Avokatët e viktimave duhet të lexojnë me kujdes hapat e mbrojtjes së viktimës në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (nëse viktimja është e mitur) dhe Kodin e Procedurës Penale si dhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 05, datë 26.10.2018 “Për garantimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale”;⁵¹ të takohen me viktimën që përfaqësojnë për të diskutuar hapat që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e viktimës si dhe kërkesat që duhet të paraqiten; të konsultohen me prokurorin se kush do t’i paraqesë këto kërkesa; si dhe të marrin në konsideratë paraqitjen e një kërkesë në fillim të seancës për dëmshpërblim për viktimën, pasi konsultimit me palën e akuzës.⁵²

DËSHMITARËT E AKUZËS (PËRFSHIRË VIKTIMËN/VIKTIMAT)

Të gjithë këta dëshmitarë: duhet të takohen me prokurorin/prokurorët për t’u përgatitur për seancën, të lexojnë me kujdes deklaratat e tyre para policisë; të lexojnë seksionet përkatëse të Përmbledhësit të Rasteve të UNODC-së me qëllim që ta vendosin dëshminë e tyre në kontekstin e duhur.⁵³

Viktima: Sidomos pjesëmarrësi që luan viktimën, duhet të diskutojë edhe me prokurorin dhe/ose avokatin e viktimës mbi hapat e mundshëm të mbrojtjes së viktimës dhe për kërkesën e mundshme për dëmshpërblim.

Aktorët: Nëse është vendosur që rolet e dëshmitarëve të akuzës t’i luajnë aktorë, këta duhet ta shfrytëzojnë këtë periudhë edhe për të studiuar skenarët.

I PANDEHURI DHE DËSHMITARËT E MBROJTJES

Të gjithë këta dëshmitarë: duhet të takohen me avokatët mbrojtës përkatës për t’u përgatitur për gjykim, të lexojnë me kujdes deklaratat e tyre para policisë; të studiojnë seksionet përkatëse të Përmbledhësit të Rastit të UNODC-së.⁵⁴

I pandehuri: duhet të takohet me avokatët mbrojtës për të diskutuar strategjinë dhe për të tjera, për shembull: a duhet të bëjë deklaratë? Nëse po, a duhet të deklarohet fajtor apo i pafajshëm? A dëshirojnë të paraqesin deklaratat të mëtejshme gjatë procedimit? A duhet të dëshmojnë? A duhet të paraqiten prova shtesë për të mbështetur çështjen e tyre?

Aktorët: Nëse është vendosur që këto role t’i luajnë aktorët, ata duhet ta shfrytëzojnë këtë periudhë edhe për të studiuar skenarët.

⁵⁰ Ndonëse ky profesionist figuron në nene të ndryshme të legjisllacionit që ka të bëjë me viktimat e mitura dhe të rritura, nuk është plotësisht e qartë nëse u janë dhënë kompetencat që të marrin pjesë vetëm në procedimet paraprake dhe në seancën e parë apo përgjatë gjithë procedimit penal dhe çfarë funksionesh përmbush. Mund të argumentohet se këta avokatë mund t’i paraqesin gjykatës çdo kërkesë në emër të viktimës, përfshirë edhe kërkesat për masa mbrojtëse. Shih nenet 58, 59, 61 të Kodit të Procedurës Penale, neneve 23, 24, 34, 36 të Kodit të Drejtësisë për të Miturit, neneve 11 dhe 12 të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nenit 23 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, 2018. Prandaj, roli, siç përshkruhet më sipër, mund të mos jetë në përputhje me praktikën që do të zhvillohet dhe funksionet e përshkruara më lart janë dhënë vetëm për qëllimin e gjyqit imitues. Kjo duhet të vihet në dukje nga moderatori gjatë prezantimit hyrës dhe të shfaqet në rregullat bazë.

⁵¹ Shih seksionin 5.1 mbi “Përmbajtjen” gjatë pjesës teorike, shënimin 18 që përfshin shembuj të hapave të mbrojtjes së viktimave të nxjerra nga këto burime.

⁵² Kjo kërkesë bazohet në nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale, i cili kërkon që ajo të paraqitet gjatë seancës paraprake. Duke qenë se gjyqi imitues nuk e përfshin këtë fazë paraprake dhe nisur nga rëndësia e çështjes së dëmshpërblimit, sugjerojmë që kërkesa të paraqitet në fillim të seancës së gjyqit imitues. Kjo është një shmangie nga procedura penale dhe kjo duhet theksuar në rregullat bazë si dhe në hyrjen që prezanton moderatori.

⁵³ Cituar më parë. Për shembull, dëshmitarët e viktimave duhet të lexojnë seksionet 2.2 dhe 3.3.6 të Përmbledhësit të Rasteve; dëshmitarët e tjerë duhet të lexojnë seksionin 2.3.

⁵⁴ Cituar më parë. Për shembull seksioni 2.3 i Përmbledhësit të Rasteve.

DËSHMITARËT EKSPERTË

Nëse vendoset që të dëshmojë një ekspert, në vend të ekspertizës me shkrim, ai ose ajo duhet të takohet me avokatët që kërkuan mendimin e tij për t'u përgatitur për gjykim. Si rregull, do të jetë akuza, megjithëse edhe mbrojtja mund të marrë parasysh marrjen e një eksperti. Eksperti duhet të lexojë me kujdes opinionin e vet dhe mund të lexojë edhe seksionin 2.6 të Përmbledhësit të Rastit të UNODC-së⁵⁵ mbi "Dëshminë e ekspertit dha atë profesionale" për t'u njohur me kontekstin për dëshminë e ekspertit në përgjithësi.

VËZHguesIT PROFESIONISTË

Nëse vendoset të caktohet edhe roli i vëzhguesve profesionistë, pjesëmarrësit që luajnë këtë rol mund të ndahen në 3 grupe para periudhës përgatitore, ku secili do të vëzhgojë gjyqtarët, prokurorët ose avokatët mbrojtës përkatësisht gjatë kësaj faze të aktivitetit, në mënyrë që të vlerësojnë cilësinë e përgatitjes, çfarë ishte e dobishme dhe çfarë mund të përmirësohet. Si alternativë, ata mund të marrin pjesë në përgatitjen e këtyre 3 grupeve, edhe pse nuk do t'u luajnë role gjatë seancës.

7.3 MJEDISI FIZIK

Nëse është e mundur, është e rëndësishme që ekipet ligjore (akuza, mbrojtja dhe gjyqtarët) si dhe dëshmitarët e tyre të jenë në salla të veçanta ose në zona të veçanta të një salle të madhe, me qëllim që të kenë mundësi ta përgatiten për çështjen veçmas.

7.4 PERIUDHA E PËRGATITJES NË NJË GJYQI IMITUES NË VERSION TË SHKURTUAR

Edhe në versionin e shkurtuar të gjyqit imitues duhet të ketë gjithsesi një periudhë përgatitore, por ajo mund të jetë më e shkurtër se sa në versionin e plotë të gjyqit imitues. Gjithashtu, aktorët e vetëm janë gjyqtarët; prokurorët dhe avokatët mbrojtës dhe ndoshta edhe vëzhguesit profesionistë. Çfarë pritet prej tyre do të varet nga kohëzgjatja dhe nga fakti që nuk ka marrje në pyetje të dëshmitarëve dhe paraqitje të provave.

Kështu, gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës nuk do të kenë nevojë të mendojnë për hapat e mbrojtjes së viktimave; prokurorët nuk do të kenë nevojë të hartojnë strategji për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet ose të palës tjetër apo të përgatisin dëshmitarët e tyre për gjykim. Në mënyrë të ngjashme, avokatët mbrojtës nuk do të kenë nevojë të vendosin për strategjinë në konsultim me të pandehurin. Për më tepër, as nuk do të kenë nevojë të përgatisin dëshmitarët për gjykim apo të përgatisin marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet apo të palës tjetër. Nëse e lejon koha, mund t'u lejohet të përgatisin dokumente shtesë, të kenë sende fizike ose deklarata të dëshmitarëve shtesë gjatë periudhës së përgatitjes. Megjithatë, kjo mund të sjellë ndërlikime, pasi do t'u duhet t'ua shpërndajnë këto dëshmi pjesëmarrësve të tjerë sa më shpejt, në mënyrë që atyre t'u mundësohet kohë e mjaftueshme për t'u përgatitur, dhe kjo mund të mos jetë e mundur në një kohë të kufizuar. Roli i vëzhguesve profesionistë do të jetë i ngjashëm me atë në një version të plotë të gjyqit imitues.

⁵⁵. Cituar më parë.

8. SEANCA

Seanca është pjesa qendrore e aktivitetit, gjatë së cilës pjesëmarrësit do të vënë në zbatim njohuritë e fituara. Për këtë, gjyqtarët që drejtojnë seancën duhet të tregohen vigjilentë e të garantojnë që ekipet e akuzës dhe të mbrojtjes fokusohen në çështje që kanë të bëjnë me thelbin dhe provat dhe jo në ato të natyrës procedurale. Gjithashtu, kryetari i trupit gjykues duhet të sigurojë respektimin e kuadrit kohor. Lexoni seksionin 8.2, i cili përshkruan rolin e kryetarit të trupit gjykues.

8.1 FAZAT E SEANCËS

Për të kursyer kohë dhe për të krijuar rregull, në vijim jepet një procedurë e sugjeruar për gjyqin imitues. Theksojmë se modeli kapërcen disa faza procedurale për shkak të kufizimeve kohore, të cilat duhet të përmenden në rregullat bazë.⁵⁶

1. FILLIMI I ÇËSHTJES:

Kryetari i trupit gjykues shpall të hapur seancën gjyqësore. Më pas, ai lexon emrat e të pandehurve dhe akuzat ndaj secilit prej tyre, duke iu referuar neneve 110/a dhe/ose 128/b të Kodit Penal, sipas rastit. Gjyqtari informon të pandehurin për të drejtën e tij për të bërë ndonjë deklaratë gjatë seancës së gjykimit dhe më pas i pandehuri, nëse dëshiron, deklarohet për fajësinë ose pafajësinë e tij.

2. PROVAT E PALËS SË AKUZËS:

Kryetari i trupit gjykues më pas i kërkon akuzës të paraqesë provat.

Prokurori ose avokati mbrojtës i viktimës dorëzon një kërkesë për dëmshpërblimin e viktimës, nëse e dëshiron një gjë të tillë.⁵⁷

Prokurori ose avokati mbrojtës i viktimës i paraqesin gjykatës kërkesa për hapat e mbrojtjes së viktimës, nëse është menduar si e përshtatshme.

Prokurori paraqet provat e tij, të cilat konsistojnë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve të prokurorisë për të nxjerrë në pah historitë e tyre, dhe dorëzimin e provave dokumentare dhe fizike, në varësi të rastit.

Mbrojtja merr në pyetje dëshmitarët e akuzës të cilëve mund t'u bëhen pyetje edhe nga gjyqtari.

3. KAZUSI I MBROJTJES:

Ecuria e çështjes së mbrojtjes do të varet nga strategjia që do të vendoset gjatë periudhës përgatitore:

- » Nëse i pandehuri **vendos të heshtë**, mbrojtja mund të paraqesë prova të tjera ose jo.
- » Nëse i pandehuri **dorëzon një deklaratë për qëndrimin në heshtje**, ai nuk do të merret në pyetje as nga njëra palë e as nga tjetra.

⁵⁶. Fazat që janë hequr përfshijnë hetimin paraprak dhe seancën paraprake.

⁵⁷. Sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale, paraqitja e kësaj kërkesë gjatë seancës paraprake është e detyrueshme. Megjithatë, duke qenë se gjyqi imitues nuk do të përfshijë fazat paraprake të procedurës penale, kjo kërkesë duhet të parashtrohet në fillim të seancës.

- » Nëse i pandehuri **zgjedh të dëshmojë** – avokati mbrojtës i tij i bën pyetje për të nxjerrë në pah historinë e tij dhe akuza e merr në pyetje nga ana e saj ndërkohë që pyetje mund të bëjnë edhe gjyqtarët.
- » **Prova të tjera të mbrojtjes:** Nëse mbrojtja ka vendosur që të sjellë dëshmitarë të tjerë dhe/ose të dorëzojë prova dokumentare ose fizike, kjo mund të bëhet nëse u lejohej nga gjyqtarët, me kushtin që të jetë brenda kufizimit kohor. Akuza mund të marrë më pas në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes.

4. ARGUMENTET PËRMBYLLËSE:

Pas përfundimit të dëshmisë nga dëshmitarët e mbrojtjes, akuza dhe avokatët mbrojtës paraqesin argumentet përmbyllëse, duke u mbështetur në të paktën 2 çështje trafikimi si dhe duke trajtuar elementët e veprës penale dhe çështjet që lidhen me thelbin dhe provat. Kryetari i trupit gjykues mund të kufizojë kohën për paraqitjen e argumenteve përmbyllëse.

Në rast se kufizimet kohore nuk lejojnë kërkesa të ndara në lidhje me dënimin, akuza paraqet pretendimet e saj për dënimin, në rast se i pandehuri do të dënohet. Edhe avokatët mbrojtës mund të trajtojnë kërkesat për dënimin në rast se klienti i tyre dënohet.

HARTIMI I VENDIMIT (paraprirë nga një pushim)

» Puna për hartimin e vendimit:

Pas argumenteve përmbyllëse, bëhet një pushim për t'u mundësuar gjyqtarëve të hartojnë vendimin, duke u mbështetur në të paktën 2 çështje trafikimi dhe duke trajtuar elementët e veprës penale si dhe çështjet që kanë të bëjnë me aspekte të themelit dhe provave. Nëse çështja po gjykohet nga një ekip gjyqtarësh, ata këshillohen dhe kryetari i trupit gjykues harton vendimin. Mund të ketë edhe opinione të pakicës që hartohen nga gjyqtarët që e kanë këtë opinion i cili mund të jetë në të njëjtin vendim ose mund të jetë me vete.

» Çfarë duhet të përfshijë vendimi?

Nëse koha lejon që palët të paraqesin secila më vete argumentat përmbyllëse si më sipër vendimi kufizohet në dhënie dënimi ose pafajësie (nëse i pandehuri dënohet). Nëse koha nuk e lejon një gjë të tillë, atëherë gjykata harton vendimin dhe dënimin nëse vendos që të ketë dënim. Vendimi mund të përfshijë dëmshpërblimin e viktimës nëse prokurori ose avokati mbrojtës i viktimës kanë paraqitur kërkesë për dëmshpërblim në fillim të seancës.

» Leximi i vendimit:

Vendimi lexohet me zë të lartë nga kryetari i trupit gjykues, nëse gjykimi bëhet nga një trupë gjyqtarësh. Nëse jo, gjyqtari i vetëm e lexon vendimin me zë të lartë. Nëse ka opinion të pakicës, gjyqtari i pakicës e lexon gjithashtu me zë të lartë.

» Kërkesat e veçuara për dënimin dhe vendimi:

Nëse e lejon koha, akuza dhe mbrojtja deklarojnë gojarisht kërkesat për dënimin nëse i pandehuri dënohet. Gjyqtarët më pas shpallin vendimin për dënimin që mund të përfshijë edhe dëmshpërblimin e viktimës, nëse akuza ose avokati mbrojtës i viktimës e kanë paraqitur një kërkesë të tillë në fillim të seancës. Nëse nuk ka kohë, gjyqtarët shpallin vendimin së bashku me dënimin, nëse do të jetë një vendim me dënim, siç u përmend më sipër.

8.2 FAZAT E SEANCËS SË GJYQIT IMITUES NË VERSION TË SHKURTUAR

Siç u përmend në seksionin 3.3 të këtij manuali, ndonjëherë kufizimet kohore diktojnë zbatimin e një versioni të shkurtuar i gjyqit imitues, ku akuza dhe mbrojtja paraqesin argumente pro dhe kundër dënimit dhe gjyqtari vendos. Nëse zgjidhet ky variant, faza e seancës mund të kufizohet si më poshtë:

- » Leximi i akuzës.
- » Deklarimi i fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit nga avokati mbrojtës, nëse vendosin ta bëjë një gjë të tillë.
- » Kërkesa për dëmshpërblimin e viktimës nga akuza, nëse i pandehuri dënohet.
- » Argumente me gojë nga ana e akuzës dhe palës mbrojtëse, duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi si dhe duke trajtuar elementë të veprës penale dhe çështje që kanë të bëjnë me thelbin dhe provat. Nëse është e mundur të paraqiten argumenta përfundimtare të veçanta për dënimin për shkak të kufizimit kohor, palët i përfshijnë këtu edhe kërkesat për dënimin, në rast se i pandehuri dënohet. Gjyqtarët mund të parashirojnë pyetje gjatë debatit me gojë.
- » Bëhet një pushim për t'u përgatitur për vendimin.
- » Leximi i vendimit që mbështetet në të paktën 2 raste trafikimi dhe trajton elementët e veprës penale dhe çështjet që lidhen me thelbin dhe me provat, ku anëtarët e trupit gjykues (nëse është më shumë se një gjyqtar) janë të lirë të shkruajnë edhe opinionet e pakicës. Nëse nuk e lejon koha që të paraqiten argumenta përfundimtare të veçanta në lidhje me vendimin, kjo do të pasohet menjëherë nga dhënia e një vendimi i cili mund të përfshijë edhe dëmshpërblimin e viktimës nëse prokurori ose avokati mbrojtësi viktimës e ka paraqitur një kërkesë të tillë në fillim të seancës.
- » Nëse koha e lejon - argumenta përfundimtare të veçanta mbi dënimin nga akuza dhe mbrojtja.
- » Dhënia e dënimit nga gjykata që mund të përfshijë dëmshpërblim për viktimën nëse prokurori ose avokati mbrojtës i viktimës e kanë paraqitur një kërkesë të tillë në fillim të seancës.

8.3 ÇFARË PRITET TË BËJNË PJESËMARRËSIT NË ROLET E TYRE GJATË SEANCËS?

Më poshtë jepet një përshkrim i asaj që duhet të bëjnë pjesëmarrësit në rolet e tyre, gjatë fazës së seancës së gjyqit imitues në një version të plotë. Theksojmë se të gjithë pjesëmarrësve duhet t'u jepet një përshkrim i hollësishëm me shkrim për atë që pritët prej tyre, i përfshirë në rregullat bazë ose në përshkrime të veçanta të roleve për secilin prej tyre.

» GJYQTARËT

Të gjithë gjyqtarët: mund të bëjnë pyetje kur dëshmitarët janë duke u përgjigjur; mund t'u bëjnë pyetje ekipeve të akuzës ose mbrojtjes; parandalojnë ngacmimin e dëshmitarëve; vendosin për hapat e mbrojtjes së viktimës, të tillë si mbajtja e seancës me dyer të mbyllura ose lejimi i një dëshmitari të frikësuar për të dhënë dëshminë pas një ekrani; konsultohen nëse lind një kundërshtim ose kërkesë e veçantë që kërkon një vendim dhe të vendosë për të; diskutojnë pas përfundimit të shqyrtimit të provave për vendimin dhe dënimin përfundimtar; përgatisin dhe japin një vendim i cili mbështetet në të paktën 2 raste trafikimi dhe analizon elementet veprës penale si dhe çështjet që lidhen me thelbin dhe provat. Në rastin kur ka një mendim të pakicës - ai duhet të përgatitet dhe të dorëzohet nga gjyqtari që është i këtij mendimi. Vendimi mund të përfshijë dëmshpërblimin e viktimave, përveç sanksioneve të tjera, nëse një gjë e tillë është kërkuar në fillim të seancës nga akuza ose avokati mbrojtës i viktimës.

Kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm: Krahas detyrave që kryejnë të gjithë gjyqtarët, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm drejton gjykimin në këto mënyra: hap seancën; lexon akuzat në fillim të seancës; informon të pandehurin për të drejtën e tij për të bërë ndonjë deklaratë gjatë zhvillimit të seancës; sigurohet që të respektohet afati kohor;⁵⁸ qëndron i gatshëm që të mos lejojë kundërshtime apo kërkesa për procedurë ose prova, përveç masave për mbrojtjen e viktimave; pyet të pandehurin nëse dëshiron të heshtë, të dëshmojë ose të paraqesë deklaratë në përfundim të provave të akuzës; konsultohet me gjyqtarët e tjerë për vendimin dhe dënimin, e harton atë me ndihmën e gjyqtarëve të tjerë dhe e shpall.

» PROKURORËT:

Gjatë seancës, akuza mundet të veprojë si më poshtë:

- » të paraqesë kërkesë për dëmshpërblimin e viktimës në fillim të seancës.
- » të paraqesë kërkesa për hapat e mbrojtjes së viktimave.⁵⁹

Akuza duhet që të veprojë si më poshtë:

- » të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës gjatë kohës që dëshmojnë për të nxjerrë në pah historitë e tyre.
- » t'i paraqesë gjykatës prova dokumentare dh fizike nëse ekzistojnë.
- » të marrë në pyetje të pandehurit nëse këta zgjedhin të dëshmojnë si dhe ndonjë dëshmitar shtesë të palës së mbrojtjes nëse sillen për dëshmi.
- » të paraqesë argumentet përmbyllëse duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi si dhe duke analizuar elementët e krimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me thelbin dhe provat.
- » të kërkojë një dënim të caktuar para marrjes së vendimit të gjykatës nëse ekzistojnë kufizime kohore, ose nëse koha e lejon në argumentat përmbyllës.

» PËRFAQËSUESIT E MBROJTJES:

Gjatë seancës, mbrojtja duhet të realizojë veprimet si vijon:

- » të marrë në pyetje dëshmitarët e prokurorisë.
- » të marrin në pyetje klientin e tyre, nëse ky zgjedh të dëshmojë.
- » mund t'i kërkojë gjykatës leje për paraqitjen e provave shtesë të mbrojtjes si për shembull dëshmitarë shtesë, prova dokumentare ose fizike, si dhe, nëse kërkesa e tyre pranohet, të marrë në pyetje dëshmitarë shtesë dhe të dorëzojë provat dokumentare ose fizike shtesë.
- » të paraqesë argumenta përmbyllëse në përfundim të seancës, duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi dhe duke analizuar elementët e dhe çështjet që kanë të bëjnë me thelbin dhe me provat.
- » të kërkojë një dënim të caktuar para marrjes së vendimit të gjykatës nëse ekzistojnë kufizime kohore, ose nëse koha e lejon në argumentat përmbyllës.

⁵⁸ Disa shembuj janë: kufizimi i kohës për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe ata të palës tjetër; kufizimi i kohës për argumentet përmbyllëse; vendimi në mënyrë të shpejtë për kërkesat; marrja në konsideratë e lejimit të vetëm një prokurori ose avokati mbrojtës për të marrë në pyetje dëshmitarin; lejimi që avokati mbrojtës të sjellë një dëshmitar tjetër përveç të pandehurit, nëse koha e lejon; vendimi nëse ka kohë për të dëgjuar argumentet përmbyllëse nga palët për dënimin.

⁵⁹ Për shembuj të këtyre hapave, shih seksionin 5.2 mbi "Përmbajtjen" gjatë pjesës teorike, shënimi footnote 17.

» DËSHMITARËT E AKUZËS PËRFSHIRË VIKTIMËN

Do të merren në pyetje nga prokuroria si dhe nga avokatët e mbrojtjes dhe ndoshta edhe nga gjyqtari ose gjyqtarët.

Në veçanti viktimat mund të thirren të dëshmojnë mbi arsyet e hapave për mbrojtjen e viktimës që janë kërkuar nga prokuroria ose avokati mbrojtës i viktimës, ose lidhur me dëmin e shkaktuar nga veprimet e të pandehurit që justifikojnë dëmshpërblimin.

» TË PANDEHURIT DHE DËSHMITARËT E MBROJTJES

Të pandehurit

- » Në fillim të seancës, të pandehurit mund të deklarohen fajtorë ose të pafajshëm nëse dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë.
- » Ata mund të bëjnë edhe çdo deklaratë tjetër që dëshirojnë gjatë zhvillimit të seancës.
- » Në përfundim të provave nga akuza, ata njoftojnë gjykatën nëse dëshirojnë të heshtin, të dëshmojnë duke u marrë në pyetje nga palët përkatëse, apo të paraqesin një deklaratë duke mos i'u nënshtruar marrjes në pyetje nga mbrojtja apo akuza.
- » Në rast se të pandehurit zgjedhin të dëshmojnë, ata do t'u përgjigjen pyetjeve të avokatëve mbrojtës dhe të akuzës. Atyre mund t'iu bëhen edhe pyetje nga gjyqtarët.

Dëshmitarët e mbrojtjes merren në pyetje nga mbrojtja dhe nga akuza. Ata mund të marrin pyetje edhe nga gjyqtarët.

Avokatët e viktimave

Në fillim të seancës, avokati mbrojtës i viktimës mund të paraqesë kërkesa për dëmshpërblimin e viktimës, pasi të ketë diskutuar me viktimën dhe prokurorin; mund të paraqesë kërkesa për hapat e mbrojtjes së viktimës⁶⁰, pasi të ketë diskutuar me viktimën dhe prokurorin; mund të kundërshtojë ngacmimin e viktimës gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër.

Dëshmitari ekspert

Gjatë seancës, pala që ka ftuar ekspertin mund të mjaftohet me opinionin e paraqitur me shkrim në gjykatë dhe mund të merret në pyetje nga pala tjetër. Ose si alternativë tjetër, mund merren në pyetje nga pala që e ka ftuar, dhe më pas nga pala tjetër si dhe nga gjyqtarët.

8.4 ÇFARË PRITET NGA PERSONAT QË DO TË LUAJNË ROLET NË NJË VERSION TË SHKURTUAR TË GJYQIT IMITUES?

Në një version të shkurtuar të gjyqit imitues, në përgjithësi rolet e vetme do të jenë gjyqtari(ët); prokurori(ët); dhe avokati(ët) mbrojtës. Mund të ketë edhe vëzhgues profesionistë.

Prokurorët dhe avokatët mbrojtës nuk i marrin në pyetje dëshmitarët, por thjesht paraqesin argumentet e tyre pro dhe kundër dënimit, në bazë të dokumenteve të background-it dhe dokumenteve gjyqësore dhe, nëse e lejon koha, bëjnë argumentat përmbledhëse lidhur me një dënim të caktuar. Në fillim të seancës, prokurorët mund të kërkojnë dëmshpërblim për viktimën. Roli i gjyqtarit(ëve) është të vendosë mbi dhënien e pafajësisë ose dënimit që mund të përfshijë dëmshpërblimin e viktimës, në rastin kur

⁶⁰. Për shembuj të hapave për mbrojtjen e viktimës, shihni seksionin 5.2 mbi "Përmbajtjen" në pjesën teorike, shënimi footnote 18.

kjo është kërkuar në fillim të seancës. Vëzhguesit profesionistë do të kryejnë të njëjtat role si gjatë një versioni të plotë të një gjyqi imitues.

8.5 SHTRIRJA KOHORE E SEANCËS SË GJYQIT IMITUES

Për një proces optimal, seanca e gjyqit imitues, përfshirë edhe vendimin, do të duhet të parashikohen rreth 3 orë e gjysmë deri në 4 orë. Megjithatë, ka pasur raste kur gjyqi imitues është realizuar në një kohë më të shkurtër, për shembull, 2 – 3 orë. Trajnuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se sa më e gjatë koha që caktohet, aq më shumë rriten mundësitë që të mësohet më shumë.

Trajnuesit këshillohen që t'i kujtojnë gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të turpit gjykues rëndësinë që ka respektimi i kohës, përfshirë përqendrimin e kundërshtimeve dhe kërkesave në çështjet që kanë të bëjnë me thelbin, dhe jo ato që kanë të bëjnë me procedurën ose provat, pasi kjo përçon qëllimin kryesor të gjyqit imitues që është nxitja e zhvillimit të njohurive dhe aftësive në trajtimin e çështjeve tipike në rastet e trafikimit të personave.

Natyrisht, versioni i shkurtuar i gjyqit imitues kërkon më pak kohë.

9. DISKUTIMET PËRMBLEDHËSE

9.1 OBJEKTIVAT DHE RËNDËSIA

Qëllimi i diskutimeve përmbledhëse (debriefing) është që t'u mundësohet pjesëmarrësve të shprehin mendimet e tyre mbi sa i vlefshëm ishte gjyqi imitues. Theksojmë se duhet pasur kujdes që të mos lejohet që kritikak të drejtohen ndaj pjesëmarrësve të caktuar, por fokusi të jetë tek organizimi dhe përmbajtja e trajnimit e performanca e grupit, në mënyrë që të ruhet klima e besimit dhe e bashkëpunimit që kanë një rol vendimtar për suksesin e aktivitetit.

Diskutimet përmbledhëse kanë rëndësi të madhe si për pjesëmarrësit ashtu edhe për trajnuesit. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka, rekomandohet të zgjasin një orë.

- » **Pjesëmarrësit:** Aktiviteti u mundëson pjesëmarrësve të kristalizojnë çfarë kanë mësuar dhe ta përvetësojnë atë. Këto diskutime i ndihmojnë pjesëmarrësit të reflektojnë mbi trajnimin, të bëjnë vlerësimin e tij si dhe të dëgjojnë mendimet e të tjerëve, duke pasuruar përvojën e tyre. Gjithashtu, u jep pjesëmarrësve ndjesinë e mbylljes. Si i tillë, kjo fazë është në përputhje me parimet e të nxënimit për të rriturit, duke theksuar rëndësinë e reflektimit krahas praktikës.
- » **Trajnuesit:** Diskutimet përmbledhëse (debriefing) i ndihmojnë trajnuesit të vlerësojnë më mirë aktivitetin dhe të përpiqen ta përmirësojnë atë në të ardhmen, duke marrë parasysh komentet e pjesëmarrësve. Kjo i ndihmon gjithashtu të identifikojnë mangësitë që pengojnë zgjidhjen me sukses të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore në juridiksionin përkatës.

Gjatë diskutimeve përmbledhëse, duhet t'u jepet mundësia të flasin të parët vëzhguesit profesionistë (kur e kemi këtë rol), pasi ata janë fokusuar tek vlerësimi i gjyqit imitues përgjatë gjithë periudhës përgatitore si dhe vetë seancës. Pas komenteve të tyre, diskutimi mund të hapet për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.

Theksojmë se diskutimet përmbledhëse janë po aq të rëndësishme edhe në versionin të shkurtuar të gjyqit imitues. Gjithsesi, kohëzgjatja e tij mund të shkurtrohet.

9.2 SI TË NXITET DISKUTIMI I HAPUR DHE I LIRË

Vlera e diskutimeve përmbledhëse varet nga gatishmëria e pjesëmarrësve për të shprehur pikëpamjet e tyre të singerta. Kjo mund të pengohet nëse ata ngurrojnë të shprehin kritika, sepse mund të shihet si mosmirënjohje ndaj trajnuesve të cilët kanë punuar shumë. Më tej, nëse përfaqësues të lartë të institucioneve shqiptare janë të pranishëm gjatë diskutimeve përmbledhëse ngurrimi mund të jetë edhe më i madh, pasi ata mund të mendojnë se kritikak e tyre ndaj legjisllacionit ekzistues vendas ose ndaj kapaciteteve kombëtare mund të mos merren lehtë.

Si mund të krijojnë trajnuesit një atmosferë ku flitet hapur? Së pari, ata duhet të theksojnë se kritikak e dhëna do të shërbejnë për të përmirësuar aktivitete të tilla në të ardhmen. Së dyti, duhet të shpjegojnë se gjatë kësaj faze të trajnimit pjesëmarrësit duhet të marrin rol qendror dhe ta theksojnë këtë duke i lejuar pjesëmarrësit të komentojnë të parët, para trajnuesve si dhe duke i mbajtur në minimum komentet e trajnuesve. Ata mund të theksojnë edhe se kritikak nuk duhet t'u drejtohen sukseseve dhe dështimeve personale, por performancës në grup, në mënyrë që të ruhet ndjenja e besimit dhe

bashkëpunimit të cilat janë shumë të rëndësishme për suksesin e trajnimit.

Hapa të tjerë të mundshëm mund të përfshijnë reflektimin kritik të vetëvetes nga trajnuesit ose parashtrimin nga ana e tyre të pyetjeve specifike që nuk janë delikate kur pjesëmarrësit ngurrojnë që të fillojnë të flasin. Disa shembujt mund të jenë: A mendoni se rregullat bazë ishin të dobishme? A mendoni se u la kohë e mjaftueshme për seancën? A mendoni se, në përfundim të trajnimit, keni kuptuar mjaftueshëm për çështjet që lidhen me provat? Çfarë mendimi keni për metodën e ndarjes së roleve? Pse mbrojtja zgjodhi strategjinë që të pandehurit të dëshmonin?

Një teknikë tjetër përdorur në një gjyq imitues në Marok nga UNODC-ja ishte ndarja e pjesëmarrësve në 4 grupe gjatë diskutimeve përmbledhëse, bazuar mbi supozimin se është më e lehtë të shprehësh mendimet para një grupi më të vogël dhe më pas t'i raportosh kur mblidhen të gjithë në një grup të madh.

Është e qartë se moderatorët dhe trajnuesit duhet të jenë të kujdesshëm që ta lënë të hapur mundësinë që pjesëmarrësit të flasin e të mos marrin në kontroll diskutimet përmbledhëse me komentet dhe njohuritë e tyre. Ata duhet të dëgjojnë dhe jo të orientojnë, si edhe të sigurohen që pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm se komentet e tyre po merren seriozisht. Komentet duhet të regjistrohen me shkrim nga trajnuesit, për t'u diskutuar më vonë për qëllime të të mësuarit.

10. AKTIVITETE NË VAZHDIMËSI PAS TRAJNIMIT

Gjyqi imitues mund të jetë i vlefshëm në vetvete, pasi trajnon pjesëmarrës të veçantë në lidhje me çështjet dhe sfidat e rasteve të trafikimit të personave si dhe përmirëson aftësitë e tyre. Megjithatë, mund të jetë edhe një shtysë për ndryshime pozitive në të ardhmen, nëse trajnuesit zhvillojnë veprimtari të tjera në vijim të tij. Këto aktivitete mund të jenë afatshkurtra dhe afatgjata.

AKTIVITETE VIJUESE NË AFAT TË SHKURTËR

» Pyetësorë në përfundim të aktivitetit:

Ato mund të shërbejnë për të bërë bashkë komentet e pjesëmarrësve dhe për t'u dhënë një mundësi tjetër për të shprehur komente të cilat kanë ngurruar t'i shprehin publikisht gjatë diskutimeve përmblëdhëse (debriefing).

» Vlerësim me shkrim nga trajnuesit:

Ai siguron që mësimet e nxjerra nga diskutimet përmblëdhëse të mos humbasin. Vlerësimi duhet të përfshijë rekomandime të bazuara në komentet e pjesëmarrësve, pasi kjo është me rëndësi thelbësore për të ardhmen e aktiviteteve të ngjashme. Në këtë drejtim, është po aq e rëndësishme që ekipi i trajnimit të mblidhet bashkë për të diskutuar vlerësimet si edhe për të rënë dakord mbi rekomandimet. Kjo gjë mund të bëhet edhe virtualisht.

AKTIVITETE VIJUESE NË AFAT TË GJATË

Disa shembuj përfshijnë sa më poshtë:

- » Krijimi i një grupi referimi i cili mund të shërbejë si një forum për diskutime të vazhdueshme si edhe për të ngritur çështje të ndryshme. Një forum i tillë mund të përfshijë edhe një bazë të dhënash me materiale për pjesëmarrësit.
- » Një bazë për të filluar diskutimin mbi ndryshimet në legjislacion me agjencitë përkatëse shqiptare, nëse konstatohet se ka boshllëqe që pengojnë zgjidhjen me sukses të çështjeve.
- » Një bazë për të filluar diskutimin mbi mangësitë në praktikën e pjesëmarrësve, me agjencitë përkatëse. Synimi është përmirësimi dhe trajtimi i tyre në trajnime të ardhshme.
- » Planifikimi i zhvillimit të një trajnim të trajnuesve me të njëjtin grup pjesëmarrësish, në mënyrë që ata të zhvillojnë gjyqet imituese dhe të përhapin njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit në një grup më të madh profesionistësh.



SHTOJCA

SHTOJCA 1: SHEMBULL I PROGRAMIT**TRAFIKIMI I PERSONAVE**

Trajnim për gjyq imitues

Tiranë

PROGRAMI**DITA 1**

8:30 – 9:00	Regjistrimi	OSCE
9:00 – 9:30	Mirëseardhja dhe Prezantimet	
9:30 – 9:40	Objektivat e trajnimit të gjyqit imitues	Ekspertët ndërkombëtarë ose vendas
9:40 – 10:10	<ul style="list-style-type: none"> » Prezantimi në tryezë të rrumbullakët i pjesëmarrësve dhe trajnuesve » Prezantim i rolit të gjerë të gjyqësorit në raste trafikimi (interpretim i ligjit/ dënimi/ mbrojtja e viktimës/ identifikimi i viktimës) 	Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe prokuroria shqiptare
10:10 - 10:30	Zhvillime në legjislacionin Shqiptar mbi procedimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore – me fokus mbrojtjen e viktimave	Eksperti shqiptar
10:30– 11:00	<p>LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI TRAFIKIMIN NËN DRITËN E KONCEPTEVE DHE ÇËSHTJEVE KRYESORE NDËRKOMBËTARE – PJESA 1</p> <ul style="list-style-type: none"> » Elementët e krimit: veprimi, mjeti, qëllimi i shfrytëzimit » Elementët e trafikimit të fëmijëve – A mbulohet trafikimi i fëmijëve nga familja nga nenet që trajtojnë trafikimin në legjislacionin shqiptar? » Çështje të veçanta lidhur me elementët e krimit: <ul style="list-style-type: none"> » Çështje të veçanta lidhur me veprimet: Krimi si proces që lejon dënimin e hallkave në zinxhir/a është e nevojshme lëvizja për të përbërë një ‘veprim’? » Çështje të veçanta lidhur me ‘mjetet’: A është e nevojshme forca fizike për të provuar trafikimin? A janë të nevojshme kërcënimet me forcë? 	Eksperti ndërkombëtar

	<p>Materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Kodi Penal shqiptar » Protokoll i Trafikimit të Personave » Dokument mbi analizën e neneve përkatëse të legjislacionit shqiptar për trafikimin nën dritën e debateve aktuale globale 	
11:00 – 11:15	Pushim kafe	
11:15 – 12:15	<p>LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR TRAFIKIMIN NËN DRITËN E KONCEPTEVE DHE ÇËSHTJEVE KRYESORE NDËRKOMBËTARE – PJESA 2</p> <p>Qëllimet e shfrytëzimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Dallimi midis skllavërisë/praktikave të ngjashme me skllavërinë/shërbimet e detyruara/punën e detyruar » A kërkojnë forcë fizike qëllimet e shfrytëzimit? » A janë shteruese qëllimet e shfrytëzimit? » Ku klasifikohet lypja e detyruar? <p>Pëlqimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Rëndësia e deklaratës mbi pëlqimin në Protokoll. » Si duhet ta trajtojnë gjyqtarët dhënien e pëlqimit në kuadër të mungesës së deklaratës mbi pëlqimin në seksionin e trafikimit në Shqipëri? <p>Mbrojtja e viktimave: (përfshirë kompensimin, mos-kriminalizimin)</p> <p>Materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Kodi Penal Shqiptar » Protokollin e Trafikimit të Personave » Dokument mbi analizën e neneve përkatëse të legjislacionit shqiptar për trafikimin nën dritën e debateve aktuale globale 	
12:15 – 12:45	<p>Format e trafikimit në Shqipëri:</p> <p>Trafikimi i brendshëm dhe ndërkombëtar i viktimave të rritura</p> <p>Trafikimi dhe shfrytëzimi i të miturve</p> <p>Lypja e detyruar</p>	Ekspertët shqiptar
12:45 – 13:30	Dreka	
13:30 – 14:00	<p>Çështjet tipike të provave në rastet e trafikimit të personave:</p> <p>» Elemente të rëndësishme të rasteve: (forca, kërcënimet, mashtrimet, mjete të fshehta, vulnerabilitetet e viktimave, kufizimet e lirisë, izolimi, kushtet e vështira të punës dhe të jetesës, cënimi i privatësisë dhe dinjitetit, shenja pronësie/objektifikimi, robëria prej borxhit, klima e frikës, kohëzgjatja e abuzimit) me fokus të vendosur në mjaftueshmërinë e mjeteve psikologjike si mjetet delikate të detyrimit.</p>	Eksperti ndërkombëtar

	<p>» Dobësitë tipike në rastet: (sjellja problematike e viktimës gjatë trafikimit dhe hetimit dhe seancës gjyqësore; vështirësi në vërtetimin e qëllimit, alternativat/ sistemet mbështetëse të viktimës, praktikat kulturore të pranuar.)</p> <p>» Shpjegimet e dobësive në sjelljen e viktimës (trauma, stereotipe dhe mite, metoda kontrolli)</p> <p>Materialet: Përmbledhje e rasteve të UNODC-së mbi çështje që kanë të bëjnë me provat në rastet e trafikimit të personave</p>	
14:00 – 14:20	<p>Dënimi në rastet e trafikimit (përfshirë dëmshpërblimin e viktimës)</p>	Gjyqtari shqiptar
14:20 – 15:15	<p>Rast studimor mbi elementet e krimit, çështje tipike të provave dhe dënimi</p> <p>Materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Rast studimor me pyetje për reflektim » Përmbledhje e rasteve të UNODC-së mbi çështjet e provave në rastet e trafikimit të personave 	
15:15 – 15:30	Pushim kafe	
15:30 – 16:15	<p>Metodologjia e gjyqit imitues:</p> <ul style="list-style-type: none"> » Prezantimi i procedurës dhe trajtimi i pyetjeve që lindin » Ndarja e roleve » Përshkrimi i roleve <p>Shpërndarja e dokumenteve (rregullat bazë, skenari i rastit, lista e provave dhe roleve, aktakuza, deklaratat e dëshmitarëve përfshirë viktimën dhe të pandehurit, mendimin e ekspertit nëse është i pranishëm, dokumentet dhe provat fizike)</p>	Ekspertët ndërkombëtar ose vendas

DITA 2:

9:00 – 11:30	<p>Puna përgatitore nga pjesëmarrësit me mbështetjen e ekspertëve</p> <ul style="list-style-type: none"> » Secili pjesëmarrës lexon të gjithë materialin përkatës për rolin e tij, përfshirë pjesët e përmbledhjes së rasteve, aktakuzën, deklaratat e dëshmitarëve dhe dokumente të tjera » Ekipet e akuzës dhe ekipet e mbrojtjes takohen për të përgatitur strategjitë dhe për të përgatitur dëshmitarët » Gjyqtarët përgatiten duke lexuar të gjitha dokumentet dhe pjesët përkatëse nga përmbledhja e çështjes » Të pandehurit, viktimat, dëshmitarët takohen me prokurorinë për t'u përgatitur për dëshmi » Avokati mbrojtës i viktimës takohet me viktimën dhe akuzën për të harmonizuar strategjitë » Vëzhguesit profesionistë ndahen në 3 grupe për të vëzhguar përgatitjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës
11:30 – 13:00	Seanca - dëshmitë dhe dorëzimi i provave dokumentare dhe fizike
13:00 – 13:45	Dreka
13:45 – 15:15	Vazhdimi i seancës
15:15 – 15:35	Argumentet përfundimtare nga prokuroria dhe mbrojtja
15:35 – 16:00	Pushim për t'u mundësuar gjyqtarëve të përgatisin vendimin dhe pushim kafeje
16:00 – 16:15	Leximi i vendimit - përfshirë arsyetimin dhe dënimin
16:15 – 17:00	Përmbledhje dhe diskutime

SHTOJCA 2: SHEMBUJ TË RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME DHE PËRSHKRIMIT TË ROLEVE

MODEL RREGULLA BAZË TË GJYQIT IMITUES, PËRFSHIRË PËRSHKRIMIN E ROLEVE

SHËNIM: Secilit prej pjesëmarrësve në gjyqin imitues mund t'u shpërndalet përshkrimi i roleve dhe t'u tregohet se çfarë pritjet prej tyre me qëllim shkurtimin e rregullave bazë, duke përfshirë në to vetëm informacionin më të rëndësishëm për çdo pjesëmarrës.

I. RREGULLAT BAZË PËR TË REALIZUAR QËLLIMET E GJYQIT IMITUES:

1. Afatet kohore: Afatet kohore të gjyqit imitues janë me rëndësi kritike. Pjesëmarrësve do t'u kërkohet të respektojnë kohën e caktuar për përgatitje si dhe për zhvillimin e seancës gjyqësore. Në këtë drejtim, rol thelbësor luan Kryetari i trupit gjykues për të garantuar respektimin e afatit kohor, si për shembull, duke kufizuar kohën për marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose paraqitjen e argumenteve përmbyllëse në fund të seancës.
2. Veprimet paraprake sipas së drejtës procedurale penale që nuk përfshihen: Këtu bëhet fjalë për hetimet paraprake dhe seancën paraprake. Ky rregull shërben në interes të përmbylljes së qëllimit kryesor të ushtrimit të gjyqit imitues, pra të kuptuarit dhe zhvillimit të aftësive për trajtimin e çështjeve tipike të së drejtës penale materiale në gjykimin e trafikimit të personave dhe jo me ushtrimin e aftësive të përgjithshme në sallën e gjyqit.
3. Kufizimi i kundërshtimeve dhe i kërkesave për t'u fokusuar në aspektin material dhe jo procedural: gjatë pyetjes së dëshmitarëve, kërkesa drejtuar gjykatës, dhe argumentet përmbyllëse, si nga akuzat edhe mbrojtja duhet të fokusohen te çështjet e ligjit material dhe jo atij procedural. Ky rregull ndihmon që metodologjia të përqendrohet në aspekte të legjislacionit penal për gjykimin e trafikimit të personave, duke i shërbyer qëllimit kryesor të ushtrimit të gjyqit imitues, që është rritja e aftësive të pjesëmarrësve në ndjekjen penale dhe trajtimin e rasteve të trafikimit të personave. Ky rregull ofron edhe një përfitim shtesë, kursen kohë.
4. Kufizimi i objektit të gjyqimit në veprën e trafikimit: Edhe nëse faktet e çështjes mund të nxjerrin në pah vepra të tjera përveç akuzave për trafikim, sugjerohet që pjesëmarrësit të mos merren me veprat e tjera, pasi qëllimi i gjyqit imitues është të mësohet përballimi i gjyqimit të rasteve të trafikimit.
5. Për disa prova mund të bihet dakord: Për të kursyer kohë, disa prova do të pranohen me marrëveshje midis palës së akuzës dhe asaj të mbrojtjes.
6. A mund të shtojnë pjesëmarrësit fakte përtej atyre që përshkruhen në rastin studimor ose provat? Përsa është e arsyeshme, pjesëmarrësit mund të përdorin imagjinatën për të zhvilluar strategji të mbrojtjes dhe të akuzës. Megjithatë, këto nuk mund të bien ndesh me faktet e çështjes.
7. Mbi devijimet nga legjislacioni procedural në fuqi dhe për shembull:
 - 7.1 Të gjithë pjesëmarrësit do të njihen me provat dhe dosjen përkatëse para fillimit të gjyqit imitues, ku do të përfshihet akuzat si dhe çdo deklaram i marrë nga oficeri i policisë gjyqësore

- dhe prokurori, me qëllim që të sigurohet një mbarëvajtje e gjyqit.
- 7.2 Të gjithë pjesëmarrësit do të jenë të pranishëm gjatë seancës së gjyqit imitues, edhe pse e drejta procedurale mund të ndalojë praninë e dëshmitarëve në sallën e gjyqit gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve të tjerë.
 - 7.3 Edhe nëse trupi gjykues vendos që gjykimi të mbahet me dyer të mbyllura ose që viktimat të dëshmojnë nëpërmjet mjeteve audio-vizuale, çdo pjesëmarrës do të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit me qëllim për vetësimin e njohurive.
 - 7.4 Nuk do të ketë veprime paraprake dhe as seancë paraprake në mënyrë që për vetësimin i njohurive të përqendrohet te çështjet kryesore. Për këtë, akuza ose mbrojtja do të duhen të kërkojnë dëmshpërblimin e viktimës në fillim të seancës së gjyqit imitues, dhe jo gjatë seancës paraprake, siç përcaktohet nga neni 62 i Kodit të Procedurës Penale.
 - 7.5 Kërkesat procedurale, deklaratimet, kundërshtimet dhe parashtrimet nuk do të lejohen në mënyrë që fokusi të jetë në ligjin material.
 - 7.6 Rendi i gjykimit do të përqendrohet në fazat kryesore për shkak të kufizimeve të kohës: hapja e seancës nga kryetari i trupit gjykues, provat e palës akuzuese, provat e palës mbrojtëse, argumentet përmblylëse, shpallja e vendimit.
 - 7.7 Nëse nuk e lejon koha, kryetari i trupit gjykues mund të vendosë të mos u japë të drejtën palëve për replika. Gjyqtarët mund të vendosin për marrjen dhe shpalljen e vendimit pa i dhënë të drejtë palës mbrojtëse për replikë.
 - 7.8 Megjithëse rastet e trafikimit gjykohen nga një gjyqtar, gjyqi imitues mund të gjykohet nga një trup gjykues, që të krijohet mundësia për më shumë role për pjesëmarrësit si dhe për të rritur të nxëniet me anë të diskutimit midis pjesëmarrësve që luajnë rolin e gjyqtarëve.
 - 7.9 Ndonëse roli i mbrojtësit të viktimës i është i parashikuar në legjislacionin shqiptar, ai nuk është i qartë për sa u përket veprimeve specifike që ky mund të marrë. Prandaj, përshkrimi i rolit në këto rregulla bazë është vetëm për qëllimin e këtij gjyqi imitues⁶¹.
8. Rëndësia e fazave të gjyqit imitues: Gjyqi imitues kalon nëpër 3 faza kryesore⁶²: periudhën përgatitore, seancën e gjyqit imitues, përfshirë paraqitjen e provave dhe vendimin, si dhe një diskutim mbi ecurinë në fund. Secila nga këto faza ka kërkesa të ndryshme për pjesëmarrësit dhe secila është po aq e rëndësishme sa të tjerat.
 9. Rëndësia e përdorimit të praktikës gjyqësore për të mbështetur argumentet ose vendimet përfundimtare: Pjesëmarrësve do t'u kërkohej të mbështesin argumentet ose vendimet e tyre përfundimtare me të paktën 2 raste trafikimi. Kjo do të thotë se do t'u duhet të lexojnë me kujdes praktikën gjyqësore që u është shpërndarë, e cila do të përfshijë raste të marra nga Shqipëria si dhe raste të tjera të nxjerra nga Përmbledhja e Rasteve të UNODC-së për Provat në Çështjet e Trafikimit të Personave⁶³.

Seksionet e mëposhtme (II dhe III) përshkruajnë se çfarë pritet nga pjesëmarrësit gjatë periudhës së përgatitjes dhe gjatë seancës gjyqësore. Seksioni IV përshkruan fazat e seancës së gjyqit imitues.

⁶¹ Ndonëse ky funksion parashikohet në nene të ndryshme të legjislacionit që kanë të bëjnë me viktimat e mitura dhe të rritura, nuk është plotësisht e qartë nëse kjo e drejtë ushtrohet vetëm në hetimeve paraprake dhe seancë paraprake dhe seancës së parë apo gjatë gjithë procedimit penal dhe çfarë funksioni ka. Mund të arsyetohet se mbrojtësi i viktimës mund t'i paraqesin gjykatës çdo kërkesë në emër të viktimës, duke përfshirë edhe kërkesat për masa mbrojtëse. Shih nenet 58, 59, 61 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 23, 24, 34, 36 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, nenet 11 dhe 12 të Ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti", neni 23 i Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, 2018. Prandaj, roli i përshkruar në këto rregulla bazë mund të mos jetë në përputhje me praktikën që do të zhvillohet dhe funksionet e përshkruara më sipër, janë vetëm për qëllimin e gjyqit imitues.

⁶² Gjyqi imitues në një kuptim më të gjerë përfshin edhe vendimet e planifikimit nga trajnuesit; prezantimin nga ana e moderatorit dhe ndarjen e roleve; dhe aktivitetet vijuese pas diskutimit përfundimtar. Megjithatë, tre fazat e shënuara janë ato që lidhen me rregullat bazë.

⁶³ Gjetet në :https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2017/Case_Digest_Evidential_Issues_in_Trafficking.pdf

II. PERIUDHA E PËRGATITJES: DETYRAT E ÇDO PJESËMARRËSI

SHËNIME:

- » Për të shkurtuar rregullat bazë, pjesëmarrësve mund t'u shpërndalet, sipas rolit që kanë, përshkrimi i asaj që pritet nga secili gjatë periudhës përgatitore.
- » Megjithëse në këto rregulla bazë të përgjithshme nuk figurojnë emrat e dëshmitarëve të akuzës dhe të mbrojtjes (përfshirë ekspertët), rekomandohet që në rregullat specifike bazë që shoqërojnë një gjyq imitues, të përdoren emrat e të gjithë dëshmitarëve.

Më poshtë jepet përshkrimi i detyrave për pjesëmarrësit gjatë periudhës përgatitore:

Të gjithë pjesëmarrësit duhet që:

- » Të lexojnë dokumentet përkatëse⁶⁴ akuzën, provat dhe rregullat bazë.⁶⁵
- » Të lexojnë materialin përkatës teorik që u është shpërndarë.
- » Të kenë mundësinë për të pyetur trajnuesit, të cilët do të jenë në dispozicion gjatë kësaj kohe, për t'iu përgjigjur dhe për të dhënë udhëzime.

Për më tepër, çdo pjesëmarrës që ka një rol gjatë gjyqit imitues do të ketë detyra të veçanta për të kryer si më poshtë:

GJYQTARËT:

Në rastin kur ka një trup gjykues, trupa duhet të zgjedhë kryetarin, i cili drejton seancën gjyqësore dhe bën pyetje përgjatë kësaj faze të ushtrimit për të pasuruar eksperiencën e të mësuarit si dhe për të diskutuar në thellësi çështjet, legjislacionin dhe praktikën gjyqësore. Ata duhet të marrin në konsideratë edhe mundësinë e opinioneve të pakicës dhe të shumicës në përfundimin e çështjes. Pavarësisht nëse seanca zhvillohet me një gjyqtar apo me një ekip si trup gjykues, pasi të ketë lexuar në thellësi dokumentet gjyqësore dhe materialin teorik, pjesëmarrësit duhet të përpiqen të identifikojnë çështjet e lidhura me ligjin material dhe provat, duke pasur në vëmendje çështje që mund t'i përdorin në vendimet e tyre, pasi do t'u duhet të citojnë të paktën dy çështje trafikimi në gjykimin e tyre. Gjithashtu, duhet të marrin në konsideratë rolin e tyre në seancë, përfshirë hapat e mbrojtjes së viktimës dhe kompensimin e dëmit nëse akuza apo mbrojtja e kanë paraqitur këtë kërkesë në fillim të seancës.

PROKURORËT:

- » Përgatitja e aktakuzës nëse trajnuesit kanë vendosur se duhet ta bëjnë: Nëse trajnuesit kanë vendosur që prokurorët ta hartojnë akuzën gjatë kësaj faze të procedurës, prokurori ose ekipi i prokurorëve duhet të veprojnë menjëherë, me qëllim që t'u shpërndalet sa më shpejt të gjithë pjesëmarrësve. Nëse ka një aktakuzë të gatshme, duhet të bazohen tek ajo dhe të vijojnë me kryerjen e detyrave të tjera.
- » Detyrë e veçantë për ekipin e prokurorëve: nëse është një ekip prokurorësh, duhet të ndajnë punën midis tyre.
- » Pavarësisht nëse është një ekip prokurorësh apo vetëm një, duhet të kryejnë detyrat e mëposhtme:
 - » Hartimi i një strategjie: prokurorët duhet të hartojnë një strategji bazuar në pikat e forta dhe të dobëta të çështjes. Kjo duhet të përfshijë edhe se ku duhet vënë theksi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe atyre të palës tjetër, si dhe në argumentet përmbyllëse.

⁶⁴ Këto përfshijnë një skenar ilustrues, listën e roleve dhe provave dhe një listë të burimeve.

⁶⁵ Këto mund të përfshijnë deklaratatë të dëshmitarëve, dokumente ose objekte fizike që duhen paraqitur si provë.

- » Puna përgatitore: Prokurorët duhet të marrin në konsideratë nëse dëshirojnë të kërkojnë në fillim të shqyrtimit gjyqësor kompensimin e dëmit që ka pësuar viktimja; duhet të përgatisin dëshmitarët e akuzës për seancë; duhet të përgatisin pyetjet e tyre për dëshmitarët që kanë kërkuar vetë dhe dëshmitarët e palës tjetër; duhet të përgatisin kërkesat për masat e marrjes në mbrojtje të viktimës⁶⁶ nëse e gjykojnë të nevojshme, pasi të konsultohen me viktimën; të hartojnë versionin fillestar të argumenteve përfundimtare përfshirë elementët e veprës penale si dhe çështje të ligjit penal material dhe duke u mbështetur në të paktën 2 çështje trafikimi; si dhe të hartojnë versionin fillestar të kërkesës për masën e dënimit.

MBROJTJA

- » Detyrë e veçantë për ekipin e mbrojtjes: Nëse mbrojtja do të bëhet nga një ekip, ata duhet të ndajnë punën midis njëri tjetrit.
- » Pavarësisht nëse ka një person të vetëm apo një ekip për mbrojtjen, ata duhet që:
 - » Të vendosin për një strategji:

Kjo duhet të bëhet nëpërmjet konsultimit me të pandehurin/t përfshirë: nëse do të shprehet i fajshëm apo i pafajshëm dhe nëse vendoset të pranohet – si të shprehet; nëse i pandehuri duhet të paraqesë një deklaratë tjetër gjatë shqyrtimit gjyqësor; nëse vendimi është që i pandehuri të mos flasë, dorëzojnë një deklaratë që nuk i nënshtrohet pyetjes nga pala tjetër ose dhënies së dëshmisë; nëse do t'i kërkohet gjykatës që të lejojë dëshminë e dëshmitarëve shtesë të mbrojtjes; nëse do të paraqiten prova materiale ose dokumentare.
 - » Të kryejnë punë përgatitore:
 - » Përgatisin prova shtesë nëse është vendosur që këto të dorëzohen duke qenë të vetëdijshëm se gjyqtari/ët mund të mos e lejojnë këtë për shkak të mungesës së kohës. Në provat shtesë mund të përfshihen dëshmitarë, dokumente, dhe/ose sende materiale. Nëse zgjedhin të paraqesin dëshmitarë shtesë, duhet të zgjidhet dikush për rolin e dëshmitarit;
 - » Përgatisin dëshmitarët për seancën gjyqësore (të pandehurin/t dhe çdo dëshmitar tjetër të zgjedhur);
 - » Përgatisin pyetjen e dëshmitarëve të kërkuar vetë dhe dëshmitarëve të palës tjetër;
 - » Përgatisin pretendime të mundshme në lidhje me hapat e marrjes në mbrojtje të viktimave, në rast se i kërkon prokurori;
 - » Përgatisin në mënyrë të përafërt argumentet përmblylëse, duke trajtuar elementët e krimit, dhe çështje të ligjit material dhe procedural, dhe provat duke u mbështetur në të paktën 2 raste trafikimi;
 - » Hartojnë kërkesat për masën e dënimit në rast se gjykata do të shprehet me vendim fajësie;

⁶⁶ Shiko për shembull Nenin 31 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit sipas të cilit prokurori është përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të viktimës nëpërmjet veprimeve të mëposhtme: shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; paraqitja e kërkesës për dhënien e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur; marrja e masave për mbrojtjen fizike të viktimës. Gjithashtu, gjatë procesit, disa hapa të mëtejshme për mbrojtjen e viktimës janë: gjykimi me dyer të mbyllura, dhënia dëshmisë nëpërmjet lidhjes audio dhe audio-vizuale (nenet 340 dhe 361 të Kodit të Procedurës Penale dhe Neni 43 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur). Nëse çështja përfshin familjarë, Gjykata mund të lëshojë urdhër mbrojtjeje në bazë të ligjit "Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare".

MBROJTËSIT E VIKTIMËS

Mbrojtësit e viktimës duhet të lexojnë me kujdes hapat e mbrojtjes së viktimës në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur (nëse kemi të bëjmë me një viktimë të mitur), Kodin e Procedurës Penale, si dhe Ligjin “ Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare “(nëse krimi ndodh në një kontekst familjar⁶⁷ dhe Nenin 31 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit;⁶⁸ duhet të takohen me viktimën që përfaqësojnë për të diskutuar hapat e mbrojtjes që do ndërmarrin si dhe kërkesat që duhet të dorëzojnë; të diskutojnë me prokurorin se kush do t'i paraqesë këto kërkesa; dhe të shqyrtojnë paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim për viktimën në fillim të seancës, pasi të konsultohen me prokurorinë se kush duhet ta paraqesë një kërkesë të tillë.⁶⁹

DËSHMITARËT E AKUZËS (përfshirë viktimën/at)

Të gjithë ata duhet të takohen me prokurorin/ët në mënyrë që të përgatiten për seancën; të lexojnë me kujdes deklaratimet e tyre para policisë; të lexojnë pjesë të rëndësishme të përmbledhjes së rasteve të UNODC-së që ta vendosin dëshminë e tyre në kontekstin e duhur.⁷⁰

Viktima: Pjesëmarrësi që luan viktimën në veçanti, duhet të diskutojë me prokurorin dhe avokatin mbrojtës të viktimës për hapat e mundshëm të mbrojtjes së viktimës dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim në fillim të shqyrtimit gjyqësor.

Aktorët: Nëse është vendosur që rolet e dëshmitarëve të prokurorisë të luhen nga aktorë, ata duhet ta shfrytëzojnë këtë periudhë për të studiuar skenarët përkatës.

TË PANDEHURIT DHE DËSHMITARËT E MBROJTJES

Të gjithë këta dëshmitarë: Duhet të takohen me përfaqësuesit e mbrojtjes për t'u përgatitur për seancën, të lexojnë me kujdes deklaratimet e tyre para policisë; të studiojnë seksione përkatëse të Përmbledhjes së Rasteve të UNODC-së.⁷¹

I pandehuri/të pandehurit: Duhet të takohet me mbrojtjen për të diskutuar strategjinë, për shembull: A duhet të deklarohen? Si duhet të deklarohen – fajtorë apo të pafajshëm? A duhet të paraqesin ndonjë deklaratë tjetër në gjykatë? A duhet të dëshmojnë? A duhet të paraqiten prova shtesë?

Aktorët: Nëse është vendosur që këto role t'i luajnë aktorët, ata duhet të shfrytëzojnë kohën duke mësuar skenarët.

⁶⁷ Gjatë procesit gjyqësor, viktima nëpërmjet mbrojtësit, mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë mbi masat mbrojtëse si gjykimi me dyer të mbyllura, dhënia e dëshmisë nëpërmjet lidhjes audio-vizuale. (Nenet 104, 340, 361 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 43 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur). Nëse çështja përfshin familjarë, Gjykata mund të lëshojë urdhër mbrojtjeje në bazë të ligjit „Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare“

⁶⁸ Shiko Shënimin 4. Ndonëse ky nen përcakton afatin e legjitimitit të padisë civile në procesin penal derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, ushtrimi i gjyqit imitues nuk përfshin seancën paraprake, prandaj për këtë qëllim padia civile duhet të paraqitet në fillim të seancës gjyqësore.

⁶⁹ Kjo kërkesë parashikohet nga neni 62 i Kodit të Procedurës Penale

⁷⁰ E përmendur më lart. Për shembull, viktima dëshmitare duhet të lexojë seksionet 2.2 dhe 3.3.6 të Përmbledhjes së Rasteve; dëshmitarët e tjerë duhet të lexojnë seksionin 2.3.

⁷¹ Cituar më lart. Për shembull seksioni 2.3 i Përmbledhjes së Rasteve.

DËSHMITARI EKSPERT

Ky lloj dëshmitari nuk është i rëndësishëm për çdo lloji gjyqi imitues

Nëse është vendosur se duhet të dëshmojë një ekspert, në vend që të dorëzojë thjesht një raport ekspertize me shkrim, ai ose ajo duhet të takohet me palën që kërkoi opinionin e tyre në mënyrë që të përgatiten për gjyq. Si rregull, kjo do të jetë akuza, megjithëse mundet që edhe mbrojtja të sjellë një ekspert. Eksperti duhet të lexojë me kujdes raportin e vet si dhe të lexojë seksionin 2.6 së Përmbledhjes së Rasteve të UNODC-së⁷² mbi “dëshminë e ekspertit” në mënyrë që të bazohet në një kontekst për dëshminë e ekspertit në përgjithësi.

VËZHguesIT PROFESIONISTË

Nëse vendoset që të vendoset roli i vëzhguesve profesionistë, pjesëmarrësit që do të luajnë këtë rol mund të ndahen në 3 grupe para periudhës përgatitore, duke qenë se secili prej tyre do të vëzhgojë gjyqtarët, akuzën, ose mbrojtjen përkatësisht gjatë fazës përgatitore të ushtrimit, me qëllimin që të vlerësojnë cilësinë e përgatitjes dhe të vëzhgojnë se çfarë ishte e dobishme dhe çfarë mund të përmirësohej. Përndryshe, ata mund të marrin pjesë në përgatitjen e këtyre 3 grupeve, megjithëse nuk do të interpretojnë rolet gjatë seancës gjyqësore.

⁷². I cituar më lart

III. SEANCA E GJYQIT IMITUES: DETYRAT E PJESËMARRËSVE

SHËNIM: Pjesëmarrësve mund t'u shpërndahet, sipas rolit që kanë, përshkrimi i asaj që pritët nga secili gjatë periudhës përgatitore, me qëllim të shkurtimit të rregullave bazë.

GJYQARËT

Të gjithë gjyqtarët:

Mund të parashtrijnë pyetje sqaruese kur dëshmitarët janë duke dëshmuar; t'i bëjnë pyetje palës së akuzës ose të mbrojtjes; të parandalojnë ngacmimin apo kërcënimin e dëshmitarëve; të marrin vendim në lidhje me masat për mbrojtjen e viktimave si zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura ose lejin e një dëshmitari të intimiduar të dëshmojë nëpërmjet mjeteve audio-vizuale; të arsyetojë nëse ka kundërshtim ose kërkesë të veçantë dhe të shprehet me vendim; nëse kërkohet një i tillë; pas përfundimit të provave të shprehet në lidhje me marrjen e vendimit dhe masën e dënimit; të përgatisë dhe të japë një vendim i cili mbështetet në të paktën dy çështje trafikimi dhe të analizojë elementët e veprës penale si dhe çështjet e së drejtës materiale dhe procedurale (provat). Nëse ka mendime të pakicës – këto duhet të përgatiten dhe të dorëzohen nga gjyqtarët që i përkasin këtij mendimi. Dënimi mund të përfshijë dhe kompensimin e dëmit të pësuar nga viktimat krahas masave të tjera të dënimit, nëse prokuroria ose mbrojtësi ligjor i viktimës ka paraqitur një kërkesë për këtë në fillim të seancës.

Kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm i seancës:

Krahas detyrave që kryejnë të gjithë gjyqtarët, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i seancës, në vartësi të ushtrimit, e drejton seancën në këto mënyra: hap gjyqin; lexon akuzat në fillim të seancës, pyet të pandehurin nëse dëshiron të bëjë ndonjë deklaratë, sigurohet që të respektohet afati kohor⁷³, qëndron i gatshëm që të mos lejojë kundërshtime apo kërkesa në lidhje me procedurën ose provat, përveç atyre që lidhen me mbrojtjen e viktimës; pyet të pandehurin nëse dëshiron të flasë apo të mos flasë, të dëshmojë ose të paraqesë deklaratë në përfundimin e provave të prokurorisë, bisedon me gjyqtarët e tjerë mbi vendimin dhe dënimin, e harton atë me ndihmën e gjyqtarëve të tjerë e me pas e jep.

Nëse ka vetëm një gjyqtar, ai duhet të përmbushë funksionet e kryetarit të trupit gjykues si dhe funksionet e përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve.

PROKURORËT:

Gjatë seancës prokurori duhet që:

- » Të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës gjatë kohës që dëshmojnë për të marrë historinë e tyre.
- » Të dorëzojë në gjykatë provat materiale dhe dokumentet, nëse ka.
- » Të marrë në pyetje të pandehurit nëse zgjedhin të dëshmojnë si dhe dëshmitë e dëshmitarëve shtesë të palës mbrojtëse nëse paraqiten.
- » T'i kërkojë gjykatës që kjo e fundit të zbatojë hapat për mbrojtjen e viktimave, nëse janë të nevojshme.⁷⁴

⁷³ Për shembull: Kufizim i kohës për pyetjen e dëshmitarëve dhe kundërshtimin e dëshmitarëve; kufizim i kohës për konkluzionet përfundimtare; arsyetim i shpejtë mbi kërkesat; merr në konsideratë mundësinë që dëshmitari të pyetet vetëm nga një prokuror ose vetëm nga një mbrojtës; lejon palën mbrojtëse të sjellë një dëshmitar tjetër përveç të pandehurit vetëm nëse e lejon koha në dispozicion; vendos nëse ka kohë që palët ta parashtrijnë replika.

⁷⁴ Shiko Nenin 31 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit sipas të cilit prokurori është përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të viktimës nëpërmjet veprimeve të mëposhtme: shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; paraqitja e kërkesës për dhënie të statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur; marrja e masave për mbrojtjen fizike të viktimës.

- » Të kërkojë dëshmëpërblim për viktimën në fillim të seancës, nëse viktimja dëshiron.
- » Të parashtojë konkluzionet përfundimtare duke u bazuar në të paktën 2 çështje trafikimi dhe duke analizuar elementët e veprës penale, aspekte të së drejtës materiale dhe procedurale (provat).
- » Nëse koha e lejon dhe i pandehuri dënohet, të kërkojë një dënim të caktuar.

AVOKATËT MBROJTËS:

Gjatë seancës pala mbrojtëse duhet që:

- » Të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës;
- » Të marrë në pyetje klientin e vet, nëse ai ose ajo zgjedh të dëshmojë;
- » Të kërkojë nga gjykata leje për të paraqitur prova të reja, si dëshmitarë shtesë, ose prova dokumentare ose materiale, nëse e sheh të arsyeshme;
- » Nëse kërkesa i pranohet, të marrë në pyetje dëshmitarët shtesë dhe të dorëzojë provat shtesë dokumentare ose materiale;
- » Të parashtojë argumentet përmbyllëse në fund të seancës duke u bazuar në të paktën 2 çështje trafikimi dhe duke analizuar elementët e veprës penale, aspekte të së drejtës materiale dhe procedurale (provat);
- » Nëse koha e lejon dhe i klienti i tyre dënohet, të bëjnë kërkesë për një dënim të caktuar;

DËSHMITARËT E PROKURORISË, PËRFSHIRË VIKTIMËN

Ata do të merren në pyetje nga prokurori si dhe dëshmitë tyre do të jenë objekt i pyetjeve nga pala mbrojtëse, dhe ndoshta do të pyeten nga gjyqtari ose gjyqtarët.

Viktimat në veçanti mund të thirren për të dëshmuar lidhur me masat e mbrojtjes së viktimave të kërkuara nga prokuroria ose mbrojtja e viktimës. Atyre mund t'u kërkohet edhe që të dëshmojnë në lidhje me dëmin e shkaktuar nga i/të pandehuri/të në mënyrë që të mbështesin kërkesën për kompensimin e dëmit.

I PANDEHURI/TË PANDEHURIT DHE DËSHMITARËT E PALËS MBROJTËSE

Të pandehurit:

- » Në fillim të shqyrtimit gjyqësor të pandehurit mund të bëjnë deklaratë në gjykatë nëse dëshirojnë, dhe mund të vetë-deklarohen fajtorë ose të pafajshëm nëse vendosin ta bëjnë këtë.
- » Mund të bëjnë deklarime shtesë në gjykatë në çdo fazë të procedurës.
- » Në përfundim të provave të prokurorisë, do të njoftojnë gjykatën nëse dëshirojnë të heshtin, të dëshmojnë me anë të marrjes në pyetje, ose të paraqesin një deklaratë pa iu nënshtruar marrjes në pyetje.
- » Nëse të pandehurit zgjedhin të dëshmojnë, do t'u përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga pala mbrojtëse, si dhe do të pyeten nga prokurori. Gjithashtu, mund të thirren për t'iu përgjigjur pyetjeve nga gjyqtarët.
- » Nëse pranohen kërkesat e fajësisë në lidhje me dënimin, ata mund të thirren të dëshmojnë për rrethanat e tyre personale.

Dëshmitarët e palës mbrojtëse do të merren në pyetje nga pala mbrojtëse si dhe nga akuza. Ata mund të thirren për t'iu përgjigjur edhe pyetjeve të gjyqtarëve.

AVOKATËT MBROJTËS TË VIKTIMAVE

Gjatë seancës, përfaqësuesi i mbrojtjes së viktimës mund të paraqesë kërkesa mbi mbrojtjen e viktimës, përveç rasteve që ky hap ndërmerret nga prokurori;⁷⁵ mund të paraqesë një kërkesë në fillim të seancës për kompensimin e dëmit të pësuar nga viktimja, pasi të konsultohet me prokurorinë se cila nga palët duhet të ndërmarrë këtë hap; të kundërshtojë ngacmimin dhe kërcënimin e viktimës gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër.

EKSPERTI

Ky lloj dëshmitari mund të mos jetë i pranishëm në çdo lloj gjyqi imitues.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, pala që ka ftuar ekspertin mund të mjaftohet me raportin me shkrim të dorëzuar në gjykatë dhe në këtë rast mund të merret në pyetje nga pala tjetër. Përndryshe, ai/ajo do të pyetet nga pala që ka kërkuar ekspertin, nga pala tjetër dhe nga gjykata.

⁷⁵ Gjatë procesit gjyqësor, viktimja nëpërmjet mbrojtësit, mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për t'u shprehur me vendim në lidhje me masat mbrojtëse si zhvillimi seancës me dyer të mbyllura, dhënia e dëshmisë nëpërmjet mjeteve audio-vizuale (nenet 104, 340, 361 të Kodit të Procedurës Penale, Neni 43 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur). Nëse në çështje janë të përfshirë familjarë, Gjykata mund të lëshojë urdhër mbrojtjeje sipas Ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

IV. FAZAT E SEANCËS SË GJYQIT IMITUES

Në vijim janë listuar procedurat e një gjyqi të plotë imitues. Për shkak të kufizimeve kohore, do të anashkalohen disa faza procedurale. Për shembull, këtu nuk përfshihet hetimi paraprak ose seanca paraprake.

1. HAPJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR:

Kryetari i trupit gjykues lexon emrat e të pandehurve dhe akuzat përkatëse ndaj secilit prej tyre, duke iu referuar neneve 110/a dhe 128/b. Ai vijon më pas të pyesë të pandehurin nëse dëshiron të deklarohet fajtor apo jo, dhe nëse do të paraqesë ndonjë deklaratë tjetër në gjykatë.

2. PROVAT E PËRFAQËSUESIT TË AKUZËS:

Kryetari i trupit gjykues i kërkon pastaj prokurorit të parashtojë provat.

Prokurori mund të paraqesë një kërkesë për kompensimin e dëmit që ka pësuar viktimat dhe/ose kërkesë për masat mbrojtëse të viktimës nëse e gjykon të përshtatshme.⁷⁶

Prokurori parashtron provat të cilat konsistojnë në pyetjen e dëshmitarëve të prokurorisë për të nxjerrë në pah historinë e tyre, dhe dorëzimin e provave dokumentare dhe materiale, në varësi të rastit.

Mbrojtja do t'u drejtojë pyetje dëshmitarëve të prokurorisë; këtyre mund t'u bëhen pyetje edhe nga gjyqtari/ët.

3. TRAJTIMI NGA MBROJTJA:

Ecuria e çështjes së palës mbrojtëse do të varet nga strategjia e përcaktuar gjatë punës përgatitore:

- » Nëse i pandehuri vendos të heshtë, mbrojtja do të vendosë nëse do të paraqesë prova shtesë ose jo.
- » Nëse i pandehuri dorëzon një deklaratë, ai nuk do të merret në pyetje.
- » Nëse i pandehuri vendos të dëshmojë, mbrojtja duhet t'i bëjë pyetje me qëllim që të zbardhë historinë e tij, e më tej do t'i bëjë pyetje akuza; pyetje mund të bëjë edhe gjyqtari.
- » Prova të tjera të palës mbrojtëse: Nëse është vendosur që të dëshmojnë dëshmitarë të tjerë dhe/ose të dorëzohen prova dokumentare ose materiale, pala mbrojtëse do ta ndërmarrë këtë hap nëse gjykata e lejon me kusht që ta lejojë koha. Prokurori mund të vijojë me pas të marrë në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes.

4. ARGUMENTET PËRMBYLLËSE

Pas përfundimit të dhënies së dëshmisë nga dëshmitarët e mbrojtjes, akuza dhe mbrojtja parashtrajnë argumentet përmbyllëse duke u mbështetur në të paktën 2 çështje trafikimi dhe duke trajtuar aspektet e së drejtës materiale dhe procedurale (provave). Kryetari i trupit gjykues mund të vendosë një afat kohor të kufizuar për sa i përket paraqitjes së argumenteve përmbyllëse nga palët.

Në rast se për shkak të kohës nuk është e mundur të bëhen dy parashtrime të veçanta për masën e dënimit pas dhënies së vendimit, kjo është koha që mbrojtja e viktimës ose akuza të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me dënimin.

⁷⁶. Sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për dëmshpërblim duhet bërë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Por, meqenëse ky ushtrim nuk përfshin një fazë të tillë të procesit, kërkesa do të paraqitet në fillim të parashtrimit të fakteve dhe provave nga ana e palës akuzuese.

5. HARTIMI I VENDIMIT (PARAPRIRË NGA NJË PUSHIM)

» Përpilimi i vendimit:

Pas argumenteve përmbyllëse të palëve, trupi gjykues tërhiqet për t'u mundësuar gjyqtarëve të përpilojnë vendimin, i cili do të mbështetet në të paktën 2 çështje trafikimi, duke trajtuar aspektet e së drejtës materiale dhe procedurale (provave).

Nëse seanca gjykohet nga një trup gjykues, secili parashtron mendimin dhe është kryetari i trupit gjykues, i cili përpilon vendimin. Mund të ketë dhe mendime të pakicës, ose për arritjen e një vendimi ndryshe ose për dakordësimin me vendimin e shumicës. Këto do të hartohen nga gjyqtarët që i përkrahin.

» Çfarë do të përmbajë vendimi?

Nëse koha lejon pretendime të ndryshme lidhur me çështjet (nëse i pandehuri dënohet) vendimi do të kufizohet në dënim me fajësi ose dhënie pafajësie. Nëse nuk ka kohë për këtë, gjyqtari/ët do të hartojnë vendimin dhe masën e dënimit, nëse vendosin për dënim. Ky dënim mund të përfshijë dëmshpërblim për viktimën, nëse mbrojtja ose akuza e kanë bërë këtë kërkesë në fillim të seancës gjyqësore.

6. LEXIMI VENDIMIT

Kryetari i trupit gjykues (nëse ka trup gjykues) ose gjyqtari i çështjes do të lexojë vendimin me zë të lartë. Nëse ka mendime të pakicës, gjyqtarët e pakicës do të lexojnë vendimet e tyre.

7. DEKLARATA TË VEÇUARA PËR MASËN E DËNIMIT DHE VENDIMI I MASËS SË DËNIMIT

Nëse e lejon koha, i jepet fjala si akuzës edhe mbrojtjes të paraqesin me gojë pretendimet e tyre në lidhje me masën e dënimit. Vendimi më pas shpallet në seancë nga gjyqtarët dhe mund të përfshijë dëmshpërblimin nëse kjo është kërkuar nga prokurori apo mbrojtësi i viktimës në fillim të seancës. Nëse e lejon koha, gjyqtari e shpall vendimin së bashku me masën e dënimit nëse është vendosur fajësia, siç u përshkrua më lart.

SHTOJCA 3: SHEMBULL I RASTI STUDIMOR PËR PJESËN TEORIKE TË AKTIVITETIT

SHËNIM: Ky rast studimor bazohet në një sërë faktesh që shfaqen në një çështje të suksesshme, e cila ka rezultuar në një dënim, dhe është marrë nga analiza e UNODC-së për rastet e trafikimit të personave në Republikën e Shqipërisë, Tiranë 2022, me shtjellime.

TRAFIKIMI PËR SHFRYTËZIM SEKSUAL DHE PUNË TË DETYRUAR JASHTË VENDIT/SI METODEË KONTROLLI NËPËRMJET LIDHJES ROMANTIKE.

Amelia, një vajzë 18-vjeçare naive dhe romantike, ka ëndërr të lidhet me një djalë që do të kujdeset për të dhe që do ta vlerësojë. Por, ajo nuk ka guxim të dalë në takime. Amelia i hapet kushërirës së saj 26-vjeçare, Aria. Kjo i thotë se njeh një burrë që është i këndshëm dhe i kujdesshëm dhe që mund të mbajë bashkëshorten pa problem, dhe e pyet Amelian nëse ka interes ta takojë. Amelia i beson gjykimit të kushërirës dhe ndihet e mbrojtur, dhe duke qenë se përfshihet një familjare, bie dakord.

Aria e shoqëron Amelian në takimin e parë me burrin e përmendur me lart, që quhet Niku. Ai është simpatik e dorëlëshuar, dhe e trajton Amelian me gjithë të mirat në një kafene në Tiranë. Ajo fillon ta takojë rregullisht dhe, pas takimit të parë, pranon ta takojë vetëm, pa praninë e kushërirës. Brenda pak javësh, Niku i propozon për martesë, dhe ata fejohe. Kur lajmi i prezantohet familjes së Amelias, e ëma nuk është dakord, pasi e njohin shumë pak familjen e Nikut dhe ai nuk ka bërë asgjë që të bëhet një takim midis familjeve. Ky dyshim rezultoi i drejtë, pasi Niku figuronte i martuar ndërkohë që i kishte propozuar Amelias.

Niku i sugjeron Amelias që të udhëtojnë jashtë vendit për një jetë më të mirë. Në fillim, Amelia heziton pasi ajo e do familjen si dhe nuk flet asnjë gjuhë të huaj. Megjithatë, Niku e josh duke i përshkruar një jetesë të mirë që ata të dy mund të kenë në Kosovë duke e bindur se ai do ta ndihmojë që atje të kenë një jetë më të mirë. Kështu, Amelia pranon të shpërngulet në Kosovë dhe, duke vepruar sipas këshillave të Nikut, e njofton familjen në momentin e fundit, në mënyrë që ata të mos e pengonin.

Gjatë kësaj kohe, Niku i kërkon ndihmë Amelias që të gjejë një grua për vëllain e tij, Alketin. Sipas kërkesës së Nikut, Amelia e prezanton Alketin me shoqen e saj 16-vjeçare Lorna. Lorna del në disa takime me Alketin, dhe ky i shprehet se është i dashuruar me të dhe i kërkon të martohet. Lorna pranon të fejohe si dhe të shpërngulen të dy në Kosovë.

Niku i kërkon Amelias që fillimisht të shoqërojë Alketin dhe Lornën në Kosovë, pasi nuk mund ta lërë ende biznesin e tij në Tiranë, e më pas do t'u bashkohet në Kosovë. Ndonëse në fillim është në mëdyshje, Amelia i beson gjykimit të Nikut dhe pajtohet me planin.

Amelia dhe Lorna shoqërojnë Alketin në Kosovë, dhe çdo shpenzim të udhëtimit e paguan Alketi. Ky i dërgon vajzat të punojnë si kameriere në Kosovë, duke u premtuar se do t'i ndihmojë të gjejnë shtëpi. Në bashkëpunim me pronarin e lokalit, të quajtur Drini, ai i bind vajzat të kërcejnë me klientët në barin që punonin me qëllim që të fitonin më shumë para. Vajzat, të cilat i besojnë Alketit, bien dakord, megjithëse ato vetë janë rritur në mënyrë strikte dhe hezitojnë të kërcejnë me burra të panjohur.

Ato punojnë çdo natë nga ora 6 e pasdites deri në 6 të mëngjesit, pa pushuar dhe pa ngrënë e pirë. Vajzat jetojnë në një dhomë që ndodhet sipër lokalit, bashkë edhe me 4 vajza të tjera. Ato nuk ushqehen mjaftueshëm dhe flenë dy vajza në një krevat. U kanë dhënë celularë në mënyrë që komunikimi me Alketin të jetë sa më i thjeshtë. Ai u thotë se nuk mund të largohen nga ambienti i lokalit pa të, pasi rrezikojnë të arrestohen nga policia lokale për shkak sepse nuk kanë viza.

Pas 2 javësh, Alketi fillon të ankohet për gjendjen e tyre të varfër ekonomike, dhe u kërkon vajzave të

rrisin të ardhurat duke u angazhuar në marrëdhënie seksuale me disa klientë. Ai thekson se kjo do të jetë një gjë e përkohshme dhe se do të kontrollojë personalisht klientët për t'u garantuar sigurinë e vajzave. Ai shton dhe se sukcesi i zhvendosjes në Kosovë varet nga ato dhe se pa ato ai dhe Niku nuk do të kenë mjaftueshëm. Ai u thotë vajzave se sa shumë i do dhe u beson. Këto fjalë thyejnë hezitimin e vajzave dhe ato pranojnë ta bëjnë këtë për një periudhë të përkohshme.

Përveç detyrave të "rregullta" të kamerieres dhe kërcimit, Amelia dhe Lorna fillojnë të angazhohen në marrëdhënie seksuale me klientët. Fillimisht pritej që të flinin me një klient në natë, por kërkesa u rrit dhe pas një muaji pritej të flinin me 6 klient në natë. Në një moment, Amelia e përdor celularin për të komunikuar me të ëmën por i thotë se çdo gjë shkon mirë.

Nënës së Amelias i ngrihen disa dyshime dhe e kallëzon rastin në policinë e Kosovës. Nëpërmjet një procedure të përbashkët hetimore vajzat lokalizohen, e transportohen në Shqipëri, ku dërgohen në një strehimore. Gjatë intervistës fillestare në Shqipëri me policinë, vajzat refuzojnë të dëshmojnë kundra Nikut dhe Alketit, duke pretenduar se i duan. Vetëm pasi qëndrojnë në strehëz për 2 javë dhe intervistat kryhen në prani të një punonjësi social, ato ndryshojnë versionin dhe faktet dhe i tregojnë policisë të vërtetën.

Pyetje për reflektim:

1. A pasqyron rasti elemente të trafikimit? Analizoni:
 - » "Veprimet", "mjetet" dhe "qëllimet e shfrytëzimit" që i përkasin Amelias dhe Lornës.
 - » Në veçanti referojuni elementit "mjete". A ka "forma të tjera detyrimi"? "Mashtrim"? "Përfitim nga gjendja sociale, fizike apo psikologjike"?
 - » Pjesët e marra nga Niku, Alketi, Drini. A janë të gjithë trafikantë?
 - » A ka rëndësi që nuk është ushtruar dhunë ndaj Amelias dhe Lornës?
2. A është ky trafikim për shfrytëzim seksual? Punë dhe shërbime të detyruara? Skllavëri? Forma të ngjashme me skllavërinë? Cilat fakte janë të rëndësishme për secilën formë të shfrytëzimit?
3. A dhanë pëlqimin e tyre Amelia dhe Lorna që të shfrytëzohen? Nëse po, a ka rëndësi kjo? Pse po ose pse jo?
4. Cilat janë vulnerabilitetet e Amelias? Të Lornës? Si ndikojnë ato në analizën tuaj të rastit?
5. Cilat janë pikat e forta për provat e kësaj çështjeje? Po pikat e dobëta?
6. Cilat prova duhet të paraqesë prokuroria në gjykatë? A duhet të përfshijë dëshminë e një eksperti? Një certifikatë lindjeje? Fotografji?
7. Cilat janë disa nga praktikat e mira në këtë çështje?
8. Çfarë hapash për mbrojtjen e viktimave do t'i rekomandonit gjyqtarit të ndërmarrë në sallën e gjyqit?
9. Nëse do të dënonit të dyshuarit, çfarë dënimesh do t'u jepnit? A do të përfshinte dëmshpërblimin? Pse?

SHTOJCA 4: SHEMBULL I SKENARIT TË NJË ÇËSHTJEJE PËR GJYOQ IMITUES

Adriana dhe Besart Hysa janë motër e vëlla. Nëna e tyre, Flutura, ndërroi jetë kur ata ishin përkatësisht 18 dhe 12 vjeç. Adriana ka probleme fizike në njërin këmbë. Që kur u divorcuan prindërit, kur ishin ende foshnja të vogla, nuk kanë pasur asnjë kontakt me të atin apo me ndonjë prej të afërmeve, përveç se me tezen, Era Gjoka, dhe të shoqin e saj Agron Gjoka. Në varrimin e së ëmës, Adriana dhe Besarti ishin shumë të shqetësuar e të trembur për shkak se mund të përfundonin të jetonin në mes të katër rrugëve. Era u ofroi t'i merrte të jetonin në shtëpinë e saj, por i paralajmëroi se do të duhej të punonin për të nxjerrë bukën e gojës.

Kushtet e jetesës në shtëpinë e Erës dhe të Agronit ishin të vështira. Shtëpia kishte vetëm 3 dhoma dhe nuk kishte ngrohje të mjaftueshme për dimër dhe as freskim për verë. Në ditë me shi, ç'binte jashtë hynte brenda nga tavani i dhomës së ndenjjes që pikonte. Era dhe Agroni flinin në njërin dhomë dhe tre fëmijët e tyre të moshës 10, 12, dhe 14 vjeç flinin në dhomën tjetër. Adriana dhe Besarti flinin në dyshemenë e dhomës së ndenjjes dhe gjatë ditës i palosnin shtresat dhe i hiqnin prej aty. Pavarësisht nga kushtet e vështira të jetesës, ushqimi bazë ishte i mjaftueshëm për të gjithë.

Familja ia dilte me vështirësi. Agroni nuk kishte një punë të qëndrueshme, po bënte punë të rastit si kopshtari, bojaxhi, riparime të ndryshme. Era pastronte në shtëpi të ndryshme 3 herë në javë. Pavarësisht nga vështirësitë ekonomike, Era dhe Agroni këmbëngulnin që fëmijët e tyre të shkonin në shkollë rregullisht, ndonëse djalin e madh Agroni e kërkonte ta ndihmonte në punët që gjente. Kur Agroni mbetej pa punë, fëmijët i nisnin të lypnin në rrugë.

Sapo arritën në shtëpinë e tyre, Agroni u tha Adrianës dhe Besarti se me kënaqësi do t'u ofronte shtëpinë e tij si strehë, dhe se nuk donte t'i shikonte të jetonin në mes të rrugëve. Megjithatë, familja ishte e varfër dhe nuk mund t'ia dilte mbanë pa ndihmën e tyre. Më tej, u tha se shpresonte që të bënin sa të mundeshin për të shprehur mirënjohjen ndaj familjes, duke lypur në rrugë për të fituar para, që mund të ndihmonin për të siguruar ushqim për veten dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Adriana dhe Besarti ranë dakord me dëshirë. Ata ishin falënderues që kishin një strehë dhe vendosën të tregoheshin të dobishëm.

Çdo ditë pasi hanin një mëngjes të pakët, vëlla e motër dilnin në rrugët e Tiranës dhe u lypnin shoferëve dhe kalimtarëve. Për shkak të moshës së vogël të Besartit dhe gjendjes së pamundur fizike të Adrianës, njerëzit ndjenin keqardhje dhe në këtë mënyrë vëlla e motër mund të fitonin para në shuma të arsyeshme. Të dy dilnin për të lypur për 12 orë çdo ditë, në mot me diell a me shi, në të ftohtë acar a në vapë përvëluese, për gjashtë ditë e gjysmë në javë. Kur ktheheshin në shtëpi, lekët i merrnin Agroni ose Era. Adriana dhe Besarti nuk mbanin asnjë lek për vete, se mendonin që familja kishte nevojë për ato lekë.

Paratë e fituara nga lypja ndihmuan në përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjes. Gjatë tetë muajve që pasuan, mundën të blinin ngrohëse dhe disa rroba për tre fëmijët e Erës dhe Agronit. Me këto para, familja mund të blinte ushqime më të mira dhe të një herë në javë dilte nëpër dyqane. Adriana dhe Besarti nuk shkonin me pjesën tjetër të familjes kur ata dilnin.

Pas shtatë muaj lypje, Agroni filloi të mbikëqyrë se sa shumë fitonin Adriana dhe Besarti. Ai filloi t'u kërkonte të sillnin më shumë para në shtëpi çdo ditë. U tha se familja kishte nevojë për më shumë para për të riparuar çatinë dhe se aq para sa sillnin nuk mjaftonin. Kur nuk sillnin aq sa u kishte kërkuar, Agroni filloi të ngrinte zërin dhe të bënte veprime kërcënuese. E shoqja, Era, përpiquej ta qetësonte por i tha Adrianës se nëse nuk sillte më shumë para në shtëpi, nuk do të mund të jetonin më me ta.

Pas tetë muajsh, kur si vëllai edhe e motra nuk arritën të sillnin aq sa u kishte kërkuar Agroni, ky i tha Adrianës të fillonte të vidhte që të fitonte më shumë. Në një rast, Adriana i vodhi ca lekë njërit që shiste në rrugë. Për këtë Agroni e përgëzoi dhe i kërkoi edhe Besartit të fillonte të vidhte si e motra. Po për këtë, Adriana u ndje tmerrësisht e shqetësuar. Jo vetëm që ndihej keq me veten se kishte vjedhur, por s'mund të duronte më e të lejonte që edhe i vëllai po fillonte t'i hynte rrugës së kriminalitetit.

Në këtë pikë, Adriana shkoi në polici dhe bëri kallëzim. Një oficer i policisë gjyqësore nga njësia e posaçme e mori në pyetje, pas konsultimeve dhe udhëzimeve që mori nga prokurori. Pas intervistës me të, oficeri njoftoi Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve që të dërgonte një punonjëse e të merrej me rastin për të mbështetur Besartin, i cili është i mitur, gjatë kësaj interviste dhe për ta referuar në strehëz. Agjencia dërgoi një punonjëse, Besjana Leka, e cila punonte në atë zonë dhe e kishte parë Besartin që lypte në rrugë dhe ishte përpjekur të vendoste një marrëdhënie me të.

SHTOJCA 5: SHEMBUJ ME PJESË PROVASH NGA NJË GJYQ IMITUES AKTUAL

PJESË NGA PROVAT

SHËNIME:

- » Pjesët nga provat të paraqitura më poshtë u prodhuan për një gjyq imitues që kishte të bënte me lypjen e detyruar të një vëllai të mitur dhe një motre me aftësi të kufizuara, që u zhvillua në shkurt 2022 në Tiranë.
- » Shtojca 5 është ndarë në dy pjesë: listë e roleve dhe provave të gjyqit imitues. si dhe vetë pjesët e provave.

A. ROLET DHE PROVAT E GJYQIT IMITUES

Rolet:	
3 gjyqtarë	4 dëshmitarë të akuzës (viktima e rritur, shitësi, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, hetuesi i policisë)
2 prokurorë	2 të pandehur
1 avokat mbrojtës për Agron Gjakën	1 avokat mbrojtës për viktimën e mitur
1 avokat mbrojtës për Era Gjakën	1 avokat mbrojtës për viktimën e rritur

PROVAT QË DUHEN PARAQITUR NË GJYKIM:

AKUZA:

- » 4 dëshmitarë (Adriana, shitësi, Punonjësi i Kujdesit për Fëmijët, Oficeri i Policisë Gjyqësore).
- » Ekspertiza e psikologut klinik që analizon simptomat e traumës së Adrianës dhe që i lidh me trafikimin.
- » Certifikata e lindjes së viktimës së mitur.
- » Certifikata e vdekjes së Flutura Hysës.
- » Fotografi që tregojnë rroba të rrekosura dhe viktimat në gjendje jo të mirë shëndetësore, ndërkohë që janë duke lypur.
- » Teksti i zbardhur i shqyrtimit audio-vizual të viktimës së mitur nga prokuroria.

PROVA SHITESË QË LIDHEN ME MARRJEN NË PYETJE TË TË PANDEHURVE:

- » Intervistë e të pandehurit 1 (Agron) para policisë gjyqësore.
- » Intervistë e së pandehurës 2 (Era) para policisë gjyqësore.

MBROJTJA

- » Dëshmitarët – do të varen nga strategjia e mbrojtjes. Ata mund të vendosin që të dëshmojnë të dy personat e akuzuar, ose vetëm njëri, ose asnjëri. Gjithashtu, mund të vendosin për të thirrur një dëshmitar surprizë (si për shembull, një mik që të dëshmojë se sa mirë i trajtonin viktimat).
- » Dokumentet – do të jenë në varësi të strategjisë dhe aftësisë improvizuese të mbrojtjes. Shembuj të mundshëm – fotografi të një vakti tipik në shtëpinë e të pandehurve me viktimat dhe të pandehurit dhe fëmijët e tyre, ulur rreth një tavoline me ushqim të bollshëm, ose fotografi e viktimave që kanë dalë shëtitje me të pandehurit dhe familjen e tyre.

B. PJESË NGA PROVAT**1. INTERVISTA E VIKTIMËS 1, ADRIANA HYSA, NGA POLICIA GJYQËSORE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Procesverbal

Për marrjen e informacionit nga persona që japin informacion në lidhje me hetimin

Tiranë, më 21 shtator 2020

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, në bazë të neneve 297, 155 - 160 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Penale, e mbaj këtë procesverbal për marrjen e informacionit që ka të bëjë me veprën penale, nga Adriana Hysa, e bija e Fluturës dhe Besimit, lindur më 9 nëntor 2002 në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, arsim 8-vjeçar, pa profesion, gjendja civile e pamartuar, banore në Rrugën e Kavajës, banesa nr. 13, numri i telefonit 0673580045 82, pa precedentë penale, nr. ID #K35786523K.

Pas shpjegimit të neneve 150 deri në 160 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë rregullat e dëshmisë, u pyet për të treguar gjithçka është në dijeni të saj që ka lidhje me veprën penale dhe personat e përfshirë, të cilëve u atribuohet kjo vetëm, si dhe;

Pas paralajmërimit për përgjegjësinë penale në rast të dëshmisë së rreme para oficerit të policisë gjyqësore, dhënia e informacionit për të cilin ajo është në dijeni se është plotësisht apo pjesërisht i pavërtetë ose fsheh fakte apo prova, dënohet me burgim deri në 6 muaj, sipas nenit 305/b të Kodit Penal.

Në vullnetin e saj të lirë, shtetasja Adriana Hysa

DEKLARON:

Unë banoj në adresën e mësipërme së bashku me vëllanë, tezen, burrin e saj dhe fëmijët e tyre.

Pyetje: Mund të na thuash emrin dhe moshën si dhe një përshkrim për veten tënde ?

Përgjigje: Më quajnë Adriana Hysa. Mbusha 18 vjeç më 9 nëntor 2020. Siç mund ta shikoni, vuaj nga këmba e majtë dhe kjo ma vështirëson jetën. Po jam mësuar të jetoj edhe me këtë gjendje. Nëna më vdiq në janar dhe kam një vëlla që është 12 vjeç. Quhet Besart. Jemi shumë të afërt me njëri tjetrin.

Pyetje: A mund të më tregosh si u takove për herë të parë me Erën dhe Agron Gjokën?

Përgjigje: Era Gjokën e njohim që kur kemi lindur. Është te zja jonë dhe takoheshim shpesh me të kur mami ishte gjallë. Me Agronin shiheshim më rrallë se me tezen, kur mami ishte gjallë. Por pas vdekjes së saj, shiheshim çdo ditë duke qenë se jetonim me Erën dhe Agronin.

Pyetje: Pse shkuat të jetonit me Erën dhe Agronin pasi ju vdiq nëna?

Përgjigje: S'kishim ku të shkonim tjetër. Babai u nda ng mami kur ne ishim të vegjël dhe ne nuk kemi asnjë kontakt fare me të dhe nuk e dimë as ku është. Të vetmit të afërm që kemi janë Era dhe Agroni. Në varrimin e mamit, si unë si Besarti qanim me të madhe, se humbëm mamin, por edhe nga frika se tani do të mbeteshim të vetëm fëmijë në mes të rrugës. Era ofroi të na merrte të jetonim me të dhe të shoqin, por na paralajmëroi se do të duhej të punonim për të siguruar jetesën tonë.

Pyetje: Më thuaj, sa kohë keni qëndruar me Erën dhe Agronin dhe si ju trajtonin ata?

Përgjigje: Ne kemi qëndruar me ta për rreth tetë muaj. Pata shpresuar se Era do të na tregonte ndopak ngrohtësi familjare, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Që të nesërmen pasi arritëm, na nxorën të lypim për të mbështetur jetesën për veten dhe familjen.

Në këtë pikë, Adriana filloi të qajë dhe u deshën disa çaste që ajo të qetësohej. Avokatja e saj mbrojtëse më kërkoi një pushim. Unë rashë dakord për një pushim 10 minuta. Pas pushimit, rifilluam me pyetjet.

Pyetje: A mund të na tregosh se çfarë ndodhi ditën që arritët?

Përgjigje: Kur arritëm, Era na shpjegoi se do të duhej të flinim në dysheme në dhomën e ndenjes, se dy dhomat e gjumit i kishte zënë familja. Ajo na dha shtresa dhe ne e kaluam natën, dhe të gjitha netët e tjera, duke fjetur në dysheme. Kur u kthyem në shtëpi, pak para darkës, Era na dha darkën për të ngrënë, që ishte sanduiç me bukë e djathë. Pas darkës, Era dhe Agroni u ulën me ne për të biseduar. Agroni na tha se duhet të ishim mirënjohës që ai dhe e shoqja na morën në shtëpi dhe duhet ta tregonim mirënjohjen duke lypur në rrugë. Në fillim i shokuam, sepse nuk e kishim bërë kurrë më parë këtë gjë, po meqë duhet të ishim mirënjohës për të pasur një shtëpi, ne ramë dakord ta bënim këtë gjë. Për të treguar që jemi të dobishëm, u përpoqëm me sa mundëm për të fituar sa më shumë para nga lypja.

Në këtë pikë, e intervistuar ndali së foluri dhe i vendosi duart mbi sy.

Për ta lejuar të vijonte me historinë e saj, i bëra një pyetje tjetër.

Pyetje: A mund të më përshkruash një ditë të zakonshme pasi shkuat të jetonit me Erën dhe Agronin?

Përgjigje: Hanim një mëngjes të lehtë me bukë e kos me familjen dhe kur fëmijët e familjes shkonin në shkollë rreth orës 7:45, ne bëheshim gati të dilnim në rrugë për të lypur. Ne lypnim nga shoferët dhe kalimtarët për rreth 12 orë në ditë, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Dilnim në rrugë gjashtë ditë të javës, nga e hëna në të shtunë. Të dielën dilnim vetëm gjysmë dite. Merrnim me vete ca bukë për ta ngrënë gjatë ditës dhe kur ktheheshim në shtëpi, Era na jepte çfarë mbetej nga vakti i familjes. Ne flinim në dysheme çdo natë.

Pyetje: A keni kundërshtuar ndonjëherë që të mos dilnit të lypnit?

Përgjigje: Ne, ishin tepër mirënjohës që kishim një shtëpi, e nuk kundërshtonim. Por unë i kërkoja Erës që Besarti të dilte më pak orë për të lypur për t'i dhënë mundësinë të shkonte në shkollë. Ajo më tha se ai nuk kishte nevojë të shkonte në shkollë dhe se familja kishte shumë nevojë për paratë që të dy ne fitonim.

Pyetje: A mund të më tregosh pak për gjendjen financiare të Erës dhe Agronit?

Përgjigje: Kur arritëm atje, ne pamë sa të varfër që ishin. Shtëpisë i pikonte çatia, nuk kishin as ngrohje as ftohje. Ishte ftohtë në dimër dhe nxehtë në verë. Agroni nuk kishte një punë fikse, por bënte punë ç't'i dilte, për shembull si kopështar ose bojaxhi. Era kishte punë si pastruese shtëpie, po vetëm për tre ditë në javë. Ndaj, paratë që fitonim ne ishin me rëndësi për ta.

Pyetje: A e përmirësuan situatën e tyre të ardhurat që ju fitonit?

Përgjigje: Po. Ne bënim sa mundnim për të fituar sa më shumë që t'i ndihmonim dhe që t'u tregonim se ishim të dobishëm. Pas ca kohe ata mundën të blenë ngrohëse si dhe rroba për fëmijët e tyre dhe ushqim më të mirë. Gjithashtu, filluan të shkojnë në qendër tregtare të dielave.

Pyetje: Më trego për fëmijët e tyre. A lypnin ata? A shkonin në shkollë?

Përgjigje: Ata kanë 3 fëmijë: Kreshniku 14 vjeç, Fatosi 12 dhe Dua 10. Të tre shkonin në shkollë, po disa herë Kreshniku ndihmonte të atin në ndonjë punë, dhe një apo dy herë në fillim nxirrnin edhe Fatosin për të lypur. Po shumë shpejt sapo erdhën ne, nuk e nxirrnin më.

Pyetje: A të kanë qëlluar ndonjë herë Era dhe Agroni ty dhe Besartin?

Përgjigje: Jo

Pyetje: Nëse keni rëndë dakord për të lypur, pse keni ardhur për një kallëzim në polici?

Përgjigje: Muajin e kaluar, gjërat filluan të ndryshojnë. Agroni filloi të na kërkonte të sillnim më shumë para në shtëpi çdo ditë se donte të riparonte çatinë e shtëpisë. Ne u përpoqëm e bëmë më të mirën po nuk arritëm të sjellim aq sa ai kërkonte. Nëse nuk arrinim të sillnim aq sa na kërkohet, ai filloi të ngrejë zërin dhe na kërcënoi se do të na duhej të largoheshim nëse nuk sillnim mjaft para. Era u përpoq ta qetësonte, por gjithsesi më tha se nëse nuk sjellim më shumë para në shtëpi, ne nuk mund të vazhdonim të qëndronim të jetonim me ta.

Kur nuk arritëm të sillnim në shtëpi aq sa na kërkonte Agroni, ai më tha të filloja të vidhja për të plotësuar aq sa na kërkohet. Unë nuk doja ta bëja këtë, po nuk kisha zgjedhje tjetër. Kështu, vodha ca para nga një shitës ambulant njëherë. Kur i solla paratë në shtëpi atë ditë, Agroni u gëzua dhe i tha edhe Besartit të vepronte po kështu. Ku ndodhi kjo, unë u ndjeva tmerrësisht keq. Unë u ndjeva keq jo vetëm për vjedhjen që kisha bërë vetë, por edhe se nuk mund të rrija duarkryq dhe të lejoja vëllanë të bëhej kriminal. U ndjeva shumë në faj që ai u detyrua të lypte dhe nuk ishte në gjendje të ndiqte shkollën, po nuk do të kishte të ardhme nëse do të merrej me krimin. Mendova se duhej të kisha bërë diçka për ta përmirësuar jetën e vëllait. Por, unë e kisha bllokuar atë në një jetë pa shpresë.

Në këtë pikë, e intervistuar shpërtheu në lot dhe nuk ndalej dot për rreth 10 minuta.

Përsëri, avokatja mbrojtëse kërkoi pushim dhe rekomanduam rifillimin e pyetjeve pas 10 minutash.

Pyetje: A keni mbajtur ndonjëherë nga paratë që fitonit nga lypja?

Përgjigje: Jo. Të gjitha ia sillnim Erës dhe Agronit. Mendoja se ato para u detyroheshim atyre meqë na kishin marrë në shtëpi dhe na kishin ushqyer.

Pyetje: A ju kanë trajtuar Era dhe Agroni ty dhe vëllanë tënd si familja e tyre?

Përgjigje: Ata na dhanë një vend për të jetuar dhe bukë për të ngrënë, por ata nuk na kanë trajtuar njësoj si fëmijët e tyre. Kur situata e tyre u përmirësua, ata u blenë fëmijëve të reja, por asnjëherë nuk menduan për ne. Ata bënë gjithçka mundën për t'i dërguar fëmijët në shkollë. Por nuk mendonin që edhe vëllai im kishte nevojë të kishte të njëjtën mundësi. Ata i çonin fëmijët e tyre në dyqane, po ne asnjëherë nuk na e ofruan këtë mundësi. Ata na tregonin ngrohtësi vetëm kur u sillnin para më shumë se zakonisht.

Pyetje: A kishit miq dhe të afërm të tjerë në Tiranë, përveç Erës dhe Agronit?

Përgjigje: Kishim disa shokë nga shkolla, por kishim turp t'u tregonim atyre për situatën ku ishim.

Kur e intervistuar mbaroi së foluri, e pyeta nëse kishte diçka tjetër për të shtuar.

E intervistuar u përgjigj se ajo e kishte prurë të vëllanë në rajonin e policisë dhe se ai ishte duke pritur jashtë. Ajo m'u lut ta intervistojta atë dhe ta referoja në një strehëz. Pas kërkesës së saj, kontaktova me Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, të cilët më premtuan se do të dërgonin një punonjës social përgjegjës për zonën ku lypnin Adriana dhe Besarti.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarën nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ajo u përgjigj në mënyrë pohuese dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.

Deklaruesja

Oficeri i policisë gjyqësore

2. INTERVISTA E VIKTIMËS I ADRIANA HYSA NGA PROKURORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Procesverbal

Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale

Në Tiranë, më 15 shkurt 2021, unë Edon Hysa, prokuror në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, në bazë të neneve 312, 155 - 160 e vijues të K. Pr. Penale, mbaj këtë proces-verbal për marrjen e të dhënave që tregojnë rrethanat e veprës penale nga shtetasi: Adriana Hysa, e bija e Fluturës dhe Besimit, lindur më 9 nëntor 2002 në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, arsim 8-vjeçar, pa profesion, gjendja civile e pamartuar, banore në Rrugën e Kavajës, banesa nr. 13, numri i telefonit 0673580045 82, pa precedentë penalë, nr. ID #K35786523

Pyetja zhvillohet në prani të avokatit të caktuar kryesisht nga organi procedues z. Ergi Sinani. të punonjësës së qendrës kombëtare pritëse të viktimave të trafikimit, juristes zj. Egla Shkurti.

Pasi iu shpjeguan nenet 155 deri 160 të K. Pr. Penale, të cilët bëjnë fjalë për rregullat e dëshmisë dhe iu kërkua që të tregojë gjithçka di për rrethanat e veprës penale dhe personin, te cilit i atribuohet vepra,

Pasi u paralajmërua për përgjegjësinë penale që ka nëse bën deklaram të rremë prokurorit duke dhënë shpjegime që i di se janë tërësisht ose pjesërisht të rreme apo fsheh fakte ose prova, në bazë të nenit 305/a i Kodit Penal, dënohet me gjobë, burgim deri në 1 vit burg .

Pasi iu shpjeguan të drejtat e viktimës së veprës së penale sipas nenit 58/2 të Kodit të Procedures Penale për të cilën është mbajtur proces-verbali përkatës për njoftimin e të drejtave, procedohet me pyetjen dhe marrjen e deklarimeve të viktimës.

Unë, Edon Hasa, deklaroj se po intervistoj Adriana Hysën në prani të avokatit të saj mbrojtës, Ergi Sinani, pasi kam lexuar intervistimin e saj nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, Lorik Marku, më datë 21 shtator 2020.

Fillova intervistën duke i treguar Adriana Hysës se sa herë që t'i nevojitet një pushim, duhet të më thotë dhe nuk do të ketë fare problem për të marrë një pushim. Gjithashtu, theksova se nuk do ta pyes atë të përsëris fakte që i ka treguar në intervistën e mëparshme, në mënyrë që të mos e shqetësoj më tepër. I thash se thjesht doja të bëja disa pyetje për sqarim të mëtejshëm. Ajo pohoi me kokë.

Pyetje: Më tregon diçka për veten.

Përgjigje: Më quajnë Adriana Hysa. Jam 18 vjeçe. Jam jetime dhe nuk kam asnjë në këtë botë veç vëllait më të vogël, Besartit që e dua pa masë.

Pyetje: Shoh që ke një aftësi të kufizuar dhe se tregohesh shumë trime. A pati ndikim kjo aftësi e kufizuar për sa të ndodhi kur ishe në shtëpinë e Agron dhe Era Gjokës?

Përgjigje: Jam mësuar tashmë me problemin e këmbës, por ata ma bënë të vështirë duke qëndruar në rrugë, duke lypur nga mëngjesi në darkë. Gjithashtu, Agroni më tallte për aftësinë e kufizuar që kam. Vazhdimisht më vinte pengesë dhe më fliste me përçmim e zemërim. Edhe fëmijët e tij i nxiste të më përqeshnin dhe të më vinin pengesë me qëllim. Unë u bëra objekt i lojrave mizore nga ana e tyre.

Pyetje: A mban mend ndonjë incident të veçantë kur Agroin të vuri pengesë me qëllim ose të ka folur në mënyrë abuzive?

Përgjigje: Kjo ndodhte pothuaj çdo ditë, por mbaj mend disa incidente që ishin më të rëndë se të tjerë. Mbaj mend sidomos herën e parë që ndodhi. Një ditë, s'kisha shumë që isha kthyer në shtëpi, ai fillo të më fliste me tallje. Më tha se askush nuk do të donte të martohej me mua, apo të më merrte prej tij, sepse isha çalamane. Pra, unë nuk do të mundesha të ikja asnjëherë nga shtëpia e tij, dhe më e pakta që mund të bëja ishte të fitoja vetëm bukën e gojës. Ai më tha se isha e shëmtuar dhe i vinte për të vjellë kur më shihte. Kur u ngrita të largohem, ai u afrua dhe më vuri pengesë me qëllim.

Në një rast tjetër, kur e gjithë familja ishte ulur rreth tavolinës, ai filloi të më fyente para fëmijëve të tij. Ai më vinte nofka dhe tha se s'bëja për asgjë, përveç se të argëtoja njerëzit, si palaço cirku. Ai i nxiti fëmijët që të më preknin këmbën e të më pengonin. Pas këtij incidenti, fëmijët më vinin shpesh pengesë.

Kur Agroni filloi të më kërkonte gjithmonë e më shumë para, kërkesa shoqërohej edhe me një gjuhë abuzive dhe fyese në lidhje me aftësinë time të kufizuar. Më bënë të ndihesha e pavlerë. Po ashtu, më bënë të ndihesha se nuk kisha të ardhme dhe të isha e depresionuar dhe pa ndonjë dëshirë për të jetuar. Po të mos ishte për vëllanë, për të cilin duhet të kujdesem, mund të kisha bërë edhe vetëvrasje.

Pyetje: Pse nuk i ke përmendur këto gjëra të tmerrshme në polici kur të morën në intervistë?

Përgjigje: Më vinte turp.

Në këtë pikë, Adriana filloi të qante dhe e ndërpreme intervistën deri sa ajo mori veten dhe ishte në gjendje të vijonte.

Pyetje: Ju përmendët se ju kishit disa shokë shkolle në Tiranë. A mund të më tregosh më shumë për ta?

Përgjigje: Kisha një shoqe të ngushtë që quhet Diella. Ajo ishte vërtetë dielli i jetës sime, emrin e kishte fiks. Ne bënë gjithçka bashkë dhe shpesh shkoja për vizitë te familja e saj. E ëma ishte shumë e mirë ndaj meje dhe më tha se gjithmonë do të kisha një vend me të. Përveç kësaj shoqeje, kisha një të afërme të largët në Tiranë, që quhej Agnesa. Mendoj se ishte stërhalla e mamit, apo ndonjë kushërirë. Ajo ishte e moshuar që vinte ndonjëherë në shtëpinë tonë dhe na

sillte ndonjë ëmbëlsirë për mua dhe vëllanë.

Pyetje: Pse nuk i ke kontaktuar këta njerëz për të të ndihmuar?

Përgjigje: Më vinte turp.

Pyetje: Nuk e kam të qartë rolin e Erës në këtë histori. Mund të ma qartësosh?

Përgjigje: Era tregohej më e mirë se sa Agroni ndaj nesh. Ajo nuk e ngrinte zërin dhe nuk tallej me aftësinë time të kufizuar. Por ajo e mbështeste burrin e vet në gjithçka që ai thoshte dhe bënte. Ajo më tha se çfarë të thoshte ai, do të bëhej. Sepse ai ishte kreu i shtëpisë. Gjithashtu, kërcënoi se do të nxirreshim jashtë shtëpisë nëse nuk fitonim më shumë para, ashtu si kishte kërkuar edhe Agroni. Të dy mbetëm të zhgënjyer që ajo nuk na mbështeti.

E pyeta Adrianën nëse kishte ndonjë gjë tjetër për të shtuar dhe ajo u përgjigj me jo.

Intervista përfundoi në orën 11:00.

3. INTERVISTA ME VIKTIMËN E MITUR 2 – BESART HYSA - NGA OFICERI I POLICISË GJYQËSORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Procesverbal

Për marrjen e informacionit nga persona që japin informacion në lidhje me hetimin

Tiranë, 21 shtator 2020

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, në bazë të neneve 297, 155 - 160 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Penale, e mbaj këtë procesverbal për marrjen e informacionit që ka të bëjë me veprën penale, nga Besart Hysa, i biri Fluturës dhe Besimit, lindur më 11 maj 2009 në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, arsim 8-vjeçar, pa profesion, gjendja civile e pamartuar, banore në Rrugën e Kavajës, banesa nr. 13, numri i telefonit 06743789082, pa precedentë penale, nr. ID #K67521778K.

Gjithashtu, e pranishme është edhe Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijës e Njesisë Administrative 10, Besjana, Leka, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Nr 10, Rruga Gjon Muzaka, Tiranë.

Pas shpjegimit të neneve 150 deri në 160 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë rregullat e dëshmisë, u pyet për të treguar gjithçka është në dijeni të saj që ka lidhje me veprën penale dhe personat e përfshirë, të cilëve u atribuohet kjo vetëm, si dhe;

Pas paralajmërimit për përgjegjësinë penale në rast të dëshmisë së rreme para oficerit të policisë gjyqësore, dhënia e informacionit për të cilin ajo është në dijeni se është plotësisht apo pjesërisht i pavërtetë ose fsheh fakte apo prova, dënohet me burgim deri në 6 muaj, sipas nenit 305/b të Kodit Penal.

Me vullnetin e tij të lirë, Besart Hysa

DEKLARON:

Pyetje: Mund të na thuash emrin dhe moshën si dhe një përkrahim për veten tënde ?

Përgjigje: Më quajnë Besart Hysa. Jam 12 vjeç. Kam një motër që e quajnë Adriana. Jemi jetimë. Jetojmë me tezen dhe burrin e saj, Era dhe Agron Gjoka në Tiranë.

Pyetje: Kur filluat të jetonit me tezen dhe familjen e saj?

Përgjigje: Kur na vdiq mami.

Pyetje: Kur ndodhi kjo?

Përgjigje: Dimrin që kaloi. Kishte rënë borë.

Pyetje: A jeni të lumtur që të jetoni me tezen dhe familjen e saj?

Përgjigje: Që kur na vdiq mami, unë kam qenë shumë i trishtuar.

Pyetje: A mund të na përshkruash një ditë të zakonshme që kur keni shkuar të jetoni me tezen dhe familjen e saj?

Përgjigje: Motra më zgjon në mëngjes. Ajo thotë se duhet të çohemi herët në mëngjes që të bëhemi gati për punë. Hamë mëngjes dhe pastaj shkojmë në punë. Ne punojmë deri në darkë dhe më pas kthehemi në shtëpi për të ngrënë darkë e më pas biem të flemë. Ne flemë në dyshe me dhomën e ndenjjes.

Pyetje: A shkon në shkollë?

Përgjigje: Kur mami ishte gjallë, shkoja në shkollë. Po që kur ajo ka vdekur nuk shkoj më.

Pyetje: Çfarë lloj pune bëni çdo ditë?

Përgjigje: U kërkojë shoferëve dhe kalimtarëve në rrugë për para për të ndihmuar familjen tonë.

Pyetje: A ndihesh mirë me këtë punë që bën?

Përgjigje: Disa herë kam ftohtë dhe i lodhur dhe i uritur. Ne hamë vetëm bukë gjatë ditës dhe më merr malli të shkoj në shkollë me shokët. Po Adriana thotë se duhet ta bëjmë këtë për të ndihmuar familjen dhe për të mbështetur veten dhe të kemi mjaft ushqim për të ngrënë. E dua shumë Adrianën dhe përpiqem të bëj çfarë më thotë.

Pyetje: A sillen mirë me ju tezja dhe burri i saj?

Përgjigje: Ata na japin një vend për të jetuar dhe ushqim për të ngrënë. Pa ata, ne do të ishim në rrugë.

Pyetje: A ju flet keq ndonjëherë burri i tezes?

Përgjigje: Disa herë ai e ngre zërin dhe na thotë se duhet të fitojmë më shumë para ose nuk do të mund të vazhdojmë të jetojmë më me të.

Pyetje: A ju kanë qëlluar apo ju kanë dhënë ndonjë shpullë tezja dhe burri i saj?

Përgjigje: Jo

Pyetje: A ka ndryshuar ndonjë gjë që kur keni filluar të jetoni me tezen dhe familjen e saj?

Përgjigje: Kohët e fundit, burri i tezes na ka kërkuar të sjellim më shumë para në mënyrë që të rregullojë çatinë. Ne jemi përpjekur me sa mundemi, por nuk ia kemi dalë shumë mirë. Prandaj, ai ngre zërin e bërtet dhe na thotë se po nuk sollëm më shumë para, nuk do të vazhdojmë të jetojmë më me ta.

Në këtë pikë, i intervistuari fillon të qajë dhe të dridhet dhe punonjësja e Agjencisë së Mbrojtjes së Fëmijës, zj. Leka, e qetëson dhe sugjeron të bëjmë një pushim për t'i dhënë kohë të qetësohet e të pijë një çaj.

Pas një pushimi gjysmë ore, rifillojmë pyetjet.

Pyetje: Si ndihesh kur burri i tezes të thotë se mund të mos vazhdoni më të jetoni me të?

Përgjigje: Më kap frika, sepse po na hodhi në rrugë, nuk kemi ku të shkojmë.

Në këtë pikë, i intervistuari i mban sytë poshtë dhe nuk është në gjendje të flasë për disa minuta. Kur e merr veten, rifilluam pyejtet.

Pyetje: A ju ka kërkuar burri i tezes të bëni gjëra të tjera përveç se ju ka kërkuar para?

Djali nuk përgjigjet.

Pyetje: A ju ka kërkuar burri i tezes që të bëni gjëra të tjera që nuk ke dashur të bësh?

Përgjigje: Po.

Djali filloi të qante përsëri dhe zj. Leka e qetëson. Pas 10 minutash, ajo e pyet nëse është në gjendje të vazhdojmë. Ai shprehet se po.

Pyetje: A ju ka kërkuar burri i tezes të vidhni që të fitoni më shumë para?

Përgjigje: djali pëshpërit - Po.

Pyetje: Re dakord për ta bërë këtë?

Përgjigje: Nuk iu përgjigja. Atë natë motra më tha se do të gjejë një mënyrë që unë të mos isha i detyruar të vidhja. Të nesërmen në mëngjes, në vend që të shkonim në punë, ajo shkoi në polici për kallëzim dhe prandaj jam edhe unë këtu.

Kur i intervistuari mbaroi së foluri, e pyeta nëse kishte diçka tjetër për të shtuar.

I intervistuari shtoi se më lutej që ta ndihmoja atë dhe të motrën sepse janë jetimë dhe nuk kanë njeri t'i ndihmojë dhe se motra ka gjithashtu probleme fizike. Ai filloi të qante sërish.

Zj. Leka e siguroi djalin se ajo do t'i ndihmonte atë dhe të motrën dhe i tha të mos shqetësohej.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarin nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ai u përgjigj në mënyrë pohuese dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.

Deklaruesi

Besart Hysa

Oficeri i policisë gjyqësore

Lorik Marku

I pranishëm

Besjana Leka

4. DËSHMIA E VIKTIMËS SË MITUR - BESART HYSA PARA PROKURORIT (PASI NUK DËSHMOI NË SEANCËN GJYQËSORE)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

PROCES-VERBAL

PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA PERSONI QË KA DIJENI PËR VEPRËN PENALE

Në Tiranë, më 30 mars 2021, unë Edon Hasa, prokuror në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, në bazë të neneve 160 - 155,312 e vijues të K. Pr. Penale, mbaj këtë proces-verbal për marrjen e të dhënave që tregojnë rrethanat e veprës penale nga shtetasi Besart Hysa, lindur më 11 maj 2009 në Tiranë dhe banues në Rruga e Kavajës, Banesa 13.

Pyetja zhvillohet në prani të avokatit të caktuar kryesisht nga organi procedues z. Asti Kolat dhe të punonjësës së Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijës, Njësia Administrative Nr. 10, zj. Besjana Leka.

Pasi iu shpjeguan nenet 155 deri 160 të K. Pr. Penale, të cilët bëjnë fjalë për rregullat e dëshmisë dhe iu kërkua që të tregojë gjithçka di për rrethanat e veprës penale dhe personin, te cilit i atribuohet vepra,

Pasi iu shpjeguan të drejtat e viktimës së veprës së penale sipas nenit 58/2 të Kodit të Procedures Penale për të cilën është mbajtur proces-verbali përkatës për njoftimin e të drejtave, procedohet me pyetjen dhe marrjen e deklarimeve të viktimës.

Deklaroj se unë, Edon Hasa, prokuror i çështjes Republika e Shqipërisë kundër Agron Gjoka dhe Era Gjoka, po regjistroj dëshminë nga i mituri Besart Hysa në praninë e Besjana Leka, përfaqësues e Agjencisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Asti Kola, avokati mbrojtës i Besart Hysës, me anë të mjeteve audio-vizive më 30 mars 2021. Dëshmia po regjistrohet në një dhomë miqësore për fëmijët dhe nuk është pjesë e mjediseve të gjykatës.

Pyetje: A mund të më tregosh sa vjeç je?

Përgjigje: Jam 13 vjeç.

Pyetje: Ç'familje ke?

Përgjigje: Kam një motër që e quajnë Adriana. Nëna na vdiq dimrin që shkoi, ndërsa babin s'e kam njohur kurrë.

Pyetje: A ke ndonjë hallë, teze, dajë, xhaxha?

Përgjigje: Era Gjoka është tezza ime.

Pyetje: Dhe Agron Gjoka është burri i tezes?

Përgjigje: Po burri i tezes. Nuk kemi lidhje gjaku. Era është tezza.

Pyetje: Ku jetuat pasi ju vdiq nëna?

Përgjigje: Adriana dhe unë shkuam të jetojmë me Era Gjikën dhe burrin e saj, Agronin.

Pyetje: Sa kohë qëndruat me ta?

Përgjigje: Që kur na vdiq mami e deri në vjeshtën pasardhëse.

Pyetje: A shkoje në shkollë gjatë kohës që qëndroje me ta?

Përgjigje: Jo

Pyetje: Pse jo?

Përgjigje: Agroni na tha se duhej të ndihmonim për të mbajtur familjen duke lypur. Ai tha se ishin të varfër dhe s'na mbanin dot dhe se ne duhet të ishim mirënjohës që ata na morën dhe duhet ta tregonim këtë duke fituar para nga lypja.

Pyetje: Si u ndjeve për këtë?

Pati një pauzë për 2 minuta.

Përgjigje: Unë pata një ndjesi të keqe në stomak, dhe më vinte turp. Nuk kisha bërë asnjëherë më parë një gjë të tillë dhe u ndjeva i trishtuar që nuk do të takohesha më me shokët e shkollës dhe nuk do të mësoja më asgjë. U shemb gjithçka. Më dukej se nuk kishte më ndihmë për mua në këtë botë.

Pyetje: I tregove xhaxhit [Agronit] se si u ndjeve?

Përgjigje: Jo, sepse nuk kishim vend tjetër ku të shkonim, dhe bashkë me motrën ramë dakord.

Pyetje: Kur filluat të lypnit?

Përgjigje: Ditën e nesërme pasi mbërritëm.

Pyetje: Sa orë në ditë lypnit?

Përgjigje: Nga mëngjesi në darkë.

Pyetje: Sa ditë në javë lypnit?

Përgjigje: Çdo ditë, po të dielën dilnim për të lypur vetëm gjysmën e ditës.

Pyetje: A mbanit ndonjë lek për vete?

Përgjigje: Shpenzonim para vetëm për bukë në drekë dhe pjesën tjetër ia jepnim Agronit.

Pyetje: Kur a jepnit paratë Agronit?

Përgjigje: Zakonisht ia jepnim paratë kur vinim në shtëpi, po disa herë ai vinte te ne në rrugë dhe na thoshte t'i jepnim paratë që kishim fituar deri në atë orë.

Pyetje: Ku flinit në shtëpinë e Agronit dhe Erës?

Përgjigje: Në dysheme në dhomën e ndenjjes.

Pyetje: A flinit në krevat?

Përgjigje: Jo

Pyetje: Po fëmijët e Agronit dhe Erës flinin në krevat?

Përgjigje: Po.

Pyetje: A shkonin në shkollë ata?

Përgjigje: Po.

Pyetje: Sa vjeç janë fëmijët e Agronit dhe Erës?

Përgjigje: Ata janë 14, 12, dhe 10 vjeç.

Pyetje: Agroni dhe Era, kanë blerë ndonjëherë rroba për ju?

Përgjigje: Jo

Pyetje: A u kanë blerë fëmijëve të tyre rroba?

Përgjigje: Po.

Pyetje: A ndihmuan familjen fitimet tuaj nga lypja?

Përgjigje: Po, ata blenë ngrohëse dhe rroba të reja për fëmijët e tyre.

Pyetje: Si ju trajtonin Era dhe Agroni?

Përgjigje: Na dhanë një vend për të banuar dhe ushqim për të ngrënë. Po ata nuk na treguan dashuri.

Pyetje: A ju trajtonte Era më mirë se Agroni?

Përgjigje: Ajo nuk e ngrinte zërin dhe nuk tallej me problemin e motrës në këmbë, si dhe përgatiste ushqim. Po gjithsesi mbështeste gjithçka që donte Agroni. Ajo na tha se ne duhet të lypnim në mënyrë që të ndihmonim familjen.

Pyetje: Pse u larguat ti dhe motra nga shtëpia e tyre?

U bë një pauzë 3 minuta dhe përfaqësuesja e agjencisë së mbrojtjes së fëmijës sugjeroi një pushim për çaj.

Prokurori e ripërsërit pyetjen pas pushimit.

Pyetje: Pse u larguat ti dhe motra nga shtëpia e tyre?

Përgjigje: Agroni filloi të na kërkonte të sillnim më shumë para në shtëpi, që të riparonte çatinë që pikonte. Kur nuk e arrinim këtë, ai e ngrinte zërin dhe na thoshte se nuk mund të vazhdonim të jetonim më me të nëse nuk sillnim më shumë para në shtëpi.

Një pauzë tjetër për 2 minuta.

Pyetje: Këtë a jua kërkoi edhe Era?

Përgjigje: Era nuk e ngrinte zërin po na tha se duhet të vepronim si ka thënë Agroni.

Pyetje: A ka ndodhur diçka tjetër që ju bëri të largoheni?

Përgjigje: Ai më kërkoi të vidhja në mënyrë që të sjell më shumë para në shtëpi. Në këtë pikë, Adriana tha se nuk mund të rrimë më aty dhe se duhet të shkojmë në polici.

Pyetje: Si u ndjeve për largimin?

Përgjigje: Kisha frikë, sepse nuk kishim ku të shkonim, por i besova Adrianës dhe bëra atë që më tha.

Pyetje: Si e trajtonte Agroni Adrianën?

Përgjigje: Ai e përqeshte për problemin me këmbën gjatë gjithë kohës. Disa herë ai dhe fëmijët e tij i vinin pengesë.

Pyetje: Pse nuk ia përmendët këtë policisë?

Përgjigje: Se nuk ma bënë këtë pyetje.

Besarti fillon të qajë me dënesë. Përfaqësuesja e agjencisë së mbrojtjes së fëmijës e qetëson dhe e merr në një dhomë tjetër. Pas 15 minutash rifillon dhënia e dëshmisë.

Pyetje: A ke ndonjë gjë tjetër që dëshiron të shtosh?

Përgjigje: Dua të bashkohem me motrën. Vetëm atë kam. Të lutem, më ndihmo!

Besarti shpërthen përsëri në lot.

Unë, Edon Hasa, deklaroj se këtu mbyllet dëshmia e Besart Hysës.

Data: 30 mars 2021

5. DEKLARIMET NË POLICI TË PUNONJËSIT TË MBROJTJES SË FËMIJËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Proces-verbal

Për marrjen e informacionit nga persona që japin informacion në lidhje me hetimin.

Tiranë, më 27 shtator 2020.

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, në bazë të neneve 297, 155 - 160 dhe më pas të Kodit të Procedurës Penale, mbaj këtë proces verbal për marrjen e informacionit për veprën penale, nga Besjana Leka, e bija e Anilës dhe Ilirit, lindur më 20 qershor 1980 në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim të lartë, me profesion punonjëse sociale, gjendja civile e pamartuar, banuese në adresën Rruga e Nikolla Tupe, #. 34, nr. cel #. 068784563, pa precedentë penale, ID #K67554378K.

Pas shpjegimit të neneve 150 deri në 160 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë rregullat e dëshmisë, u pyet për të treguar gjithçka është në dijeni të saj që ka lidhje me veprën penale dhe personat e përfshirë, të cilëve u atribuohet kjo vetëm, si dhe;

Pas paralajmërimit për përgjegjësinë penale në rast të dëshmisë së rreme para oficerit të policisë gjyqësore, dhënia e informacionit për të cilin ajo është në dijeni se është plotësisht apo pjesërisht i pavërtetë ose fsheh fakte apo prova, dënohet me burgim deri në 6 muaj, sipas nenit 305/b të Kodit Penal.

Në vullnetin e saj të lirë, shtetasja Besjana Leka

DEKLARON:

Pas marrjes së udhëzimeve nga Prokurori Edon Hasa, për të regjistruar deklarin e të intervistuarës, unë deklaroj se kam e identifikuar të intervistuarën dhe kam regjistruar deklarin e saj si më poshtë:

E nisa intervistën duke i shpjeguar të intervistuarës se po hetonim akuzat për trafikim ndaj Agron dhe Era Gjokës kundër Adriana dhe Besart Hysës, dhe se do t'i bëja disa pyetje në lidhje me akuzën.

Pyetje: Çfarë mund të më tregoni për përvojën tuaj dhe kualifikimet profesionale?

Përgjigje: Jam trajnuar si punonjëse sociale dhe prej shtatë vjetësh punoj në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve Nr 10, me fokus te abuzimi me fëmijët. Unë punoj në zonën e Rrugës së Kavajës dhe

zonat rreth saj ku ka shumë fëmijë që merren me lypje. Jam edhe zëvendësdrejtuese e një ekipi të specializuar për intervistimin e fëmijëve.

Pyetje: Çfarë mund të na tregoni në lidhje me akuzat?

Përgjigje: Në muajt e fundit, kam vënë re një të mitur të quajtur Besart Hysa, që lyp në një lagje në Rugën e Kavajës. Në fillim, vetëm e vëzhgoja dhe vura re se rrobat i kishte të vjetra e të grisura dhe të pista, se lypte për orë të gjata dhe se hante vetëm bukë gjatë ditës. U përpoqa të futesha në bisedë me të, por ai ishte shumë ngurrues për të folur dhe vendosa se kishte nevojë për më shumë kohë për të krijuar besim tek unë. Vura re se një vajzë më e rritur në moshë, me një problem në këmbë, shpesh lypte në të njëjtën zonë dhe arrita të mësoj prej tij se ajo ishte e motra.

Në detyrat e mia si punonjës i mbrojtjes së fëmijës, e fotografova të miturin dhe motrën duke lypur dhe po ju dorëzoj fotografitë e kryera.

Sapo kisha planifikuar të thelloja përfshirjen time në këtë rast, kur ju më kontaktuat për të ardhur në rajonin e policisë e për të dhënë mbështetje për Besart Hysën.

Gjatë intervistës së tij, ai dukej i shqetësuar dhe se kishte nevojë për mbështetje. Prandaj, me kërkesën tuaj, u gjeta një vend për ta sistemuar në strehëzën për djemtë e mitur. Ai më shprehu çlirim që ndjeu kur mori vesh se mund të largohej nga shtëpia e tezes dhe familjes së saj dhe të kishte ushqim rregullisht dhe strehim. Po ashtu, shprehu gëzim kur i premtova se do ta regjistronim edhe në shkollë. Megjithatë, ai ishte i trishtuar që e motra nuk lejohej të qëndronte në të njëjtën strehëz.

E kam vizituar disa herë që kur ka shkuar në strehëz dhe kam parë ndryshim në sjelljen e tij. Është më social dhe shfaq më shumë besim, më është hapur për ndjenjat dhe dëshirat. Ende ka çaste ngashërimi dhe disa herë përjeton makthe dhe kujtime të vështira, por mendoj se është drejt rrugës së shërimit.

Kur e intervistuar mbaroi së foluri, e pyeta nëse kishte diçka tjetër për të shtuar dhe ajo u përgjigj me jo.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarën nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ajo u përgjigj me po dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.

I shënova fotografitë e dorëzuara nga ajo si prova 1 dhe 2.

27 shtator 2020

Nënshkrimi: Besjana Leka

6. DEKLARIMI NË POLICI I SHITËSIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Proces-verbal

Për marrjen e informacionit nga persona që japin informacion në lidhje me hetimin.

Tiranë, më 27 shtator 2020.

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, në bazë të neneve 297, 155 - 160 dhe më pas të Kodit të Procedurës Penale, mbaj këtë proces verbal për marrjen e informacionit për veprën penale, nga Ferid Gjini, i biri i Dritës dhe Betimit, lindur më 14 mars 1970 në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim të mesëm, me profesion i punësuar pranë subjektit fizik, gjendja civile i martuar, banues në adresën Rruga "Vllazen Huta" Nr.110, Tiranë, nr. cel #. 0665432123, pa precedentë penale, ID #K43564127K.

Pas shpjegimit të neneve 150 deri në 160 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë rregullat e dëshmisë, u pyet për të treguar gjithçka është në dijeni të saj që ka lidhje me veprën penale dhe personat e përfshirë, të cilëve u atribuohet kjo vetëm, si dhe:

Pas paralajmërimit për përgjegjësinë penale në rast të dëshmisë së rreme para oficerit të policisë gjyqësore, dhënia e informacionit për të cilin ajo është në dijeni se është plotësisht apo pjesërisht i pavërtetë ose fsheh fakte apo prova, dënohet me burgim deri në 6 muaj, sipas nenit 305/b të Kodit Penal.

Pas marrjes së udhëzimeve nga Prokurori Edon Hasa, për të regjistruar deklarinin e të intervistuarit, unë deklaroj se kam identifikuar të intervistuarin dhe kam regjistruar deklarinin e tij si më poshtë:

Në vullnetin e tij të lirë, shtetasi Ferid Gjini

DEKLARON:

E nisa intervistën duke i shpjeguar të intervistuarës se po hetonim akuzat për trafikim ndaj Agron dhe Era Gjokës kundër Adriana dhe Besart Hysës, dhe se do t'i bëja disa pyetje në lidhje me akuzën.

Pyetje: Më trego, me se merresh, çfarë pune bën?

Përgjigje: Unë kam një minimarket në Rrugën e Kavajës, këtu në Tiranë. Shes bukë, djathë, miell, makarona, ushqime që i nevojiten një familjeje.

Pyetje: Po ju tregoj një fotografi të Agron dhe Era Gjokës. A i njihni?

Përgjigje: Po i njoh mirë. Era vjen në dyqan për të blerë për shembull bukë dhe djathë. Agroni vjen shpesh e ble birra.

Pyetje: Po ju tregoj një fotografi të Adriana dhe Besart Hysa. A i njihni?

Përgjigje: Po i njoh. Shumë herë vijnë në dyqan rreth drekës e blejnë bukë. I kam parë që rrinë jashtë në rrugë dhe lypin, shoferëve të makinave apo kalimtarëve. Ata qëndrojnë rreth zonës së dyqanit për shumë orë të ditës.

Pyetje: Sa orë në ditë lypnin?

Përgjigje: Nuk jam në gjendje t'ju them saktësisht sa orë, por i shikoja në mëngjes kur hapja dyqanin rreth orës 8:30, dhe i kam parë të lypin në kohën e drekës dhe deri në mbrëmje. Megjithatë, isha i zënë dhe nuk i shikoja se çfarë bënin apo ku ishin gjatë gjithë orëve të ditës, çdo ditë.

Pyetje: A e keni parë ndonjëherë Agron dhe Era Gjakën me Adrianën dhe Besartin?

Përgjigje: Asnjëherë nuk e kam parë Erën me ta, vetëm disa herë, kam parë Agronin që u është afruar e ka folur me ta. Disa herë, e kam dëgjuar të ngrejë zërin dhe në ca raste, vajza, Adriana, i ka dhënë para. Pas këtij veprimi, ai ka hyrë në dyqan dhe ka blerë birra ose verë. Në një rast, Agroni iu afrua Besartit dhe unë pashë këtë i dha lekë Agronit.

Pyetje: A mund të na e shpjegoni këtë më në hollësi?

Përgjigje: Në një rast, Agroi iu afrua vajzës me probleme fizike në këmbë, Adrianës, dhe filloi t'i ngrinte zërin. Unë e dëgjova që i kërkonte asaj t'i jepte para. Ajo dukej e trembur prej tij dhe futi duart në xhep dhe i dha paratë. Ai u largua prej saj dhe hyri në dyqan ku bleu një birra.

Në një rast tjetër, unë e pashë atë që iu afrua Besartit, dhe i foli atij me një ton të ashpër. Pas kësaj, Besarti futi dorën në xhep dhe i dha Agronit paratë. Nuk e dëgjova se ç'u tha në këtë rast.

Unë e kam parë këtë gjë të ndodhë në disa raste, por nuk jam në gjendje t'ju them datën e saktë kur.

Pyetje: Na përshkruani ju lutem Adrianën dhe Besartin. A dukeshin në shëndet të mirë? Të lumtur?

Përgjigje: Marrëdhënia ime me ta ishte sipërfaqësore, por kisha vënë re se ata mbanin veshur të njëjtat rroba të vjetëruara, dhe ishin veshur hollë. Asnjëherë nuk buzëqeshnin.

Pyetje: A mund të shtoni ndonjë gjë për marrëdhënien midis Agron Gjakës dhe Adriana dhe Besart Hysës?

Përgjigje: Nga sa kam parë, Agroni i njihnte me siguri Adrianën dhe Besartin dhe ata ishin në një marrëdhënie me njëri-tjetrin. Po unë kam parë vetëm fragmente dhe nuk jam në gjendje të them me saktësi se çfarë ndodhte midis tyre. Mund të them vetëm se nuk dukeshin të ishin një marrëdhënie e mbështetur në dashuri.

Pyetje: A ke ndonjë gjë tjetër që dëshiron të shtosh?

Përgjigje: Jo

Pyetje: Nëse ju kujtohet ndonjë gjë tjetër, mos ngurroni të më kontaktoni.

Përgjigje: Patjetër.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarën nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ajo u përgjigj me po dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.

Data: 27 shtator

Nënshkrimi: F.G.

7. RAPORT EKSPERTIZE I PSIKOLOGUT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Çështja penale 20/21

para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Të pandehur: Agron Gjoka dhe Era Gjoka

Emri i ekspertit: Adriel Toska

Vendi i punës: Ekspert i pavarur

Unë, Adriel Toska, m'u kërkua nga prokurori, Edon Hasa, të jap mendimin tim ekspert për gjendjen psikologjike të Adriana Hysa, në lidhje me përvojën e pretenduar të trafikimit. Unë e jap këtë opinion ekspert në vend të dëshmisë në gjyq dhe deklaroj se e di që është detyra ime të them të vërtetën dhe se mund të jem subjekt i sanksioneve penale nëse nuk veproj në këtë mënyrë.

Më poshtë gjeni kualifikimin tim arsimor:

Unë kam një diplomë master në psikologjik klinike. Kam përfunduar specializimin si psikologe eksperte për gjykatën dhe jam e licencuar nga Urdhëri i Psikologut.

Jam certifikuar nga Ministria e Drejtësisë si Ekspert Gjykatë.

Më poshtë gjeni përvojën e punës:

Për dhjetë vjet kam punuar si psikolog klinike me grupe rinore të ndryshme vulnerabël. Përvoja përfshin shërbime psikologjike në OJF që punojnë me gra dhe vajza të abuzuara, përfshirë raste të dhunës seksuale. Kam më shumë se 5 vjet përvojë si eksperte e certifikuar pranë gjykatës.

Po ashtu, kam 7 vjet përvojë me viktimat e trafikimit të personave në veçanti.

Më poshtë gjeni raportin tim:

E intervistova Adriana Hysën në dy raste, menjëherë pasi erdhi në strehëz më 30 shtator 2020, dhe ca kohë më pas, më 4 janar 2021. Në këto raste, kam intervistuar edhe personelin e strehëzës për gjendjen e saj. Më poshtë gjeni informacion nga takimet me Adrianën dhe personelin e strehëzës dhe përfundimet e mia pas këtyre takimeve.

Takimet me Adrianën dhe personelin e strehëzës

Informacioni i mëposhtëm mbështetet në vëzhgimet e mia dhe në detaje që më janë referuar nga Adriana dhe personeli i strehëzës.

Më 30 shtator, Adriana shfaqti sjellje agresive. Ajo më kundërshtoi, u largua prej meje dhe kishte shpërthime zemërimi. Pas ca kohe, ia dola të fitoja një farë besimi dhe ajo më tregoi se kishte vështirësi të flinte, përjetonte ëndrra të këqija, dhe disa herë kishte ripërjetime ku i dukej sikur ishte kthyer në shtëpi të Era dhe Agron Gjoka ose sikur ishte në rrugë duke lypur. Kur i kërkova të më tregonte më shumë nga këto ripërjetime, ajo filloi të dridhej dhe më kërkoi të mos e pyetja më për këto, pasi i shkaktonin shqetësim akut dhe ankth. Ajo më tha se shpesh ndihej shumë e zemëruar me të gjithë dhe ndihej se nuk kishte ndihmë për të në këtë botë.

Vëzhgova se ajo ndihej në një gjendje hiper të axhituar në të cilën tensionohej kur i bëja pyetje të caktuar. Në një pikë të intervistës, ajo u mbyll në vetvete dhe refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve të mia.

Në atë rast, drejtuesja e strehëzës më referoi te menaxherja e rastit e cila ka më së shumti kontakt me Adrianën në strehëz. Ajo quhet Albana Murati. Ajo më tregoi se Adriana është tërhequr dhe nuk lidhet me gratë e tjera në strehëz. Ajo është e zemëruar në një pjesë të madhe të kohës dhe nevojitet të qetësohet. Disa herë bërtet në gjumë dhe disa herë fillon të dridhet dhe tregon ankth gjatë ditës.

Më 4 janar, Adriana u hap ndaj meje në një kohë më të shkurtës krahasuar me takimin e parë. Kësaj radhe, në fillim, ajo qante lehtë dhe e kishte të vështirë të ndalej. Gjendja e saj luhatej midis trishtimit, zemërimit, frikës. Secila gjendje zgjaste për një kohë të shkurtër dhe kapërcente shpesh nga një gjendje te tjetra. Dukej se kishte vështirësi të përqendrohej në një temë të caktuar dhe disa herë dukej konfuzë. Kur e pyeta për të ardhmen, më tha se nuk sheh të ardhme për veten dhe se do të donte të vdiste, përveç se i duhet të kujdeset për vëllanë e vogël, Besartin. Ajo më tha se ndihet e pavlerë.

Kur intervistova punonjësen e strehëzës, Albana Muratin, ajo më tha se Adriana e kishte të vështirë të mësonte gjëra të reja apo të ndërmerre edhe detyra të thjeshta si për shembull gatimi, dhe dukej se kishte kujtime që i ripërsëriteshin, të cilat ndërhyenin dhe e pengonin të lidhej me të tashmen. Kur e pyeta për natyrën e këtyre kujtimeve, Albana u përgjigj se Adriana i kishte thënë se gjatë gjithë kohës mendonte për kohën kur kishte jetuar në familjen Gjoka dhe i duhej të lypte në rrugë dhe se këto janë kujtime që i ripërsëriten. Ajo shtoi se Adriana nuk i besonte njeriut dhe ishte gjithmonë vigjilente për të mbrojtur veten nga çka ajo i shihte si sulme, ndaj u rrinte larg grave të tjera në strehëz madje edhe disave prej stafit. Megjithatë, shtoi se Adriana reagon mirë ndaj trajtimit të mirë konsistent dhe se Albana ia kishte dalë të vendoste një marrëdhënie me të.

Përfundime:

Mendimi im ekspert është se simptomat emocionale, konjitive, sjellore, sociale dhe të konceptimit të vetes të përshkuara më lart, përputhen me një traumë të rëndë të kaluar nga Adriana. Më tej unë konkludoj se kjo traumë ka ndodhur përgjatë një periudhe kohore dhe lidhet me kohën në të cilën Adriana ka jetuar me Agron dhe Era Gjokën. Këtë përfundim e mbështes në përshkrimin e saj për momente që rikujton të cilat u shpreh se lidhen me qëndrimin e saj në shtëpinë e tyre dhe me lypjen në rrugë, si dhe në informacionin e raportuar gjatë intervistës me personelin e strehëzës në lidhje me natyrën e kujtimeve që ripërsëriten të përjetuara nga Adriana.

Kam parë simptoma traumatike si ato që ka përjetuar Adriana te viktimat e krimeve si trafikimi i personave, pengmarrja, dhe në veçanti kur këto krime kryhen për periudha relativisht të gjatë

që shtrihen për muaj të tërë.

Sa i takon literaturës ku e mbështes opinionin im ekspert, i jam referuar edhe punës madhore të Dr. Judith Herman me titull "Trauma and Recovery" [Trauma dhe Rikuperimi].⁷⁷

Kualifikim: Nuk është në kompetencën time të validoj apo të hedh poshtë faktet e pretenduara nga Adriana kundër Agron dhe Era Gjoka. Ky opinion ekspert mund të përcaktojë vetëm se Adriana vuan nga simptoma të traumës që lidhen në mendjen e saj me periudhën kur jetonte me të pandehurit dhe simptoma të ngjashme traumatike janë tipike për viktime të krimeve si trafikimi i personave dhe pengmarrja.

Data: 15 janar 2021

Nënshkrimi:

⁷⁷. Judith Herman, M.D., "Trauma and Recovery", Basic Books 1997.

8. DEKLARIMI NË POLICI I TË PANDEHURIT AGRON GJOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

PROCES-VERBAL

për marrjen në pyetje të të pandehurit

Tiranë, 30 shtator 2020

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, autorizuar nga prokurori Edon Hasa, në bazë të neneve 38, 39, 48, 49, 304/2 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, mbaj këtë proces-verbal për marrjen në pyetje të të pandehurit: Agron Gjoka i biri i Dritës dhe Qemalit, lindur më 05 shtator 1977 në Elbasan, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim të mesëm, pa profesion, gjendja civile i martuar, me banim në adresën Rruga e Kavajes, Banesa 13 nr. tel #. 066378965, pa precedentë penalë, ID #J78093452J, akuzuar për kryerjen e veprës “trafikim i personave të mitur”, parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal.

Të pandehurit i është shpjeguar dhe ai pohon se:

I ka kuptuar të drejtat e tij, të dhëna me shkrim, sipas neneve 34/a dhe 34/b të Kodit të Procedurës Penale; të pandehurit i është shpjeguar në mënyrë të qartë dhe precize fakti që i atribuohet atij; atij iu kërkua të shpjegonte gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e tij sipas nenit 39/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Nëse i pandehuri nuk ka caktuar një avokat mbrojtës, atij do t'i caktohet një avokat për të dhe të pandehurit do t'i paguhet nga Shteti, sipas nenit 49, 309 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.

I pandehuri shpjegon dhe pohon se është i vetëdijshëm për të drejtat e tij sipas ligjit; ai u njoh me aktpadinë dhe deklaroi se:

Avokati që kam zgjedhur është Ismail Sula, nr. licencës 4321, dhe do të jap shpjegimet e mia për pyetjet tuaja.

Pyetje: Çfarë mund të më thoni për lidhjen që ke me Adriana dhe Besart Hysën?

Përgjigje: Unë jam burri i tezes së tyre. E ëma u vdiq në janar të këtij viti.

Pyetje: Çfarë mund të më thoni për kohën gjatë së cilës kanë jetuar me ju?

Përgjigje: Kur u vdiq e ëma, ishin të shqetësuar se nuk kishin ku të shkonin. Bashkëshortes i erdhi keq për ta, se nuk kishin familjarë të tjerë dhe u ofroi të jetonin me ne. Kështu, që ditën e

varrimit erdhën të jetonin me ne, dhe ne i mbështetëm deri sa ata u larguan nga shtëpia jonë në shtator. Ata hanin vaktet me ne dhe ne u përpoqëm të bënim më të mirën për t'u dhënë gjithçka mundnim.

Pyetje: Çfarë bënin gjatë ditës në kohën që jetonin me ju? A shkonte në shkollë Besarti?

Përgjigje: Ndonëse unë dhe ime shoqe i ofruam ta regjistronim në shkollë, Besarti nuk pranoi. Ai e shihte veten si burrin e familjes dhe donte të fitonte vetë para për të paguar për strehimin dhe ushqimin. Si vëllai edhe motra të dy e panë se ne ishim të varfër dhe ishin falënderues për kujdesin që ne treguam. Ata donin me gjithë zemër të ndihmonin të ardhurat e familjes.

Pyetje: A i dërguat ju Adrianën dhe Besartin për të lypur?

Përgjigje: Ata më pyetën se si mund të ndihmonin dhe unë u sugjerova se mund të provonin të bënin punë të rastit. Por ata nuk gjetën ndonjë punë, se nuk kishin zanat dhe në qytet papunësia është e madhe. Pastaj, ata vendosën të dalin të lypin. Unë u përpoqa t'i bind të mos e bënin këtë, por ishin shumë të gatshëm për të ndihmuar familjen.

Pyetje: Sa orë në ditë lypnin?

Përgjigje: Nuk e di, se ata dilnin nga shtëpia pasi kisha ikur unë dhe oraret e kthimit i kishim të ndryshme.

Pyetje: Jua jepnin juve çfarë fitonin?

Përgjigje: Po na jepnin pjesë të asaj që fitonin nga mirësia e zemrës së tyre, po ndoshta mbanin edhe ca para për vete.

Pyetje: Ku flinin?

Përgjigje: Flinin në dhomën e ndenjjes, se shtëpinë e kemi të vogël dhe nuk kishim ndonjë dhomë tjetër ku t'i sistemonim.

Pyetje: A flinin në krevat?

Përgjigje: Jo flinin në dysheme, se nuk kishim krevate shtesë, por u dhamë shtroje të mira që i mbanin ngrohtë. Ne jemi të varfër e nuk kemi lukse. Kur erdhën të jetonin me ne, nuk kishim ngrohëse. Çatia na pikonte, se nuk kishim lek ta riparanim. Megjithatë, bëmë sa mundëm të ndanim me ta atë që kishim.

Pyetje: A ju ndihmuan fitimet e tyre që të përmirësoni situatën tuaj?

Përgjigje: Me kalimin e kohës, nga puna që bënte gruaja si pastruese, dhe nga puna e krahut që bëja unë, bashkë me sa nxirrnin ata, arritëm të blinin ngrohëse dhe rroba për fëmijët, si dhe ndonjëherë të shkonim të bënim pazar të dielave. Adriana dhe Besarti ndihmonin me gëzim.

Pyetje: A u bletë edhe atyre rroba? A vinin me ju kur dilnit për të blerë?

Përgjigje: Ne blemë rroba për fëmijët tani, pasi ishin rritur dhe ato që kishin nuk u bënin më. Rrobat që kishin Adriana dhe Besarti ishin në gjendje shumë të mirë. Pastaj, ata fitonin vetë para dhe mund të blinin rroba vetë. Nuk kishin interes të vinin në dyqane me ne, megjithëse ne i ftonim.

Pyetje: A u kërkoni të sillnin të paktën një shumë të caktuar çdo ditë?

Përgjigje: Sigurisht që jo.

Pyetje: A u ke thënë ndonjëherë se nëse nuk sjellin më shumë para, do të duhet të largohen nga shtëpia?

Përgjigje: Sigurisht që jo.

Pyetje: A u ke kërkuar ndonjëherë të vjedhin për të shtuar fitimin?

Përgjigje: Sigurisht që jo.

Pyetje: A mund të na shpjegoni pse Adriana dhe Besarti u larguan nga shtëpia juaj dhe paraqitën ankesë kundër jush?

Përgjigje: Jam ende i tronditur nga kjo gjë. Ne bëmë gjithçka mundëm për ta dhe i shikonim si pjesëtarë të familjes sonë. Nuk arrij ta kuptoj pse u larguan dhe pse pretendojnë se u kemi bërë këto gjëra të tmerrshme. Ndoshta, dhimbjen që kishin përjetuar në jetën e tyre na e nxorrën ne. Mendoj se kurrë nuk do t'i besoj më njeriu. Në këtë botë, i miri vuan, i keqi përfiton. Kështu ka qenë gjithmonë dhe ja ku është shembulli.

E pyeta të intervistuarin nëse kishte gjë tjetër për të thënë dhe ai u përgjigj me jo.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarin nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ai u përgjigj në mënyrë pohuese dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.

Deklaruesi

Oficeri i policisë gjyqësore

9. DEKLARIMI NË POLICI E TË PANDEHURËS ERA GJOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

PROCES-VERBAL

për marrjen në pyetje të të pandehurit

Tiranë, më 20 shtator 2020

Unë, Lorik Marku, oficer i policisë gjyqësore, autorizuar nga prokurori i çështjes Edon Hasa, në bazë të neneve 38, 39, 48, 49, 304/2 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, mbaj këtë proces-verbal për marrjen në pyetje të të pandehurës: Era Gjoka, e bija e Fatimes dhe Naimit, lindur më 2 tetor 1979 në Elbasan, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim të mesëm, pa profesion, gjendja civile i martuar, me banim në adresën Rruga e Kavajes, Banesa 13 nr. tel #. 067902341, pa precedentë penalë, ID #K98123412K, akuzuar për kryerjen e veprës "trafikim i personave të mitur", parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal.

Të pandehurës i është shpjeguar dhe ajo pohon se:

I ka kuptuar të drejtat e saj, të dhëna me shkrim, sipas neneve 34/a dhe 34/b të Kodit të Procedurës Penale; të pandehurit i është shpjeguar në mënyrë të qartë dhe precize fakti që i atribuohet atij;

Asaj iu kërkua të shpjegonte gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e saj sipas nenit 39/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Nëse i pandehuri nuk ka caktuar një avokat mbrojtës, atij do t'i caktohet një avokat për të dhe të pandehurit do t'i paguhet nga Shteti, sipas nenit 49, 309 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.

E pandehura shpjegon dhe pohon se është e vetëdijshme për të drejtat e saj sipas ligjit; ajo u njoh me aktpadinë dhe deklaroi se:

Avokati që kam zgjedhur është Fatmir Elezi, nr. licencës 4321, dhe do të jap shpjegimet e mia për pyetjet tuaja.

Pyetje: Çfarë mund të më thoni për lidhjen që ke me Adriana dhe Besart Hysën?

Përgjigje: Unë jam tezja dhe e vetmja e afërme që u ka mbetur. Unë i kam dashur gjatë gjithë jetës së tyre dhe vazhdoj t'i dua.

Pyetje: Më tregoni si erdhën të jetojnë me ju.

Përgjigje: Ditën e varrimit të motrës, ata u bënë historikë se nuk kishin ku të shkonin. Fola me

burrin dhe vendosëm që, megjithëse ishim të varfër vetë, nuk kishim ç'të bënim tjetër veçse t'i merrnim të vinin të jetonin me ne. U thamë atyre dhe ata pranuan.

Pyetje: A u thatë se mund të jetonin me ju me kushtin që të duhej të siguronin vetë për veten?

Përgjigje: U thashë se ne ishim të varfër po të gatshëm të ndanim me ta atë që kishim. Gjithsesi, do të ishim mirënjohës po të ndihmonin me ndonjë punë të lehtë për të ndihmuar familjen.

Pyetje: Më trego për kushtet në të cilat jetonin gjatë qëndrimit te ju!

Përgjigje: Hanin çfarë hanim edhe ne, dhe u përpoqëm të bënim më të mirën për t'u dhënë ushqim të mirë e me vlera ushqyese. Ata flinin në dhomën e ndenjjes, se dhomë shtesë nuk kishim, por u dhamë shtrojet më të mira që kishim.

Pyetje: Me çfarë merreshin gjatë ditës? A shkonte në shkollë Besarti?

Përgjigje: Besarti nuk pranoi të shkonte në shkollë. E mendonte veten si një burrë që duhet të ndihmojë të mbajë motrën dhe familjen. Adriana dhe Besarti punonin gjatë ditës.

Pyetje: Çfarë pune bënin?

Përgjigje: Më thonin që bënin punë të rastit.

Pyetje: E dinit që lypnin?

Përgjigje: Jo kurrë s'më kanë thënë që lypnin.

Pyetje: Jua jepnin juve çfarë fitonin?

Përgjigje: Me kullandrisjen e lekëve merrej burri, ai është burri i shtëpisë.

Pyetje: A u thënë ndonjëherë, ti dhe burri, se nuk do të mund të rrinin më në shtëpi po të mos sillnin më shumë lekë?

Përgjigje: Nuk ua kam thënë kurrë një gjë të tillë dhe as kam dëgjuar tim shoq t'u thotë një gjë të tillë.

Pyetje: A u keni thënë, ti ose burri jua të vjedhin në mënyrë që të fitojnë më shumë?

Përgjigje: Nuk ua kam thënë kurrë një gjë të tillë dhe as kam dëgjuar tim shoq t'u thotë një gjë të tillë.

Pyetje: A u keni blerë ndonjëherë rroba të reja apo a i keni marrë me vete kur dilnit?

Përgjigje: Ata nuk kishin nevojë për rroba të reja gjatë kohës së shkurtër që qëndruan me ne. Ne u ofronim shpesh të vinin për pazare me ne, dhe ata erdhën ca herë dhe u kënaqën.

Pyetje: A i keni trajtuar njësoj si fëmijët tuaj?

Përgjigje: Po. Absolutisht. Ata hanin çfarë hanim ne dhe kujdeseshim për ta njësoj.

Pyetje: Nëse gjithçka ishte kaq mirë për ta, pse mendoni se u larguan nga shtëpia juaj dhe paraqitën ankesë kundër jush dhe bashkëshortit tuaj?

Përgjigje: Nuk e kam idenë. Ndoshta kanë mësuar mosmirënjohje nga e ëma që vuajti nga ky faj.

E pyeta të intervistuarën nëse kishte ndonjë gjë tjetër për të shtuar dhe ajo u përgjigj me jo.

Më tej, lexova deklaratën me zë të lartë dhe e pyeta të intervistuarën nëse konfirmonte atë që ishte regjistruar. Ajo u përgjigj me po dhe vendosi nënshkrimin, siç paraqitet më poshtë.




Deklaruesja

Oficeri i policisë gjyqësore

10. ÇERTIFIKATA E LINDJES E BESARTIT, VIKTIMËS SË MITUR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

			
REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albania Republika e Albanisë Republik Albanien Repubblica d'Albania Αλβανική Δημοκρατία		Zyra e Gjendjes Civile Tirane Office of Civil Registry Office de l'Etat Civil Oficina de Registro Civil Standesamt Ufficio dello Stato Civile Αρχαιογραφείο	
CERTIFIKATË LINDJE Birth Certificate / Certificat de Naissance / Certificado de Nacimiento / Geburtsurkunde Certificato di Nascita / Πιστοποιητικό Γέννησης			
Emri / Name / Prénom / Nombre / Vorname / Nome / Ονομα		Besart	
Mbiemri / Surname / Nom / Apellido / Familienname / Cognome / πώνυμο		Hysa	
Numri personal / Personal number / Numéro personnel / Numero personal / Personalnummer / Numero personale / Προσωπικός αριθμός		K67521778K	
Emri i babait / Father's name / Prénom du père / Nombre del padre / Vorname des Vaters / Nome del padre / Ονομα Πατρός		Besim	
Emri i nënës / Mother's name / Prénom de la mère / Nombre de la madre / Vorname der Mutter / Nome della madre / Ονομα μητρός		Flutura	
Datëlindja / Date of birth / Date de naissance / Fecha de nacimiento / Geburtsdatum / Data di nascita / Ημερομηνία γέννησής		11/05/2009	
Vendlindja / Place of birth / Lieu de naissance / Lugar de nacimiento / Geburtsort / Luogo di nascita / Τόπος γέννησής		Tiranë	
Vendbanimi / Place of domicile / Lieu de domicile / Domicilio / Wohnort / Luogo di domicilio / Τόπος κατοικίας		Tiranë	
Gjinia / Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Sesso / Φύλο		M	
Gjendja civile / Civil status / Etat civil / Estado civil / Zivilstand / Stato civile / Κατάσταση του πολίτη		Beqar/Single	
Beqar/e / Single / Célibataire / Soltero/a / Ledig / Celibe / Nubile / Άγαμος/η			
Ë/e Martuar / Married / Marié/e / Casado/a / Verheiratet / Coniugato/a / Έγγαμος/η			
Ë/e Shkurorëzuar / Divorced / Divorcé/e / Divorciado/a / Geschieden / Divorziato/a / Διαζευγμένος/η			
Ë/e Ve / Widow/er / Veuf/veuve / Viudo/a / Verwitwet / Vedovo/a / Χήρος/α			
Shtetësia / Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα		Shqiptar/Albanian	
Mbiemri para martesë / Maiden name / Nom de jeune fille / Apellido de soltero/a / Geburtsname / Nome da nubile / Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο		-----	
Data e lëshimit / Date of issuance / Date de délivrance / Fecha de expedición / Ausstellungsdatum / Data del rilascio / Ημερομηνία έκδοσης		20/09/2020	
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature of Registrar, Seal Prénom, Nom, Signature de l'Officier de l'Etat Civil, Sceau Nombre, Apellido, Firma del/la Encargado/a del Registro Civil, Sello Vor- und Nachname, Unterschrift des Standesbeamten, Siegel Nome, Cognome, Firma del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile, Timbro			
Ovogje			
PULLE TAKSE : PULLE TAKSE PULLE TAKSE			

II. ÇERTIFIKATA E VDEKJES E FLUTURA HYSËS, NËNA E VIKTIMËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA 10
Zyra e Gjendjes Civile Tiranë

Datë: 21/09/2020

ÇERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri Name	Flutura
Mbiemri Surname	Hysa
Numri personal Personal Number	J34587654J
Emri i babait Father's Name	Fadil
Emri i nënës Mother's Name	Mejreme
Datëlindja Date of Birth	09/01/1975
Vendlindja Place of birth	Elbasan
Vendbanimi Place of domicile	Tiranë
Gjinia Gender	F
Gjendja Civile Civil Status	Martuar/Married
Shtetësia Citizenship	Shqiptare/Albanian
Data e vdekjes Date of death	15.01.2020
Vendi i vdekjes Place/city of death	Tiranë
Shkaku i vdekjes Cause of death	Aksident/Accident

Kjo certifikatë lëshohet për DREJTORISE SE GJENDJES CIVILE, Tiranë

V.O: Akt vdekje Nr. 65, date:

Nëpunësi i Gjendjes Civile
Afërdita Myrtaj
(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vulë)

12. FOTOGRAFI TË GJENDJES SË RRËNUAR TË VIKTIMAVE DHE RROBA TË RRECKOSURA.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

OSBE. Prezenca në Shqipëri

Manual për mënyrën e zhvillimit të një gjyqi imitues për trafikimin e personave në Shqipëri / OSBE. Prezenca në Shqipëri. - Tiranë : Kumi, 2023.

... f. ; ... cm

ISBN 9789928340894

1. Trafikimi i qenieve njerëzore 2. Praktika gjyqësore
3. Manuale

343.54 (035)

